

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I ADMINISTRIMIT PUBLIK DHE SHKENCAVE POLITIKE
ФАКУЛТЕТ ЗА ЈАВНА АДМИНИСТРАЦИЈА И ПОЛИТИЧКИ НАУКИ
FACULTY OF PUBLIC ADMINISTRATION AND POLITICAL SCIENCES

STUDIME TË DOKTORATËS - CIKLI I TRETË I STUDIMEVE

Administrimi dhe menaxhimi i cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë

Kandidati,
Mr.Anton Gojani

Mentori,
Prof. Dr. Hasan Jashari

Tetovë, Shtator 2019

DEKLARATË

Përmes kësaj deklarate, unë Anton Gojani , i lindur më 10. 11. 1973, në Pejë, dëshmoj se disertacioni im me titull “ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI I CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË NË KOSOVË” është punimi im origjinal dhe i mbikëqyrur nga mentori im prof.dr. Hasan Jashari. Asnjë rezultat dhe asnjë pjesë e këtij disertacioni nuk është publikuar më herët në ndonjë revistë shkencore. Të gjitha burimet, citimet dhe parafrazimet janë bërë në bazë të kriterëve shkencore dhe kërkesës institucionale. Disertacioni është realizuar në bazë të rregullores së UEJL-it për studimet e ciklit të tretë.

Anton Gojani

UEJL – SEEU

Data:

Lektor:

Dr. Bahri Koskoviku

Për familjen dhe prindërit e mi

To my family and parents

Mirënjohje

Përmbajtja

DEKLARATË.....	2
Mirënjohje	4
Abstrakti	9
Lista e tabelave.....	13
Lista e Figurave.....	14
KAPITULLI I	15
1. HYRJE	15
1.1 Definimi i problemit dhe qëllimi i Studimit.....	16
1.2 Hipotezat	18
1.3 Pyetjet Hulumtuese	20
1.4 Metodat e hulumtimit.....	20
1.5 Rezultatet.....	21
KAPITULLI II	22
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS MBI MENAXHIMIN E CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË	22
2.1 Konceptet dhe nocionet administrim dhe menaxhim i cilësisë së AL-së.....	22
2.1.1 Trendet e menaxhimit të cilësisë	30
2.2 Historiku i Arsimit të Lartë në Kosovë	34

2.3 Konteksti Kosovar i Arsimit të Lartë pas luftës	41
2.3.1 Legjislacioni, Politikat dhe Strategjitë e AL-së.....	54
2.4 Praktikrat për menaxhimin e cilësisë në AL.....	61
2.4.2 Korniza e Kosovës për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë	61
2.4.3 Modelet ekzistuese- kurrikula, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimi i studentëve ..	63
2.4.4 Sigurimi i Cilësisë në procedurat e pranimit të studentëve- Cilësia Funksionale	64
2.4.5 Shërbimet për zhvillimin dhe përkrahjen e studentëve	64
2.6 Sigurimi i jashtëm i cilësisë	66
2.6.1 Agjencia e Kosovës për Akreditim.....	66
2.6.2 Praktika aktuale e sigurimit të jashtëm të cilësisë	68
KAPITULLI III.....	75
3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	75
3.1 Popullata dhe kampioni.....	75
3.2 Vendi i studimit.....	77
3.3 Procesi dhe instrumentet e hulumtimit.....	77
3.4 Analiza e të dhënave dhe vlerësimi i konsistencës	79
3.5 Etika	80
KAPITULLI IV	81
4. RASTE STUDIMI	81

4.1 Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"	81
4.2 Universiteti I Prizrenit "Ukshin Hoti"	83
4.3 Kolegji AAB	85
4.4 Kolegji FAMA	88
KAPITULLI V	90
5. ANALIZA E REZULTATEVE TË HULUMTIMIT- VERIFIKIMI I ÇËSHTJEVE TË CILËSISË	90
5.1 Shqyrtimi dhe krahasimi rezultateve të hulumtimit bazuar në komponentët për sigurimin e cilësisë	90
5.1.1 Reflektim mbi gjetjet e hulumtimit	121
5.2 Krahasimi rezultateve sipas rasteve të studimit - Interpretimi i gjetjeve	123
5.3 Analiza e hulumtimit të mekanizmave dhe politikave për sigurimin e cilësisë	141
5.3.1 Sfidat për menaxhimin efektiv të cilësisë sipas ekspertëve të AL	141
5.3.2 Sfidat për menaxhimin e cilësisë sipas Koordinatorëve për Sigurimin e Cilësisë të IAL-ve	154
5.4 Diskutimi dhe vërtetimi i hipotezave	162
KAPITULLI VI	166
6. KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET	166
6.1 Konkluzionet	166
6.1.1 Konkluzione të përgjithshme:	166

6.1.2 Konkluzione specifike	169
6.2 Rekomandime.....	173
BIBLIOGRAFIA- REFERENCAT	178
SHTOJCAT:.....	191
SHTOJCA I - PYETJET PËR EKSPERTËT E ARSIMIT - ME FOKUS GRUP	191
SHTOJCA II- PYETJET PËR KOORDINATORËT E CILËSISË SË IAL-ve.....	192
SHTOJCA III - PYETËSOR ME STUDENTËT	193
SHTOJCA IV - DËSHMITË PËR REALIZIMIN E HULUMTIMIT	215
SHTOJCA V - LISTA E TË INTERVISTUARVE - GUPI FOKUS DHE EKSPERTËT E ARSIMIT	216

Abstrakti

Arsimi i lartë dhe shkenca në secilën shoqëri konsiderohet i një rëndësie të veçantë në zhvillimin e resurseve humane duke filluar nga ato akademike, shkencore e deri te kuadrot teknike dhe teknologjike, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor. Por institucionet e arsimit të lartë konsiderohen edhe si vatra të zhvillimit të identitetit kombëtar të shoqërisë dhe të elitave që kanë ndikim edhe në imazhin dhe pozicionimin e vendit në arenën ndërkombëtare të dijes. Siç shprehet më të drejtë, Sir Francis Bacon (1561-1526) "Dija është fuqi" dhe këtu nuk bën përjashtim as AL-ja dhe shkenca e Kosovës që ka një histori dhe rrugë të veçantë të lindjes dhe zhvillimit në rrethana krejtësisht të posaçme.

Pas luftës për çlirim të vitit 1999, shoqëria e Kosovës është përshkuar me ndryshime rrënjësore të rethanave politike, ekonomike dhe sociale, duke u sfiduar me nevoja imediate për të krijuar bazë ligjore dhe institucionale edhe për AL-në në kushte të reja. Mendohet se këto rrethana kanë ndikuar fuqishëm në cilësinë jo të mirë të AL-së. Pastaj hapja e shumë universiteteve dhe kolegjeve publike dhe private në një periudhë të shkurtër kohore pa përgatitje të mirë paraprake dhe me resurse të kufizuara të stafit akademik, me resurse të kufizuara financiare dhe fizike, ka ndikuar në rënien e cilësisë në arsimin e lartë.

Sigurimi i cilësisë nga perspektiva e administrimit dhe menaxhimit është hulumtimi i parë shkencor për menaxhimin e cilësisë në arsimin e lartë të Kosovës. Prandaj qëllimi i këtij studimi është që me metoda shkencore të analizojmë, identifikojmë dhe vërtetojmë nevojat dhe mundësitë për përmirësimin e menaxhimit të cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë.

Hulumtimi mëton t'u përgjigjet këtyre pyetjeve: cilat janë sfidat kryesore të menaxhimit të cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë, a kanë qenë të përshtatshme politikat e MASHT-it dhe legjislacioni për sigurimin e cilësisë në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë? Pastaj cili është roli dhe ndikimi institucioneve përgjegjëse në menaxhimin e sigurimit të cilësisë dhe sa janë të përgjegjshme IAL-të në zbatimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë ? Në ç'masë kanë qenë

mbështetëse programet e BE-së dhe të donatorëve të tjerë në raport me zhvillimin e kapaciteteve për përmirësimin e cilësisë të arsimit të lartë në Kosovë?

Po ashtu hulumtimi synon të identifikojë pengesat konkrete në menaxhimin e cilësisë së AL-së në institucionet publike dhe private dhe përgjegjësitë e AKA-së dhe të MASHT-it në menaxhimin e sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë, duke propozuar zgjidhje për të bërë përmirësimet e nevojshme në të mirë të cilësisë. Ky hulumtim paraqet gjetje dhe rekomandime konkrete dhe të realizueshme për institucionet përkatëse qeveritare dhe për industrinë, si dhe do të kontribuojë edhe në shoqëri përmes përmirësimit të cilësisë së kuadrove të formuara në arsimin e lartë .

Rëndësi tjetër mund të ketë edhe për donatorët që të shohin problemet dhe nevojat që dalin nga hulumtimi dhe t'i orientojnë projektet e tyre në përmirësimin e gjendjes së cilësisë së arsimit të lartë dhe potencialet për përmirësim.

Në këtë hulumtim janë përdorur metodat kualitative dhe kuantitative dhe të dhënat e mbledhura janë primare dhe sekondare. Të dhënat primare janë mbledhur nga autori i hulumtimit përmes metodës së fokus grupit eksplorues me ekspertët e arsimit, përmes metodës së intervistave gjysmë të strukturuar me përgjegjësit, bërësit e politikave dhe menaxhuesit e arsimit të lartë (fokus grup), si dhe me përgjegjësit për sigurimin e cilësisë. Pastaj anketimi me pyetësorë me studentët e IAL-ve publike dhe private. Pra, në varësi nga aspekti analitik i hulumtimit janë aplikuar metoda dhe teknika përkatëse përmes analizës së të dhënave kualitative dhe kuantitative. Gjithashtu është përdorur si metodë e rëndësishme analiza e dokumentacionit arsimor dhe vëzhgimi i drejtpërdrejtë si metodë kualitative.

Fjalët kyçe: *Arsim i lartë, administrim, menaxhim, cilësi, legjislacion, akreditim.*

Shkurtesat

AAB	Kolegji AAB
AL	Arsimi i Lartë
ALLED	Aligning Education with Economy (Harmonizimi i Arsimit me Ekonominë)
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
AU	Arsimi Universitar
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Produkti Vendor
BPrAL	Bartësit Privatë të Arsimit të Lartë
BPPrAL	Bartësit Publikë dhe Privatë të Arsimit të Lartë
DALSH	Departamenti i Arsimit të Lartë dhe e Shkencës
DASH	Departamenti për Arsim dhe Shkencë
ECTS	European Credit Transfer System (Sistemi Evropian i Transferimit të Krediteve)
ENQA	Rrjeti Evropian i Agjencive të Sigurimit të Cilësisë
ERA	European Research Area (Zona Evropiane e Kërkimit)
ESG	European Sandard and Guidelines (Standardet dhe Udhëzuesit Evropian)
ESIB	Byroja Evropiane e Informacionit të Studentëve, (në fakt Shoqata Evropiane e Sindikatave Kombëtare të Studentëve, të cilat në disa vende janë më shumë se një)
EUA	Shoqata Evropiane e Universiteteve
EURASHE	Shoqata Evropiane për Standardet Akademike në Arsimin e Lartë
FAMA	Kolegji FAMA
GTZ/GIZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman
IA	Inspektorati i Arsimit
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë

IPAL	Institucionet Publike të Arsimit të Lartë
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
KEAL	Këshilli i Ekspertëve për Arsimin e Lartë
KEC	Kosova Education Center (Qendra për Arsim e Kosovës)
KD	Këshilli Drejtues
KKK	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
KSH	Kërkimi Shkencor
KSHC	Këshilli Shtetëror i Cilësisë
MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
MC	Menaxhim i Cilësisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
PB	Procesi i Bolonjës
SAL	Strategjia e Arsimit të Lartë
SMIA	Sistemi për Menaxhimin e Informacioneve në Arsim
UA	Udhëzim Administrativ
UNMIK	Misioni i Përkohshëm Administrativ i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UP	Universiteti i Prishtinës
UPZ	Universiteti i Prizrenit
ZSC	Zyra për Sigurim të Cilësisë
ZZhA	Zyra për Zhvillim Akademik

Lista e tabelave

Tabela 1	37
Tabela 2	37
Tabela 3	40
Tabela 4	44
Tabela 5	46
Tabela 6	66
Tabela 7	67
Tabela 8	81
Tabela 9	86

Lista e Figurave

KAPITULLI I

1. HYRJE

Arsimi i Lartë në Kosovën e pasluftës të vitit 1999 është përshkuar me ndryshime rrënjësore të rethanave politike, ekonomike dhe sociale. Këto ndryshime patën për rrjedhojë administratë të re ndërkombëtare dhe vendore të sfiduar me nevoja emergjente për të krijuar bazë ligjore dhe institucionale edhe për AL-në në kushte të reja. Kjo ka ndikuar fuqishëm në cilësinë jo të mirë të AL-së dhe rrjedhimisht edhe në resurse humane jociësore. Hapja e shumë universiteteve dhe kolegjeve publike dhe private në një periudhë të shkurtër kohore, pa përgatitje të mirë paraprake dhe me resurse të kufizuara të stafit akademik, me resurse të kufizuara financiare dhe fizike, ka ndikuar në rënien e cilësisë në arsimin e lartë.

Meqë arsimi i lartë, më saktësisht universitetet kanë rol dominant edhe në forcimin e identitetit kombëtar të shoqërisë, AL cilësor është i rëndësisë thelbësore për shtetin dhe shoqërinë.

Problemi studimor i trajtuar mund të jetë një kontribut i vlefshëm për përmirësimin e punës së tyre, por edhe për vetë shkencën.

Në epokën e globalizmit dija dhe resurset njerëzore janë asete kryesore për zhvillim, mobilitet dhe konkurrencë në tregun global të dijes. Prandaj konkurrencën mund ta përballojnë vetëm kuadrot, përkatësisht resurset humane cilësore dhe të afta për t'u përshtatur në rrethana të reja të tregut global. Veçanërisht për shoqëritë e vogla në numër, cilësia e arsimit mbetet alfa dhe omega për zhvillimin e potencialeve dhe aftësisë për të konkurruar.

Problemi studimor i propozuar "Administrimi dhe menaxhimi i cilësisë në arsimin lartë në Kosovë " është i rëndësishëm për shumë arsye esenciale, duke filluar nga roli dhe rëndësia e vetë arsimit të lartë kudo në botë, Kosova nuk mund të jetë përjashtim në këtë drejtim. Sigurimi i cilësisë nga perspektiva e administrimit dhe menaxhimit të saj, është hulumtimi i parë shkencor për menaxhimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe si i tillë mund të shërbejë si një impuls i mirë për institucionet vendimmarrëse që ta trajtojnë cilësinë në AL si prioritet. Gjithashtu punëdhënësit dhe akterët e tjerë mund të krijojnë një përshtypje të bazuar në qasje shkencore se ku gjendet AL i Kosovës. Rëndësi tjetër mund të ketë edhe për donatorët që të

shohin problemet dhe nevojat që dalin nga hulumtimi dhe t'i orientojnë projektet e tyre në përmirësimin e gjendjes së cilësisë të arsimit të lartë dhe potencialet për përmirësim.

1.1 Definimi i problemit dhe qëllimi i Studimit

Sigurimi i cilësisë në tërësi dhe nga pikëpamja e administrimit dhe menaxhimit të saj në veçanti, nuk është studiuar në mënyrë shkencore si fushë e rëndësishme për zhvillimin e resurseve njerëzore në vend. Prandaj qëllimi i këtij studimi është që me metoda shkencore të analizojmë, identifikojmë dhe vërtetojmë nevojat dhe mundësitë për përmirësimin e menaxhimit të cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë. Po ashtu synoj të identifikoj pengesat konkrete në menaxhimin e cilësisë së AL-së në institucionet publike dhe private dhe në menaxhimin e sigurimit të jashtëm të cilësisë siç janë AKA-ja dhe MASHT-i, duke propozuar zgjidhje për të bërë përmirësimet e nevojshme në të mirë të cilësisë. Pritjet e mia janë që disertacioni im me gjetje dhe rekomandime konkrete dhe të realizueshme, të kontribuojë në shoqëri dhe ekonomi përmes përmirësimit të cilësisë së kuadrove të formuara në arsimin e lartë. Kjo është e ndërlidhur ngushtë me kontributin për shoqërinë dhe ekonominë duke iu referuar katër fushave kryesore:

- Kontributi për shkencën: Deri tani nuk është realizuar asnjë hulumtim shkencor i kësaj natyre në arsimin e lartë në Kosovë. Pra, është hulumtimi i parë për menaxhimin e cilësisë në arsimin e lartë. E veçanta e këtij hulumtimi është qasja e bazuar në metoda shkencore për të ekzaminuar gjendjen e cilësisë së arsimit të lartë dhe potencialet për përmirësim. Vetë arsimi i lartë është i lidhur ngushtë me shkencën dhe hulumtimet. Prandaj tërësia e metodave që do të përdoren për realizimin e hulumtimit dhe gjetjet e realizuara janë një kontribut për shkencën. Më konkretisht, kontributi për shkencën ndërlidhet me fushën e arsimit të lartë, menaxhimit të performancës dhe administrimit të cilësisë në këtë fushë.
- Kontributi për institucionet shtetërore. Qeveria, MASHT-i, Agjencia Kosovare e Akreditimit dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë (AL), të cilat merren me hartimin dhe zbatimin e politikave të AL-së do të mund të përdorin hulumtimin për nevojat e planifikimit dhe rishikimit të politikave dhe strategjive përkatëse. Në mënyrë të veçantë,

konkluzionet dhe rekomandimet e hulumtimit do të jenë të rëndësishme për të kuptuar efektin e deritanishëm të reformave në AL me fokus në administrimin dhe menaxhimin e cilësisë në AL, si dhe për orientimin e e reformave në të ardhmën. Institucionet kryesore në Kosovë që mund të përdorin rezultatet e këtij hulumtimi janë: Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT), më konkretisht Departamenti për Arsimin e Lartë, Agjencia Kosovare e Akreditimit, Inspektorati i Arsimit në Republikën e Kosovës, Universitetet publike dhe private, Institutet hulumtuese të arsimit, organizatat dhe qendrat e ndryshme hulumtuese që merren me fushën e AL-së dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë dhe shkencës.

- *Kontributi për ekonominë dhe industrinë:* Arsimi, punësimi dhe ekonomia janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën edhe pse janë divergjente në të kuptuarit e politikave të AL-së. Por kur bëhet fjalë për cilësinë në arsim, që të tre këta sektorë pajtohen se është fundamentale për të ardhmën resurseve njerëzore të vendit. Dilema mbetet se sa janë të gatshëm punëdhënësit/industria të angazhohen strategjikisht në AL, a e kuptojnë kuptojnë rëndësinë dhe a kanë kapacitete ? Prandaj rezultatet e hulumtimit mund t'i shërbejnë industrisë që strategjikisht të rrisë rolin e saj në fushën e AL-së, duke promovuar cilësinë, nxitjen e hulumtimeve dhe inovacioneve që do ta ndihmonin edhe zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.
- *Kontributi për partnerët dhe donatorët e jashtëm:* Ata që mund të përdorin rezultatet e hulumtimit janë pikërisht partnerët dhe donatorët që kanë mbështetur sektorin e arsimit të lartë në Kosovë, si: BE-ja (me programet për arsim Erasmus+), donatorët bilateralë nga shtetet anëtare të BE-së dhe më gjerë (Finlanda, Gjermania, Zvicra), Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës, USAID-i, CIDA, GIZ-i, donatorë dhe partnerët e tjerë të jashtëm.

Në kuadër të punës kërkimore është hulumtuar roli i MASHT-it për ta reformuar sistemin arsimor nëpërmjet politikave, strategjive, legjislacionit, mbikëqyrjes dhe projekteve të përbashkëta me donatorë si dhe përmes AKA-së. Në nivel të bartësve publikë dhe privatë të arsimit të lartë (BPPrAL) është hulumtuar mënyra se si ato e adresojnë menaxhimin e cilësisë së brendshme në kuadër të këtyre institucioneve. Në mënyrë të veçantë, janë

hulumtuar mekanizmat e vlerësimit dhe zbatimi praktik i tyre në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve dhe të studimeve në kuadër të tyre.

1.2 Hipotezat

Hipotezat kryesore të hulumtimit janë:

Arsimi i Lartë në Kosovën e pasluftës ka qenë nën ndikimin e ndryshimeve rapide dhe rrënjësore të rrethanave politike, ekonomike dhe sociale me nevoja emergjente për të krijuar bazë ligjore dhe institucionale edhe për AL-në në kushte të reja. Reflektimi i rrethanave të ndryshimeve në regjionin e Evropës Juglindore ku tregu i AL-së ka qenë edhe përgjigje e konjunkturës regjionale.

- **H.1** Në këto rrethana, supozohet se hapja e pakontrolluar dhe stihike e shumë bartësve publikë dhe privatë të AL-së në një periudhë të shkurtër kohore, pa përgatitje të mirë paraprake dhe me resurse të kufizuara të stafit akademik ka ndikuar në rënien e cilësisë në arsimin e lartë. Pra, masivizimi i bartësve të AL-së në raport me cilësinë (kuantitet dhe jokualitet).

Politikat e MASHT-it për menaxhimin e cilësisë në arsimin e lartë nuk kanë dhënë rezultatet e duhura në ngritjen e cilësisë së arsimit dhe besueshmërisë së publikut në komunitetin akademik dhe shkencor të vendit. Politikat e MASHT-it kanë tentuar të përcjellin zhvillimin e AL-së të prirë nga Bolonja, por për shkak të mungesave në të kuptuarit e ndryshimeve dhe kapaciteteve humane për implementim, këto reforma nuk kanë rezultuar me suksesin e pritur (mungesë e vazhdueshme e investimeve në AL).

- **H.2** Mendohet se këto politika nuk kanë rezultuar me rritje të besueshmërisë së publikut dhe ekonomisë në resurset humane, duke mbetur edhe mëtej në shpërputhje me pritjet e industrisë për fuqi punëtore kualitative dhe me premisa inovative.
- **H.3** Supozohet se politikat e ngutshme dhe pa përgatitje të mjaftueshme, paqartësia, mosharmonizimi i mirë i legjislacionit për arsimin e lartë dhe politizimi kanë ndikuar në uljen e cilësisë dhe mosrespektimin e kriterëve akademike dhe shkencore.

Nënhipotezat që kanë ndikim në hipotezat e ngritura janë:

NH.1 Mendohet se mosgatishmëria për ndryshime e stafit të institucioneve bartëse të arsimit të lartë ka ndikuar në performancën jo të mirë dhe në rënien e cilësisë. Mungesa e një kulture të vlerësimit të cilësisë ka hasur në rezistencë të stafit për ndryshime

NH.2 Supozohet se themelimi i AKA-së ka qenë përpjekje për futjen rregullsisë dhe ndaljen e ofertave jocilësore të IAL-it, por akreditimi i një numri të madh të programeve dhe institucioneve në një hapësirë relativisht të kufizuar, si për nga numri i popullsisë dhe asaj gjeografike, si duket ka ndikuar më shumë në nxitjen e kuantitetit sesa në menaxhimin real të cilësisë sipas parametrave ndërkombëtarë.

NH.3 Ekziston bindja se mosanëtarësimi i Kosovës në Procesin e Bolonjës ka ndikuar negativisht në implementimin e reformave në arsimin e lartë dhe në qasjen pa pengesa në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

NH.4 Mungesa e kapaciteteve dhe e përkrahjes së zyrës për zhvillim akademik për të aplikuar projekte ndërkombëtare dhe mosshfrytëzimi i mirë i programeve të BE-së për

arsim të lartë (p.sh.Tempus) ka ndikuar në uljen e impaktit të projekteve në rrjedhën e reformave arsimore.

1.3 Pyetjet Hulamtuese

Me qëllim të arritjes së qëllimit të studimit doemos duhet të shtrohen pyetje kërkimore, të cilat kërkojnë përgjigje. Pyetjet kërkimore janë shtruar si në vijim:

1. Cilat janë sfidat kryesore të menaxhimit të cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë dhe si duhen adresuar ato?
2. Sa kanë qenë të përshtatshme politikat dhe strategjitë e MASHT-it për sigurimin e cilësisë në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë?
3. Sa është i përshtatshëm legjislacioni i arsimit të lartë në ngritjen e cilësisë?
4. Cili është roli dhe ndikimi i Agjencisë së Kosovës për Akreditim në menaxhimin e sigurimit të cilësisë (të brendshme dhe të jashtme)?
5. Sa janë të përgjegjshme IAL-të në implementimin dhe në zbatimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë (të brendshëm dhe të jashtëm)? (duke potencuar edhe rolin e përgjegjësve për administrimin dhe menaxhimin e sigurimit të cilësisë në universitete dhe kolegje; rolin i stafit mësimdhënës (akademik) në ngritjen e cilësisë; rolin i studentëve në ngritjen e cilësisë)).
6. Sa kanë qenë mbështetëse programet e BE-së në raport me zhvillimin e kapaciteteve për përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë?

1.4 Metodat e hulumtimit

Në këtë hulumtim të dhënat e mbledhura janë primare dhe sekondare. Të dhënat primare janë të dhënat që janë mbledhur nga autori i hulumtimit. Këto të dhëna janë mbledhur përmes metodës së *fokus grupit* eksploruës me ekspertët e arsimit për të kuptuar çështjet më të rëndësishme që i shohin ata sa i përket administrimit dhe menaxhimit të cilësisë në arsimin e

lartë në Kosovë gjatë periudhës 2000-2019. Përmes metodës së intervistave gjysmë të strukturuar me përgjegjësit, bërësit e politikave dhe menaxhuesit e arsimit të lartë (fokus grup), si dhe intervista me përgjegjësit për sigurimin e cilësisë dhe me drejtorin e AKA-së. Pastaj anketimi me pyetësorë me studentët e IAL-ve publike dhe private. Pra, në varësi nga aspekti analitik i hulumtimit janë aplikuar metoda dhe teknika përkatëse përmes analizës së të dhënave kualitative dhe kuantitative, duke aplikuar teknika si fokus grupe, intervista, ose anketime me pyetësorë të strukturuar me drejtuesit e njësive - përgjegjësve të zyrave për sigurim të cilësisë dhe anketime me studentët.

1.5 Rezultatet

do të barten rezultatet kryesore.... (të permbledhura në disa paragrafe)

KAPITULLI II

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS MBI MENAXHIMIN E CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Shqyrtimi i literaturës ekzistuese që ka të bëjë me këtë temë, bazohet në një numër solid të publikimeve dhe librave të ndryshëm ndërkombëtare për AL-në, por mjaft të kufizuara në nivel vendi. Literatura vendore për cilësi në AI është shtrirë kryesisht në dokumente në formë të ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve administrative, strategjive për arsimin e lartë, të publikimeve hulumtuese nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare që merren me arsimin e lartë, si dhe publikime nga institucionet e ndryshme (think tanks) etj.

Pa dyshim se një shqyrtim i shkurtër hyrës i është bërë edhe historikut të arsimit të lartë në Kosovë, pavarësisht se flasim për një arsim të lartë mjaft të vonshëm në krahasim me vendet e rajonit dhe më gjerë, por që ka kaluar nëpër sfida të papara në historinë e arsimit të lartë në Evropë e ndoshta edhe në botë. Është trajtuar më hollësisht konteksti kosovar i AL-së prej vitit 1999 e deri më tani, duke ndërtuar një bazë solide teorike për trajtim të temës bosht dhe si bazë e mirë për punën hulumtuese që është realizuar.

2.1 Konceptet dhe nocionet administrim dhe menaxhim i cilësisë së AL-së

Shtjellimi dhe shtrirja e koncepteve teorike lidhur me administrimin dhe menaxhimin e cilësisë së AL-së për politikat dhe trendet në arsimin e lartë në vend dhe në hapsirën evropiane të arsimit të lartë, për rolin e dijes si aset në kohën e globalizmit dhe sinteza e këtyre koncepteve përbën bazën mbi të cilën ndërtohet ky hulumtim. Po ashtu, kategoritë kryesore të kontekstit të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, përkatësisht procesi hulumtues është bërë duke analizuar literaturën dhe publikimet ekzistuese.

Rishikimi i literaturës i referohet operacionalizimit teorik të koncepteve themelore që u cekën më lartë.

Administrimi “Nocioni administrim rrjedh nga fjala latine administration, që do të thotë drejtim, qeverisje. Në fjalorin anglisht-shqip të Ramazan Hysës nocioni i administrimit nënkupton: administratën, qeverinë, qeverisjen, dhënien” (Hyseni, 2003, p. 8)(Hyseni, H., Mita,

N., Salihaj, J. & Pupovci, D. 2003:8). Administrimi i arsimit është: “drejtimi, kontrolli dhe menaxhimi i të gjitha çështjeve shkollore, të drejtimit, të mësimi, të financës” (Po aty, f. 392).

Sipas Merriam Webster-it (nga 1828) administrimi përfshin drejtimin, menaxhimin, qeverisjen e punëve publike, pjesën ekzekutive të qeverisë ku realizohet ushtrimi i kompetencave dhe mbikëqyrja e përgjithshme e çështjeve kombëtare dhe zbatimi i ligjeve. Por po ashtu nënkupton edhe personat kolektivë, të cilët janë të ngarkuar me ekzekutimin e ligjeve dhe mbikëqyrjen e çështjeve publike (Webster, 1828), (Denhardt, 2010)).

Fjalori etimologjik administrimin e trajton si "akt i dhënies ose i shpërndarjes";, "ndihma, bashkëpunimi, drejtimi, menaxhimi," emër i veprimit, e kaluara e administrimit "për të shërbyer, për të marrë pjesë, për të pritur, për të ndihmuar, menaxhuar, kontrolluar, udhëzuar". Fillimisht në shek. XV si "menaxhimi i pasurisë së një personi të vdekur nën një komision të caktuar nga autoriteti më i lartë". Kuptimi i periudhës së presidentit amerikan në detyrë është regjistruar së pari më 1796 në shkrimet e Xhorxh Uashingtonit. Administrata e qeverisë, në kuptimin e saj më themelor, përfshin të gjitha operacionet e organit politik, qoftë legjislativ, ekzekutiv ose gjyqësor, por në mënyrën më të zakonshme dhe ndoshta në kuptimin më të saktë të saj, ai është i kufizuar në hollësitë ekzekutive dhe bie në mënyrë të veçantë brenda departamentit ekzekutiv (Etymology Dictionary, shikuar 21.03.2018).

Nëse i referohemi Fjalorit politik të Oksfordit, mund të vërejmë se administrimi publik ka këtë përkufizim: “Administrimi publik, si degë e shkencave politike, është studimi i administratës publike nëpërmjet përshkrimit institucional, analizës dhe vlerësimit politik, si dhe analizës së marrëdhënieve ndërqeveritare” (McLEAN, 2011), cituar nga Terziu 2018, fq 9-10)), (Terziu, 2018).

Prandaj mendoj se në rastin tonë “Administrimi” do të duhej të kuptohej si një varg veprimesh institucionale në shërbim të drejtimit, udhëzimit, bashkëpunimit, pjesëmarrjes dhe kontrollit institucional në të mirë të publikut dhe shoqërisë. Administrimi gjithsesi është ushtrim i kompetencave dhe i mbikëqyrjes nga personat kolektivë në harmoni me ligjin dhe interesin publik.

Termi “menaxhim” sikurse administrim varësisht nga këndvështrimi mund të kuptohet sipas kontekstit të caktuar dhe shpeshherë edhe ngjajnë me njëri-tjetrin. Por në vijim do të shohim se termi “menaxhim” ka kuptime dhe interpretime aq të shumta sa edhe vetë numri i autorëve që janë marrë me shtjellimin e tij.

“Fjala menaxhim rrjedh nga fjala angleze Manage, që do të thotë: drejtoj, administroj” (Hyseni, 2003, p. 8) .

Sipas Terziut, ekzistojnë shembuj nga e kaluara që demonstrojnë se organizimet kanë ekzistuar prej mijëra vjetësh dhe se menaxhimi është praktikuar për një periudhë të barazvlefshme me organizimin. Megjithatë, dy ngjarje kishin një rol të rëndësishëm në promovimin e studimit të menaxhimit.

E para në vitin 1776, kur Adam Smith publikoi doktrinën klasike ekonomike - pasuria e kombeve (The Wealth of Nations) në të cilën ai argumentoi se përparësitë ekonomike që organizatat dhe shoqëria do të fitonin nga ndarja e punës fizike dhe ajo jofizike, janë detyra të caktuara dhe gjithëpërfshirëse.

E dyta dhe më me gjasë më e rëndësishmja, e cila ndikoi në menaxhim ishte Revolucioni Industrial i cili filloi në vitet e vonshme të shek. XVIII, ku ndodhi zëvendësimi i fuqisë punëtore (krahu) me atë të makinerive, e cila, si rrjedhojë, e bëri më të lehtë prodhimin e mallrave nëpër fabrika. Këto fabrika efikase që përdornin mjete të sofistikuara kërkonin njerëz me aftësi menaxheriale. Pse? Sepse menaxherët siguronin materialin e nevojshëm dhe të kërkuar për prodhimtari, ua caktonin njerëzve detyrat në fabrikë, i koordinonin detyrat e ndryshme dhe siguroheshin për gjendjen e makinave. Planifikimi, organizmi, udhëheqja dhe kontrollimi u bënë faktorë të domosdoshëm për zhvillimin e korporatave të mëdha. Nevoja për një teori formale të udhëzimit të menaxherëve në menaxhimin e këtyre organizatave tashmë ishte evidente, mirëpo një hap i tillë madhor nuk u konkretizua deri në vitet e hershme të 1900-tave (Robbins, 2012) (Robbins dhe Coulter, 2012, cituar nga Terziu, 2018 fq 6), (Terziu, 2018)).

Menaxhimi sipas Webster-it nënkupton udhëheqje, administrim, mënyrë të trajtimit, orientimit ose mbajtjes-kontrolli. Menaxhimi i një familjeje ose i një ferme; menaxhimi i punëve

të shtetit. Praktika dinake, sjellje e drejtuar nga arti, dizajni ose kujdesi, shpikje, praktika të caktuara (<http://webstersdictionary1828.com/Dictionary/Management> -21.03.2018).

Gjithashtu, L. Gulick-u definoi të paktën gjashtë funksione të menaxhimit publik si në vijim: “Planifikimi, Organizimi, Stafi (menaxhmi i burimeve njerëzore), Drejtimi, Koordinimi, Raportimi dhe Buxhetimi” (Gulick, 1937). Sipas Gulick-ut, i cili mbështetet edhe nga Fayol për të garantuar cilësi, menaxhimi në organizatë duhet të zbatojë funksionet e lartëcekura të menaxhimit dhe që në vijim shtjellon secilën prej tyre:

- **Planifikimi:** është mjet themelor që menaxherin dhe organizatën e orienton kah e ardhmja. Menaxherët konsiderojnë se koha e shpenzuar për planifikimin e përgjithshëm dhe individual është investim që sjell rezultate të mira për organizatën.
- **Organizimi:** përfshin strukturimin e organizatës në departamente apo sektore të ndryshme, definimin dhe rregullimin e niveleve hierarkike në kuadër të organizatës, rregullimi i raportimit të vartësve të përgjegjës të tyre. Po ashtu organizmi ka të bëjë me ndarjen e pozitave, detyrave të veçanta dhe përshkrimin e punës përkatëse.
- **Menaxhimi i burimeve njerëzore:** bëhet në mënyrë që të garantohet se puna në organizatë të shkojë si duhet, duke menaxhuar procesin e përzgjedhjes, trajnimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të personelit.
- **Drejtimi:** gjithnjë sipas Gulick-ut, nënkupton të paktën tre veprime kryesore menaxheriale: udhëheqjen, motivimin dhe ndryshimin e gjërave sa herë që paraqitet nevoja. Drejtimi kërkon kompetenca dhe zotësi personale dhe ndërpersonale, meqë është një përgjegjësi komplekse dhe e ndjeshme.
- **Koordinimi:** kërkon sistemim të hierarkisë, posedimin e zotësive të veçanta në zgjidhjen e problemeve, duke u bërë koordinimi i punës së individëve të ndryshëm, në vende të ndryshme, duke i bërë gjërat të funksionojnë dhe duke zotëruar aftësi për të komunikuar dhe negociuar me secilin nga ta.
- **Raportimi:** ka të bëjë me përgjegjësinë për llogaridhënie të menaxherëve ndaj zyrtarëve të zgjedhur, publikut dhe të tjerëve, nëpërmjet analizimit dhe mbajtjes së shënimeve për punën e organizatës dhe ecurinë e saj. Gjithashtu për menaxherët raportimi dhe mbajtja e

shënimeve është e rëndësishme, në mënyrë që ata ta kenë një pasqyrë mbi ecurinë e punës dhe t'i analizojnë rezultatet e arritura në raport me objektivat e caktuara, të identifikojnë problemet në kohën e duhur dhe të gjejnë alternativat për evitim dhe përmirësim të tyre.

- **Buxhetimi:** përfshin menaxhimin e burimeve të organizatës, sidomos të atyre financiare dhe konsiston në sigurimin, planifikimin dhe menaxhimin e fondeve të organizatës, gjithashtu edhe këtu kërkohet aftësi e konsiderueshme për të menaxhuar me buxhetin (Gulick, 1937)

Sipas funksioneve të menaxhimit të paraqitura më lart vërehet qartë se për të menaxhuar një ndërmarrje, organizatë apo institucion duhet të praktikohen një varg funksionesh të menaxhimit, në mënyrë që të arrihen rezultate dhe të përmbushen objektivat e synuara.

Edhe H. Fayol, i cili është njëri nga teoricientët dhe teknikienët francez, në gjysmën e shek. XX i definon pesë funksionet themelore që duhet t'i posedojë një menaxher e që janë: “planifikimi, organizimi, komandimi, koordinimi dhe kontrolli” (Fayol, 1949). Në esencë të gjithë teoricientët që merren me menaxhimin pak a shumë kanë një pajtueshmëri për funksionet kryesore të menaxhimit.

Lidhur me menaxhimin në disertacionet e tyre të doktoraturës Isa Mustafa dhe Besim Beqaj pajtohen se: menaxhimi duhet të përfshijë të paktën funksionet themelore siç janë: planifikimi, organizimi, realizimi dhe kontrolli, duke mos përjashtur edhe koordinimin dhe udhëheqjen (Mustafa) dhe (Beqaj).

Sa i përket çështjes së administrimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore disa nga autorët vendorë pohojnë se:

“Udhëheqësi i institucionit edukativo-arsimor, u siguron të gjithë nxënësve/studentëve arsim cilësor përmes qasjes së barabartë në jetën shkollore, përmes mësimdhënies me nxënësin në qendër, përmes aktiviteteve të ndryshme kurrikulare dhe jashtëkurrikulare, përmes sigurimit të një mjedisi të mirë dhe të sigurt për të mësuar, përmes klimës miqësore në mjediset shkollore, përmes angazhimit të nxënësve në të gjitha proceset që janë me rëndësi dhe me interes për ta” (Devetaku, 2013)

Kur bëhet fjalë për menaxhimin, mendoj se përveç funksioneve të lartëcekuara nga autorë të ndryshëm siç janë: planifikimi, organizimi, stafi (menaxhmi i burimeve njerëzore), drejtimi, koordinimi, raportimi dhe buxhetimi, në botën moderne dhe dinamike në të cilën jetojmë ndjehet nevoja për modele të avancuara të menaxhmentit të shprehura përmes leadershipit. Kjo nënkupton një avancim përtej kuptimit teknik duke i dhënë dimension dhe frymë udhëheqjes përmes modeleve të liderëve që motivojnë, ndërtojnë besim dhe u prijnë ekipeve të punonjësve që i besojnë jo vetëm liderit, por edhe njëri-tjetrit.

Për ne, në kuadër të këtij punimi janë të rëndësishme të kuptuarit e drejtë të termave, menaxhimi i cilësisë dhe sigurim i cilësisë.

Sipas *Longman dictionary* menaxhimi i cilësisë (gjithashtu menaxhimi total i cilësisë), shkurtesa TQM, nënkupton menaxhimin e sistemeve në një kompani për të siguruar që secili departament prodhon ose bën gjëra me cilësi të lartë dhe vazhdon të përmirësohet (Longman dictionary, 21.03.2018). <https://www.ldoceonline.com/dictionary/quality-management> (21.03.2018)

Ne kemi nevojë të fokusohemi në përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të cilësisë përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë.

Ndërsa sigurimi i cilësisë (SC-QA emër [i panumërueshëm]) nënkupton edhe menaxhimin e cilësisë së prodhimit të mallrave ose shërbimeve në mënyrë që ata të mbetën në një standard të lartë. A jeni duke ruajtur procedurat adekuate të sigurimit të cilësisë? Një menaxher i sigurimit të cilësisë (Longman Business Dictionary, 2018).

Termi “arsim i lartë” [i panumërueshëm], kolegji ose arsimi i lartë në krahasim me shkollën ose shkollën e mesme apo arsimim të mëtejshëm (<https://www.ldoceonline.com/dictionary/higher-education>, 2018).

Por çfarë është dhe çfarë kuptojmë me termin cilësi? Siç do të shihet në vijim të kuptuarit e cilësisë është mjaft i ndryshëm dhe veçanërisht gjërat thellohen më tutje kur flasim për cilësinë në arsim dhe mënyrat e sigurimit të cilësisë.

Cilësia paraqet "temperamentin, karakterin, disponimin"; nga frëngjishtja e vjetër `qualite` "kualiteti, natyra, gjendja, gjendja" (12c, Modern French *qualité*) tha [Tucker, etj.]. Ky term duket të jetë shpikur nga Ciceroni për të përkthyer 'poiotes' greke) nga qualis "çfarë lloj", nga rrënja PIE * këo-, rrjedhin nga përemrat relativë dhe interrogativë. Kuptimi "shkalla e mirësisë" është fundi i shekullit të 14-të. Kuptimi "gradë shoqërore, pozitive" është c. 1400. Kohëzgjatja e shprehjes së frazës së parë të regjistruar në vitin 1977. Cilësia e jetës është nga viti 1943. Kontrolli i cilësisë së parë vërtetoi 1935 etj... (<https://www.etymonline.com/word/quality> , 2018)

Cilësia është një koncept kompleks. Kuptimi i tij ndryshon me njerëz dhe organizata të ndryshme. Përkufizimet e saj variojnë nga konvencionale në atë më strategjike. Nga pikëpamja konvencionale, një artikull i cilësisë është ai që "vesh mirë, është i ndërtuar mirë dhe do të zgjasë shumë kohë". Tradicionaliteti e trajton cilësinë si sinonim i mirësisë, elegancës, përsosmërisë ose "Unë e njoh cilësinë kur e shoh " 81. Megjithatë, për menaxherët që bëjnë biznes në një treg shumë konkurrues global, përkufizimi strategjik, i cili është "përmbytja e nevojave të klientëve ", ka më shumë kuptim.

David Garvin, në librin e tij "Menaxhimi për Cilësinë", identifikoi pesë qasje kryesore për përcaktimin e cilësisë. Ata janë transcendentë, bazuar në produkte, bazuar në përdorues, bazuar në prodhim dhe në bazë të vlerës. Qasja transhendente barazon cilësinë me "përsosmërinë e lindur", një pronë që konsiderohet absolute dhe e njohur në mënyrë universale (Ben A. Maguad P. &, 2012, p. 84).

Nuk ka një përkufizim të vetëm të cilësisë që pranohet në mënyrë universale. Ekzistojnë po aq përkufizime të cilësisë sa libra dhe autorë. Megjithatë, përkufizimet e saj të ndryshme strategjike ndajnë të njëjtat elementë të përbashkët:

- Cilësia përfshin takimin ose tejkalimin e pritjeve të klientit.
- Cilësia aplikohet për produktet, shërbimet, njerëzit, proceset dhe mjediset.

- Cilësia është një gjendje gjithnjë në ndryshim - ajo që konsiderohet e cilësisë sot nuk mund të jetë mjaft e mirë për t'u konsideruar si cilësi nesër.

Cilësia, e bazuar në elementet e përbashkëta të lartpërmendura, mund të përkufizohet si "një gjendje dinamike e lidhur me produktet, shërbimet, njerëzit, proceset dhe mjediset që plotësojnë ose tejkalojnë pritjet aktuale"

Ky përkufizim pohon ndryshimet vazhdueshme të cilësisë me kohën dhe rrethanat. Gjithashtu thekson se "cilësia nuk zbatohet vetëm për produktet dhe shërbimet e ofruara, por edhe për njerëzit dhe proceset që ofrojnë ato dhe mjediset në të cilat ato ofrohen" (Ben A. Maguad P. &., 2012, pp. 87-89)

Sintetizimi i këtyre tri koncepteve dhe kontekstualizimi në rastin e Kosovës.

Para se të studiojmë temën e cilësisë në çdo thellësi, duhet të jemi të qartë për atë që nënkuptojmë me termin "Cilësi". Kur flasim me të tjerët për cilësinë, duhet të jemi të sigurtë se kemi të njëjtin kuptim të termit. Konsideroni përkufizimet e mëposhtme:

- Një shkallë e përsosmërisë - Dictionary Concise Oxford;
- Fitness për qëllime - Defoe dhe Juran (2010);
- Gjithësia e tipareve dhe karakteristikave që bartin aftësinë e një produkti apo shërbimi për të përmbushur një nevojë të caktuar - Standardi Britanik 4778 (Instituti i Standardeve Britanike, 1991);
- Karakteristikat totale të përbërjes së produktit dhe shërbimit të marketingut, inxhinierisë, prodhimit dhe mirëmbajtjes nëpërmjet të cilave produkti dhe shërbimi do të përmbushin pritjet e konsumatorit - Feigenbaum (1961);
- Përputhja me kërkesat - Crosby (1979);
- Cilësia është një gjendje dinamike e lidhur me produktet, shërbimet, njerëzit, proceset dhe mjediset që plotësojnë ose tejkalojnë pritjet dhe ndihmojnë në krijimin e vlerës së lartë - Goetsch dhe Davis (2010) (Knowles, 2011, p. 10).

Përcaktimi Goetsch dhe Davis është një përpjekje e arsyeshme për të mbledhur së bashku temat e një numri definicionesh për "cilësinë" dhe për të krijuar një përkufizim unifikues. Shtimi më i rëndësishëm në diskutimin e mëparshëm është ideja e dinamizmit. Me

këtë ata nënkuptojnë se nivelet e pranueshme të cilësisë nuk janë fikse, por ndryshojnë me përvojat dhe pikëpamjet e klientëve të botës (Knowles, 2011, p. 11).

2.1.1 Trendet e menaxhimit të cilësisë

Në një artikull të botuar në vitin 1998, pionieri i cilësisë Armand Feigenbaum shpjegoi trendet e ndryshme që do të formësojnë drejtimin e menaxhimit të cilësisë në të ardhmen. Ai parashikoi se konsumatorët në shkallë globale do të vazhdonin të kërkonin cilësi të lartë dhe vlera të shtuara nga prodhuesit e mallrave dhe shërbimeve. Këta klientë do të jenë të interesuar jo vetëm në cilësinë e produkteve apo shërbimeve të ofruara, por edhe në cilësinë e organizatave që u ofrojnë atyre. Ajo do të duhet të shfrytëzojë fuqinë e teknologjisë në emër të klientit për të mbështetur konkurrencën e saj në shekullin e 21-të. Konkurrenca globale ekonomike do të ushtrojë presion të madh ndaj organizatave për të përmirësuar vazhdimisht cilësinë, duke ulur në të njëjtën kohë koston e prodhimit dhe çmimet e ngarkuara për konsumatorët. Për të pasur sukses në këtë mjedis, kompanitë duhet të mësojnë të menaxhojnë buxhetet e tyre dhe të dinë si t'i udhëheqin njerëzit e tyre në të njëjtën kohë. Kjo me siguri do të kërkojë ndryshime thelbësore në mënyrën e funksionimit të organizatës (Ben A. Maguad P. &, 2012, p. 73).

Po ashtu, Goetsch dhe Davis parashikojnë se menaxhimi i cilësisë si praktikë dhe profesion ka një të ardhme të ndritur. Ata argumentojnë më tej se në drejtim të suksesit në tregun global, menaxhimi i cilësisë është e ardhmja. Ato organizata që plotësisht institucionalizojnë parimet e menaxhimit të cilësisë kanë një shans të fortë për të arritur sukses në tregun global tani dhe në të ardhmen (Ben A. Maguad P. &, 2012, p. 74).

Sa i përket sigurimit të cilësisë në AL ka shumë dilema dhe paqartësi në nivel ndërkombëtar, pasi ende nuk ka qartësi për atë se çka duhet të arrihet në nivel të vendeve dhe as për atë që nënkuptojmë me cilësinë në arsimin e lartë.

Dennis Farrington mendon se ka njëfarë progresi drejt një kuptimi të përbashkët evropian të cilësisë, i cili, megjithëse ende nuk parashikon krijimin e një Agjencie Evropiane të Sigurimit të Cilësisë mbikëqyrëse, inkurajon bashkëpunimin ndërmjet agjencive kombëtare në baza

evropiane dhe rajonale. Pa këtë, punëdhënësit e të diplomuarve nga shtetet e tjera, veçanërisht ato jashtë Bashkimit Evropian (për shembull Rusia dhe shtetet e Ballkanit) nuk mund të kenë besim të vërtetë në krahasueshmërinë e kualifikimeve edhe nëse kanë të njëjtin emër dhe mbajnë pikë ECTS. Ndryshimet në rregullimin ligjor të procedurave të licencimit dhe akreditimit, të përqendruara në kompetencat dhe rezultatet e të nxënësve, do të duhet ta arrijnë këtë qëllim.

Gjithashtu ai mendon se një grumbull i vërtetë i shkurtesave përfaqëson agjencitë e ndryshme të ngarkuara për të paraqitur dhe për të rënë dakord me standardet, procedurat dhe udhëzimet. Këto përfshijnë ENQA (Rrjeti Evropian i Agjencive të Sigurimit të Cilësisë), EUA (Shoqata Evropiane e Universiteteve), ESIB (Byroja Evropiane e Informacionit të Studentëve, në fakt Shoqata Evropiane e Sindikatave Kombëtare të Studentëve, të cilat në disa vende janë më shumë se një); EURASHE (Shoqata Evropiane për Standardet Akademike në Arsimin e Lartë). Gjithnjë sipas tij sistemet kombëtare të sigurimit të cilësisë duhet të përfshijnë (i) një përkufizim të përgjegjësisë (ndërmjet qeverisë, agjencisë dhe institucioneve), (ii) vlerësimit të programeve ose institucioneve, (iii) një sistemi të akreditimit, certifikimit ose procedurave të krahasueshme me të vërtetë), dhe (iv) pjesëmarrja ndërkombëtare. Kjo e fundit është veçanërisht e rëndësishme për vendet e vogla ose grupet e vendeve (Farrington., 2005, p. 53).

Ndërsa konsensusi ndërkombëtar për vlerësimin e cilësisë rritet, perspektiva e një rrjeti ndërkombëtar të agjencive të sigurimit të cilësisë të modeluar në ENQA ka më shumë gjasa sesa krijimi i një agjencie evropiane të gjithanshme për sigurimin e cilësisë.

Në sistemet e zhvilluara, siguri i brendshëm i cilësisë përqendrohet në analizën reflektuese në raportet e vetëvlerësimit me sigurimin e jashtëm të cilësisë tani më të fokusuar në atë se si institucionet rrisin cilësinë e punës së tyre.

Nën emra dhe formate të ndryshme, zakonisht ekziston një autoritet kombëtar me disa funksione që kanë të bëjnë me njohjen e kualifikimeve arsimore dhe profesionale nga jashtë ose të huaj (ku vendi nuk është një ishull) dhe për të ndihmuar të diplomuarit me njohjen ndërkombëtare të kualifikimeve të tyre. Në Evropë, kjo ndodh nëpërmjet Qendrave Kombëtare të Njohjes Akademike (NARIC) të themeluara në kuadrin e Komisionit Evropian dhe Rrjetit Evropian të Qendrave të Informacionit (ENIC).

Sipas analizës së legjislacionit, pothuajse të gjitha vendet kanë ndjekur rrugën e krijimit të një organi kombëtar të sigurimit të cilësisë, por shumë pak përmendin në mënyrë eksplicite bashkëpunimin evropian në sigurimin e cilësisë. Nëse kjo është e nevojshme varet nga natyra e sistemit në çdo vend të caktuar. Është e qartë se është një ide e mirë, por, nëse kushton para, mund të argumentohet se duhet të ketë disa legjislacione (Farrington., 2005, pp. 54-55).

Më qëllim të trajtimit të një tematike dhe një hulumtimi kaq kompleks janë trajtuar 14 fusha relevante të funksionimit të IAL-ve të adresuara përmes 23 nënfushave kryesore. I tërë trajtimi bëhet përmes zbërthimit të tyre në të gjitha elementet kryesore të sigurimit të cilësisë funksionale, akademike, programore, metodologjike, vlerësimit, përmbajtësore/ materialeve mësimore, orientimit shkencor, lidhjes me tregun e punës, kompetencave kryesore të BE-së për MGJGJ (EU key competences for LLL), shërbimeve për studentë, marrëdhënieve ndërkombëtare, e-mësimin, bashkëpunimi ndërkombëtar, infrastrukturës, statistikat etj. Të gjitha këto elemente të trajtuara janë në kuadër të fushave në vijim, duke analizuar aspektet kryesore e që janë:

- Institucioni i arsimit të lartë
- Situata e përgjithshme e studimit
- Programi i studimit- mësimdhënia e ofruar
- Orientimi i kërkimit shkencor dhe integrimi me praktikën
- Organizimi i studimeve
- Përgatitja për tregun e punës
- Përkrahja nga stafi akademik dhe vlerësimi i mësimdhënies
- Përkrahje për mobilitet - qëndrim studimor jashtë vendit
- Sallat-amfiteatrot-klasat
- Biblioteka/salla leximi
- Infrastruktura e it-së dhe e-learning (të mësuarit online)
- Klima e studimit
- Aspekte të rëndësishme të studimit
- Statistika - informacione demografike

Siç shihet nga kjo që u potencua mësipër, korniza teorike e këtij hulumtimi merr për bazë fuqishëm ESG-në (European Standards and Guidelines) të ENQA-së si një emërues i përbashkët i kritereve të pranuar gjerësisht në hapësirën evropiane të AL-së. Për më tepër në mungesë të një kornize kombëtare për sigurim të cilësisë në AL dhe për të fuqizuar bazën e referimt të punës hulumtuese, besoj se referimi në ESG i bën më të pranueshme rezultatet.

2.2 Historiku i Arsimit të Lartë në Kosovë

Arsimi i lartë në Kosovë ka një histori relativisht të re në krahasim me vendet e rajonit, por edhe më gjerë. Nevoja për kualifikime në profile të ndryshme arsimore nga radhët e popullsisë shqiptare ndërlidhet me nevojën e themelimit të institucioneve të larta arsimore.

AL karakterizohet me zhvillime të njëpasnjëshme, të cilat në aspektin e arsimit tipik fillojnë me themelimin e Shkollës së Lartë Pedagogjike në Prishtinë, pastaj me themelinin Universitetit të Prishtinës në vitin 1970 e deri më sot, ku funksionojnë shumë institucione të arsimit të lartë në Kosovë.

Shumë studiues lindjen dhe zhvillimin e arsimit të lartë në Kosovë e lidhin me hapjen e SHLP-së në vitin 1958 dhe e shohin të ndarë nga shkenca, por mendimi im është se fillet e arsimit të lartë dhe të shkencës në Kosovë datojnë me hapjen e institucioneve të para shkencore-hulumtuese siç janë:

Qendra e Studimeve Kosovare më 1943 në Prizren (Instituti i parë shkencor, Prof. Selman Riza), Enti Veterinar Bakterologjik më 1946, Instituti i Veterinarisë (funksionon edhe sot), Instituti për Hulumtime Bujqësore në Pejë më 1949, Instituti Albanologjik i Prishtinës më 1953, pastaj ajo që mendohej si fillet e arsimit të lartë në Kosovë SHLP-ja në vitin 1958 e deri tek akti i themelimit të Universitetit të Prishtinës më 1970, i cili më të drejtë konsiderohet si maja e arritjeve të asaj kohe (Berisha, 2018).

Institucioni i parë i arsimit të lartë (jo edhe i shkencës) në Kosovë është Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, e themeluar në vitin 1958. Fillimisht me profilet (Grup autorësh, Monografi, 2005, p. 12).

Vlen të përmendet fakti se në "vitin e parë shkollor 1958/59 kishte 93 studentë të rregullt dhe 55 me korrespondencë. Në vitin shkollor 1961/62 u hap paralelja e SHLP-së të Prishtinës në Prizren, ku u regjistruan 100 studentë, 48 prej të cilëve ishin shqiptarë. Në vitin 1962 SHLP-ja e Prizrenit bëhet e pavarur".

Një vit pas themelimit të SHLP-së të Prishtinës, më 1959 u hap Shkolla e Lartë Administrative në Prishtinë, kurse në vitin 1960 u themelua Shkolla e Lartë Ekonomike Komeriale në Pejë. Në po të njëjtin vit u themelua edhe Shkolla e Lartë Bujqësore në Prishtinë

(Po aty, faqe 15). Numri i nxënësve të regjistruar në këto institucione ishte simbolik, por domethënës për kohën.

Në po të njëjtin vit (1960) u hap fakulteti i parë - Fakulteti Filozofik në Prishtinë, me gjashtë katedra. Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe, e Gjuhës Serbokroate dhe e Letërsisë Jugosllave, e Matematikës, e Fizikës, e Kimisë, e Biologjisë. Më 1961/62 u themeluan edhe katedrat: Gjuhë dhe Letërsi Ruse dhe Letërsi Angleze. Vlen të përmendet fakti se në vitin e parë të themelimit, "1960/61 u regjistruan 97 studentë të rregullt (60 shqiptarë, 32 serbë dhe 5 të tjerë) dhe 141 me korrespondencë. Mësimin e mbanin 7 mësimdhënës (2 shqiptarë dhe 5 serbë) dhe 7 bashkëpunëtorë (2 shqiptarë dhe 5 serbë). Prej tyre 4 ishin doktorë shkencash dhe 1 magjistër" (Po aty).

Siç mund të kuptohet nga faktet e dhëna, numri i nxënësve ishte simbolik, siç ishte simbolik edhe numri i kapaciteteve/kuadrove për mësimdhënie.

Në vitin 1961 u themelua Fakulteti Juridik-Ekonomik. Ky fakultet kishte 2 drejtime: Juridik dhe Ekonomik. Në vitin e parë në dy drejtimet u regjistruan 586 studentë. Në po këtë vit (1961) u hapën edhe dy shkolla të larta teknike: Shkolla e Lartë Teknike në Prishtinë dhe Shkolla e Lartë Teknike në Mitrovicë.

"Në katër shkollat e larta dhe në dy fakultete të hapura deri në vitin 1961 studionin 3320 studentë (1046 të rregullt dhe 2274 me korrespondencë), prej të cilëve 2010 serbë, 928 shqiptarë dhe 382 të tjerë". Po në vitet '60 u themeluan edhe disa institucione të tjera të arsimit të lartë, si: Shkolla e Lartë Pedagogjike "Xhevdet Doda" në Prizren (1962), Fakulteti Teknik në Prishtinë (1965), Shkolla e Lartë Pedagogjike "Bajram Curri" në Gjakovë (1967) dhe Fakulteti i Mjekësisë në Prishtinë (1969) (Po aty, f.16)).

Gjatë asaj periudhe, mësimi në fakultete dhe në shkolla të larta mbahej në gjuhën serbo-kroate. Kjo për shkak se kuadri mësimor në gjuhën shqipe ishte i paktë, përjashtime kishte vetëm në degën e Albanistikës, në të cilën që nga fillimi mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe.

" Në vitin 1964 diplomuan 31 studentë nga gjenerata e parë e studentëve të Fakultetit Filozofik, prej të cilëve 16 shqiptarë dhe 15 të tjerë" (Po aty).

Me hapjen e katër fakulteteve të përmendura më lart, u krijuan kushtet themelore për themelimin e Universitetit të Prishtinës. Këtu ndikuan edhe rrethana të tjera objektive dhe politike në vend.

Duke pasur parasysh faktin që kuadrot profesionale në Kosovë me arsim të lartë dhe universitar mungonin shumë, mbështetja e fakulteteve të para të themeluara dhe shkollave të larta ishte shumë e madhe dhe e rëndësishme. Këto institucione dhanë kontribut në përgatitjen e kuadrove dhe ekspertëve shqiptarë me arsim të lartë (Po aty, f.17).

Në nëntor të vitit 1969 u nxor ligji për themelimin e Universitetit të Prishtinës, kurse ceremonia e hapjes u zhvillua më 15 shkurt 1970 dhe dita e 15 shkurtit u shpall Dita e Universitetit të Prishtinës. Rektor i parë i Universitetit të Prishtinës u zgjodh Dr. Dervish Rozhaja (Po aty, f.18).

Zhvillimet në Universitetin e Prishtinës ishin të shumta. Pas themelimit u hapën edhe fakultete të tjera, Shkollat e Larta Pedagogjike u bënë pjesë e UP-së, numri i studentëve u rrit në masë të madhe, duke përfshirë rritjen e numrit të studentëve shqiptarë, po ashtu edhe studentet femra. Prandaj, "në periudhën 1970 - 1990 numri i fakulteteve rritet në 13, ndërsa Universitetit i bashkohen edhe 7 shkolla të larta" (KEC, 2001, p. 141).

Nëse shikojmë numrin e studentëve shqiptarë në raport me numrin e studentëve serbë, nga viti i parë i themelimit të Universitetit të Prishtinës dhe deri në vitin 1980/81, shohim se është një rritje e jashtëzakonshme dhe një e arritur e mirë e shqiptarëve në rrugën e arsimimit dhe edukimit. UP-ja u shndërrua në një qendër të fuqishme universitare. Bashkë me rritjen e numrit të studentëve, rritje të madhe pati edhe në kuadrin e profesorëve dhe bashkëpunëtorëve të UP-së. Për një kohë relativisht të shkurtër u krijua kuadri për mësim në gjuhën shqipe në të gjitha degët. Gjatë vitete 1970/1980 në Universitetin e Prishtinës u diplomuan mbi 9500 studentë nga 46 profilet e tij dhe u mbrojtën mbi 100 disertacione të doktoratës. Pjesa dërrmuese e tyre ishin shqiptarë (Grup autorësh, Monografi, 2005, p. 20).

Gjatë periudhës 1981/91 Universiteti i Prishtinës "shënon numrin më të madh të studentëve dhe të kuadrit mësimor shqiptar, por shquhet edhe nga intensifikimi i represionit politik dhe policor serb ndaj profesorëve dhe studentëve shqiptarë (Po aty, f.23) ".

Gjatë kësaj periudhe UP-ja shënoi rritje të sukseshme në të gjitha fushat, ndritja e kuadrit profesional me tituj shkencorë (doktorantë dhe magjistrantë), rritje të SHLP-ve dhe fakulteteve, ndarjen e disa fakulteteve si të veçanta etj.

Krahas sukseseve të UP-së, pati edhe probleme serioze, sidomos pas lëvizjes studentore të vitit 1981, e cila u përkrah dhe me të cilën u solidarizuan i gjithë populli shqiptar. Këto lëvizje u shoqëruan edhe me ndërhyrje policore dhe dhunë ndaj studentëve. Si rezultat i kësaj, studentëve shqiptarë iu mohua e drejta e studimit ose u përjashtuan nga studimet 568 studentë.

"Në vitin 1990 u nxor vendimi për masat e dhunshme në Universitetin e Prishtinës nga Kuvendi i Republikës së Serbisë, ndërsa në qershor të vitit 1991 u futën masat e dhunshme në Universitet dhe në fakultete . Më 1 tetor 1991 Fondi Krahinor për Arsimin e Lartë në Kosovë ndërpreu financimin e mësimiit shqip në të gjitha fakultetet dhe shkollat e larta. Studentët dhe arsimtarët shqiptarë u përjashtuan nga Universiteti i Prishtinës" (Po aty,f.26).




Tabela 1

Studentët sipas gjuhëve mësimore në periudhën 1969/70-1990/91

Viti shkollor Academic year	Gjithsej Overall	Të rregullt Full time	Me korrespondencë Part time
1991/92	19622	15826	3796
1992/93	15679	11867	3812
1993/94	12093	8481	3612
1994/95	11532	7769	3763
1995/96	13805	9231	4574
1996/97	16375	10880	5495
1997/98	16715	10813	5902
1998/99	15765	10736	5029
1999/2000	22058	14225	7833

Table 2

Numri i studentëve në Universitetin e Prishtinës në periudhën 1991/92-1999/2000 sipas mënyrës së studimeve

Siç vërehet në tabelat e prezentuara, të dhënat e paraqitura janë të ndara në dy periudha kohore. Periudha e parë konsiston me vitet kur është themeluar Universiteti i Prishtinës, duke filluar nga viti akademik 1969/70 deri në vitin 1990/91 kur edhe u suprimua mësimin në gjuhën shqipe nga ana e Kuvendit të Serbisë që për rrjedhojë kishte largimin e dhunshëm nga hapësirat universitare të mësimdhënësve dhe studentëve që zhvillonin punën akademike dhe shkencore në gjuhë shqipe. Deri në këtë periudhë të dhënat janë paraqitur për studentët që studionin në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Ndërsa për periudhën e dytë, e cila përfshin vitet akademike 1991/92-1999/2000 janë paraqitur vetëm të dhënat për mësimin në gjuhën shqipe, ku për shkak të kushteve në të cilat janë mbledhur cilësia e tyre dallon nga cilësia e të dhënave të periudhës së parë kohore.

Të dhënat për shkolla të larta kanë filluar të përpunohen prej vitit 1979/80, kur këto institucione kanë hyrë në kuadër të Universitetit dhe mungojnë të dhënat nga koha para themelimit të Universitetit të Prishtinës, pra për periudhën 1958/59-1968/69 (KEC, 2001, p. 146).

Pas rrethanave të vështira të krijuara pas përjashtimit të mësimdhënësve dhe studentëve dhe pas ndërprerjes së financimit për UP-në dhe studentët shqiptarë, periudha

1991-1999 konsiderohet periudhë e mbijetesës së Universitetit. Meqë lokalet e fakulteteve të UP-së u uzurpuan plotësisht nga policia serbe, organizimi i mësimi u bë në lokale të tjera private. Nga viti në vit numri i studentëve zvogëlohej për shkak të rrethanave dhe kushteve të vështira ekonomike dhe situatës politike, megjithatë mësimi zhvillohej vazhdimisht, megjithëse nuk mund të thuhet se edhe cilësia ishte në nivel të kënaqshëm apo rezultatet ishin të larta.

Veprimtaria mësimore e UP-së u ndërpre përkohësisht për shkak të luftës, në mars të vitit 1999. Vlen të përmendet fakti që në këtë luftë u vranë 322 studentë dhe 8 profesorë të Universitetit të Prishtinës (Po aty, f.30).

Një fazë e re e organizmit të mësimi në Universitetin e Prishtinës ishte periudha 1999-2005, pra periudha e pasluftës. Mësimi zhvillohej në objekte legale të UP-së. Edhe kjo periudhë kishte vështirësitë e veta, megjithëse në rrethana krejtësisht të tjera. Kjo periudhë karakterizohet me procesin e reformave në arsimin e lartë, sipas rezolutes 1244 të KS të OKB-së. Qëllimi i reformave ishte harmonizimi i arsimit sipas standardeve dhe kritereve evropiane dhe në frymën e Deklaratës së Bolonjës (Pupovci, D., Hyseni, H. & Salihaj, J., p. 59).

Vlen të përmendet fakti se mënjherë pas luftës së vitit 1999, në vitin shkollor 2000/2001 në Universitetin e Prishtinës numri i studentëve ka rënë për 8.1% më pak studentë se në vitin akademik 1999-2000. Zvogëlimi i numrit të studentëve mund të shpjegohet me nevojën për punësim në periudhën e pasluftës apo edhe me mosreformimin e disa degëve të Universitetit në raport me nevojat e kohës. Numri i studentëve të rregullt është pothuajse i njëjtë si në vitin 1999-2000, kurse numri i studentëve me korrespondencë është zvogëluar dukshëm (KEC, 2001, p. 60).

Pjesë e ndryshimeve të mënjëhershme arsimore pas luftës ishte themelimi i Fakultetit të Edukimit, i cili filloi të funksiononte në katër qendra: Prishtinë, Gjiilan, Prizren dhe Gjakovë. Si rrjedhojë e kësaj Shkollat e Larta Pedagogjike dhe Fakulteti i Mësuesisë u integruan në Fakultetet e Edukimit, në degët përkatëse.

Në këtë periudhë kohore Universiteti i Prishtinës kishte mbështetje nga organizata të ndryshme vendore e ndërkombëtare, qeveritare e joqeveritare, si: SOROS, WUS i Austrisë, UNMIK, Këshilli i Evropës, OSBE etj. (Grup autorësh, Monografi, 2005, p. 35).

Por duhet të theksohet se megjithë rrugën e vështirë të zhvillimit, UP-ja ka luajtur një rol të rëndësishëm edhe përtej Kosovës për shkollimin dhe ngritjen e kuadrove shqiptare që jetonin në tërë hapësirën e ish-Jugosllavisë. Ishte vatra e dijes dhe shkencës për shqiptarët që jetonin në Maqedoni, Mal të Zi, Luginën e Preshevës e gjetiu.


Roli i tij historik në formimin dhe zhvillimin e identitetit kombëtar dhe kulturor të shqiptarëve si një vatër e lindjes dhe formësimit të ideve për zhvillimin e vetëdijes kombëtare, kulturore dhe për artikullimin e atyre ideve dhe aspiratave për liri njerëzore dhe kombëtare.

Ishte porta kryesore e dijes dhe shkencës për gjithë shqiptarët jashtë Shqipërisë për t'iu bashkëngjitur zhvillimeve shkencore, teknike, teknologjike dhe kulturore të kohës, duke na bërë pjesë të kombeve të përparuara.

Prandaj një moto e mirë për të nxitur ndryshimet pozitive është kjo thënie e Sokratit: "Sekreti i ndryshimit është që të përqëndroni të gjithë energjinë tuaj, jo në luftimin e së vjetrës, por për ndërtimin e së resë. Pikë!"

2.3 Konteksti Kosovar i Arsimit të Lartë pas luftës

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar nëpër zhvillime të jashtëzakonshme dhe të shpejta që nga qershori i vitit 1999 kur përfundoi lufta në Kosovë.



Skema e Qeverisjes në Arsimin e Kosovës (2000)

Legjenda:

KPA – Këshilli i përkohshëm administrativ

KTK – Këshilli tranzitor i Kosovës

Tabela 3

Skema e Qeverisjes në Arsimin e Kosovës në vitin 2000

Burimi: (Shifra dhe fakte për arsimin e Kosovës, 2001)

Kjo skemë paraqet organizimin dhe qeverisjen e arsimit në Kosovë në vitin 2000, kohë kur autori i këtij punimi ka punuar në Departamentin e Arsimit. Nëse e krahasojmë me strukturën e tanishme, shohim se kemi ndryshime të mëdha, duke kaluar nga Departamenti për Arsim dhe Shkencë në kuadër të IPVQ-ve në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Ndërsa sa i përket IAL-ve shihet qartë që në këtë kohë kemi të bëjmë me vetëm një universitet publik që është UP-ja dhe SHLP-të. Më vonë me vendim të qeverisë fillojnë reformat duke filluar me vendimin për mbylljen shkollave të larta pedagogjike duke kaluar në fakultete, si dhe duke përqafuar njëanshëm parimet dhe rregullat e Deklaratës së Bolonjës të vitit 1999. Për arsye politike Kosova edhe sot e kësaj dite nuk është anëtare e procesit të Bolonjës. Ndryshim tjetër të rëndësishëm përbën nxjerrja e ligjit për AL-në dhe lejimi i hapjes së IAL-ve private, të cilat do të marrin një hov të shpejtë të përhapjes së tyre pa ndonjë përgatitje paraprake me kuadro dhe aranzhime të tjera institucionale sa i përket funksionimit të tyre dhe sigurimit të cilësisë.

Kurse sot organizimi i sistemit të Arsimit të Lartë në Kosovë rregullohet me Ligjin për Arsimin e Lartë (Nr. 04 / L-037), i miratuar në gusht të vitit 2011. Sistemi i Arsimit të Lartë në Kosovë funksionon përmes universiteteve publike dhe institucioneve private të arsimit të lartë (kolegje, shkolla dhe akademi të larta profesionale). Vetëm institucionet e akredituara të arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi që çojnë në një titull ose diplomë.

Megjithëse Kosova nuk është zyrtarisht pjesë e procesit të Bolonjës, që nga futja e reformave të Bolonjës nga Universiteti i Prishtinës më 2001/2002, të gjitha legjislacionet kombëtare kanë shërbyer për të zbatuar dhe vënë në funksion më mirë objektivat dhe parimet e reformës së Bolonjës në tërë sektorin e AL-së të Kosovës. Si rezultat i zbatimit të këtyre reformave në arsimin e lartë, të gjitha institucionet e arsimit të lartë zbatojnë aktualisht sistemin e kredive ECTS, sistemin e diplomës me tre cikle, mobilitetin e studentëve dhe stafit, shtojcën e diplomës dhe një sistem të sigurimit të cilësisë (HE in Kosovo, National Erasmus+ office , 2017).

E drejta e arsimit është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila në nenin 47 [E Drejta e Arsimit] parashikon që:

1. Çdo person gëzon të drejtën për arsimim bazë të lirë. Arsimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike.

2. Institucionet publike sigurojnë mundësi të barabarta për arsimim për secilin në përputhje me aftësitë dhe nevojat specifike të tyre (Kushtetuta e RKS, K-09042008 , 2008) .

Arsimi i lartë në Kosovë bazohet në parimet e mëposhtme, të artikuluar në Ligjin e Arsimit të Lartë, neni 2:

1. Liria akademike, e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe interpretimi i saj i mëvonshëm nga gjyqësori;
2. Barazia para ligjit të të gjithë bartësve të arsimit të lartë;
3. Mundësi të barabarta për të gjithë studentët dhe personelin në institucionet e arsimit të lartë pa diskriminim;
4. Diversiteti dhe cilësia në programet e studimit dhe në mbështetje të mësimi;
5. Kreativiteti, inovacioni dhe sipërmarrja si objektiva kryesorë të bartësve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit;
6. Një fokus evropian dhe ndërkombëtar në të gjitha fushat e arsimit të lartë, duke siguruar lëvizjen e studentëve dhe stafit dhe krahasueshmërinë e standardeve të diplomave dhe kualifikimeve;
7. Një angazhim për hulumtime dhe bursë për të mbështetur mësimdhënien dhe mësimin dhe për të zgjeruar kufijtë e njohurive dhe të kuptuarit brenda dhe jashtë Kosovës;
8. Angazhimi aktiv i studentëve në aspektin individual, si dhe në mënyrë kolektive, në jetën e institucionit të tyre dhe në mësimin e tyre (Ligji Nr.04/L-037 përAL).

Strategjia për Zhvillimin e Arsimit të Lartë 2010-2015 ka kaluar në fazën përfundimtare të zbatimit, e cila ka rezultuar me promovimin e një politike gjithëpërfshirëse të arsimit dhe ngritjen e një sistemi të sigurimit të cilësisë së arsimit të lartë (MASHT SZHAL2010-2015 , 2010).

Plani Strategjik i Kosovës për Arsimin e Lartë në Kosovë (PSAK) për periudhën 2011-2016 ka përfunduar implementimin, ndërsa PSAK e re për periudhën 2017-2021 është në proces të implementimit (PSAK 2017-2021 MASHT, 2017).

Një dokument tjetër që ndikon në zhvillimin e arsimit të lartë është Programi Kombëtar i Shkencës i miratuar nga Parlamenti i Kosovës në vitin 2010, i cili përcakton masat për promovimin e kërkimit dhe prioritetet kombëtare të kërkimit për periudhën 2010-2015 (Këshilli Kombëtar i Shkencës i RKS 2010, 2010, p. Këshilli). Ky program është edhe në harmoni me Ligjin nr. 04/L-135 për veprimtari kërkimore-shkencore të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligjin nr. 04/L-135 për VKSH , 2013).

Përveç kësaj, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë (MTI) dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MED) ka hartuar Strategjinë Kombëtare të Inovacionit 2013-2020, e cila në masë të madhe mbështet qasjen e trefishtë spirale që bashkon akademinë, kërkimin dhe industrinë.

Sipas Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë, arsimi i lartë në Kosovë mund të ofrohet nga institucionet publike ose private. Emërtimet e institucioneve të arsimit të lartë janë të rregulluara me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe UA nr. 01/2013 për emërtimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë. Ato përfshijnë: universitetet, universitetet aplikative, kolegje universitare, kolegjet, akademitë, shkolla të larta profesionale dhe shkolla të larta teknike. Universitete dhe kolegjet universitare janë institucione që ofrojnë arsim dhe kërkim shkencor dhe ofrojnë programe studimi në të tre ciklet e arsimit të lartë (Bachelor, Master dhe Doktoratë). Këto dy lloje të institucioneve dallojnë në aspektin e shumëllojshmërisë së programeve të tyre të studimit: universitetet ofrojnë programe në të paktën pesë fusha lëndore të Erasmus-it, ndërsa kolegjet universitare ofrojnë programe në të paktën tri fusha të tilla. Kolegjet dallojnë nga universitetet dhe kolegjet universitare në atë se, ato nuk ofrojnë arsim të lartë në nivelin e tretë (doktoratë) dhe natyra e hulumtimit që ata kryejnë është aplikative. Akademitë dhe shkollat e larta profesionale ofrojnë studime profesionale dhe mund të ofrojnë hulumtim aplikativ, kurse dallimi në mes të dyve është se kjo e para përqendrohet në një lëndë specifike (p.sh. në fusha specifike të artit, sportit, rendit publik, të sigurisë dhe fusha të tjera profesionale) (AKK,Raporti i referencimit te KKK me KEK, 2016, pp. 22-23). Sistemi i arsimit të lartë në Kosovë përfshin arsimin e lartë akademik dhe arsimin e lartë profesional, edhe pse në legjislacionin aktual nuk ka dallim të qartë ndërmjet tyre. Në arsimin e lartë akademik dhe profesional, të dyja e kanë Nivelin Bachelor dhe atë Master.




Tabela 4

Struktura organizative ekzistuese e MASHT-it

Kjo figurë pasqyron strukturën organizative të funksionimit të MASHT-it (Struktura organizative e MASHT-it, 2015).

Siç shihet në këtë paraqitje skematike të MASHT-it, për dallim nga skema paraprake, tanimë kemi një strukturë të konsoliduar institucionale sa i përket menaxhimit të arsimit në përgjithësi dhe AL-së në veçanti. Ekziston një strukturë më e qartë hierarkike me shumë IAL publike dhe me institucione përgjegjëse për sigurim të cilësisë dhe për kualifikime siç janë AKA-ja dhe AKK-ja. Kurse sa i përket kualifikimeve në përputhje me Deklaratën e Bolonjës dhe Ligjin nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë, AL është zakonisht i organizuar në tri nivele kryesore që çojnë në kualifikime në Bachelor, Master dhe Doktoratë, dhe kjo përfshin çdo arsim tjetër post-sekondar

në nivelet 5-8 të KKK-së, për të cilat mund të jepen ECTS kredi. Kualifikimet e arsimit të lartë mund të lëshohen nga institucionet e arsimit të lartë, të cilat janë të akredituara nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës (AAK) dhe të licencuara nga MASHT-i që të ofrojnë programe të arsimit të lartë. Universitetet ofrojnë studime në të paktën pesë fusha akademike, kurse kolegjet universitare ofrojnë studime të paktën tri fusha akademike.

Kur bëhet fjalë për strukturën e programeve të arsimit të lartë siç u theksua më lart, IAL-të në Kosovë organizojnë studime sipas strukturës në tre cikle sipas procesit të Bolonjës dhe zbatojnë sistemin e ECTS kredive në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-037 mbi Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës dhe UA nr. 14/2008 për implementimin e ECTS në Arsimin e Lartë në Kosovë (UA nr. 14/2008 për ECTS në AL , 2008). Sipas këtij ligji, arsimi i lartë është i organizuar si më poshtë:

- Cikli i parë: Programe Bachelor
- Cikli i dytë: Programe Master.
- Cikli i tretë: Programe të studimeve të Doktoratës me karakter akademik dhe të pavarur kërkimor-shkencor.




Tabela 5
Struktura niveleve dhe programeve ekzistuese të AL në Kosovë
(Burimi: Overview of the HE system; Erasmus+)

Figura e mësipërme tregon shtrirjen dhe kohëzgjatjen e secilit cikël të studimeve, numrin e ECTS-ve, renditjen sipas SNKA (ISCED) dhe harmonizimin e tyre me parimet e Bolonjës.

Edhe pse përqindja e kredive të marra përmes moduleve të detyrueshme dhe zgjedhore brenda një studimi nuk është përcaktuar në mënyrë rigoroze, për pjesët e detyrueshme ka tendencë që të llogarisin 70 për qind të ECTS kredive, ndërsa ato zgjedhore 30 për qind.

Është e detyrueshme të punohet nga një tezë për të dy programet: Bachelor dhe Master. Numri i ECTS kredive i caktuar për tezën e Bachelor-it vendoset nga ana e institucioneve të arsimit të lartë, ndërsa numri i ECTS kredive të një teze të Masterit është i përcaktuar në 30 kredi.

Studimet e doktoratës zakonisht organizohen përmes një kombinimi të provimeve dhe një teme të doktoratës, e cila prezentohet dhe mbrohet publikisht. Këto studime zgjasin të paktën tre vjet dhe ofrohen aktualisht vetëm në arsimin e lartë akademik (AKK, Raporti i referencimit të KKK me KEK, 2016).

Sistemi AL-së dominohet nga institucionet e arsimit të lartë akademik me programe studimore akademike, të cilat ofrohen për nivelet 6-8 të KKK-së, ndërsa programet e kualifikimeve profesionale ofrohen për nivelet 6-7 të KKK-së.

KKK-ja parasheh ofrimin e arsimit të lartë profesional për nivelet 5-7 të KKK-së. Megjithatë ofrimi i nivelit të 5-të të KKK-së është në një fazë fillestare. Edhe pse programet e shkurtra arsimore tre-cikëlshe të Bolonjës janë të parapara në nivelin e 5-të të KKK-së, aktualisht nuk ofrohen programe të tilla dhe titulli për këto kualifikime nuk dihet ende.

Arsimi i lartë profesional mund të ofrohet nga ofruesit publikë dhe privatë që ofrojnë arsim të lartë akademik, apo institucione që veçanërisht fokusohen në arsimin profesional akademik, shkollat e larta profesionale apo shkollat e larta teknike, por që janë të akredituara nga AAK-ja sipas KKK-së.

Studentët e regjistruar në sistemin formal të arsimit zakonisht ndjekin një progres linear nga një kualifikim në një tjetër.

Për t'u pranuar në një program të arsimit të lartë, studenti duhet të posedojë kualifikimin e mesëm të lartë të nivelit të arsimit, diplomën e maturës shtetërore, dhe kjo vlen për të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe të dy programet akademike dhe profesionale (Ligji Nr. 03/L-

018 për Provimin e Maturës , 2018). Sipas ligjit në fjalë, diploma e maturës shtetërore fitohet pas provimit të maturës në fund të gjimnazit trevjeçar apo të arsimit profesional. Studentët e programeve profesionale të arsimit të mesëm mund të zgjedhin të mos hyjnë në testin e Maturës Shtetërore, por ata duhet të arrijnë këtë kualifikim në qoftë se dëshirojnë të vijojnë ndonjë program të arsimit të lartë.

Sipas Ligjit Nr. 03/L-018 për Provimin Përfundimtar dhe Provimin e Maturës Shtetërore obligohen të gjitha institucionet e AL-së të pranojnë rezultatet që nxënësit kanë arritur, si gjatë shkollimit të mesëm në vlerësimet e brendshme, ashtu edhe në provimin e jashtëm të standardizuar të maturës shtetërore.

Sidoqoftë, IAL-të publike me miratim nga MASHT-i mund të organizojnë testet pranuese sipas kërkesave të tyre për regjistrim të përcaktuara në statutet e tyre.

Progresi i programeve të studimit që çojnë nga niveli i 5-të i kualifikimeve në KKK te Niveli i 6-të në KKK, është paraparë nga KKK-ja. Megjithatë ende nuk ekziston legjislacion primar apo sekondar që rregullon ligjërisht këtë progress.

Në nivelet 6, 7 dhe 8, të KKK-së kualifikimet dalëse të AL-së përcaktohen nga sistemi i Bolonjës dhe ato kanë tituj të përgjithshëm: Bachelor, Master dhe Doktoratë. Mirëpo, rregullat për emërtimin e kurseve të shkurtra të Bolonjës nuk janë vendosur deri më sot.

Sipas UA nr. 23/2012 mbi gradat dhe diplomat e Arsimit të Lartë, dokumentet e mëposhtme të arsimit të lartë dëshmojnë përfundimin e programeve studimore të arsimit të lartë:

- Një diplomë Bachelor jepet nga çdo ofrues i akredituar dhe licencuar i arsimit të lartë, i cili ofron programe studimore të ciklit të parë me një kohëzgjatje prej 3 deri në 4 vjet dhe 180-240 pikë të ECTS kredive.
- Një diplomë Master jepet nga çdo ofrues i akredituar dhe licencuar i arsimit të lartë, i cili ofron programe studimore të ciklit të dytë me një kohëzgjatje prej 1 deri në 2 vjet dhe 60-120 pikë të ECTS kredive, me kusht që shuma e përgjithshme e pikave të kredive për të dy nivelet e studimit (Bachelor dhe Master) të jetë 300 pikë të ECTS kredive.
- Një diplomë e doktoratës lëshohet nga çdo ofrues i akredituar dhe licencuar i arsimit të

lartë, i cili ofron programe studimore të ciklit të tretë, të cilat janë të një natyre akademike kërkimore- shkencore dhe që zgjasin të paktën 3 vjet.

Diplomat e mësipërme janë aktualisht të përgjithshme për të gjitha programet në këto nivele, si programe akademike dhe profesionale, kurse titulli specifik i diplomave të Bachelor-it, Master-it dhe Doktoratës përcaktohet në përputhje me rregulloren e vetë institucioneve të arsimit të lartë për dhënien e diplomave dhe certifikatave (UA nr. 23/2012 mbi Gradat dhe diplomat e AL, 2012).

Pas përfundimit me sukses të programit studimor, të gjitha IAL-të në Kosovë janë të obliguara me Ligjin Nr 04/L-037 për Arsimin e Lartë t'u japin studentëve një diplomë dhe një shtojcë të mbyllur të diplomës me formën dhe përmbajtjen që përcaktohet nga UA Nr. 02/2012 për formën dhe përmbajtjen e diplomave dhe shtojcave të diplomës të ofruesve të Arsimit të Lartë (UA Nr. 02/2012 për Diploma dhe shtojca të diplomës , 2012).

Përveç informacionit mbi studentin dhe programin studimor, i cili është përfunduar, diploma duhet të specifikojë numrin e ECTS kredive të fituara dhe nivelin e kualifikimit në KKK. Udhëzimi Administrativ, Nr. 02/2012 për formën dhe përmbajtjen e diplomave dhe shtojcave të diplomës gjithashtu përcakton modelin e shtojcës së diplomës në përputhje me Konventën për Njohjen e Kualifikimeve lidhur me Arsimin e Lartë në rajonin evropian (Konventa e Lisbonës 1997).

Sipas AKA-së, në Kosovë ofrojnë arsim të lartë akademik dhe profesional: nëntë (9) universitete publike dhe njëzet e dy (22) institucione private të arsimit të lartë.

Disa programe të A-sëL ofrohen edhe nga degët e universiteteve të huaja, ose nga institucionet lokale sipas licencës, franshizës apo marrëveshjeve me universitete të huaja për shërbim, programet e të cilave janë validuar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim:

- Fakulteti i Ekonomisë - Universiteti i Lubjanës (MBA)
- Staffordshire University programmes në kolegjin Riinvest (BA dhe MBA)
- Shkolla e Biznesit EADA (MBA)

Sipas raportit të Erasmus+, është bërë progres i rëndësishëm në sigurimin që përqindjet më të larta të studentëve të regjistruhen në IAL. Numri i studentëve që ndjekin programet e ciklit të tretë është rritur në rreth 122,000 (duke përfshirë edhe studentët e pakicës serbe në

univeristetin paralel të Mitrovicës së Veriut). Kosova renditet në krye të vendeve evropiane për numrin e studentëve me rreth 7.000 për 100.000 banorë.

Megjithatë rritja e numrit të studentëve solli sfida të reja në menaxhimin e cilësisë. Kosova u bë anëtare e ENQA-së në vitin 2014 (në ndërkohë para një viti është është degraduar anëtarësimi duke e vendosur si anëtar në vëshgim, për shkak të ndërhyrjeve të pretenduara politike nga qeveria), duke konfirmuar se Kosova zbaton Udhëzimet Standarde Evropiane në sigurimin e jashtëm të cilësisë. Ndërkohë MASHT-i kërkon fuqizim të mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë, gjë që nuk po duket se po ndodh ende.

IAL-të publike të aplikojnë praktika dhe mënyra të ndryshme të menaxhimit financiar dhe kjo parashikohet të rregullohet në kuadër të Ligjit të ri për Arsimin e Lartë, i cili ende nuk është miratuar nga Kuvendi i RKS. Mirëpo MASHT-i në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, po zhvillon kornizën e zbatimit për një praktikë të standardizuar dhe të unifikuar të menaxhimit financiar në të gjitha institucionet publike.

IAL-të në Kosovë gjithashtu bashkëpunojnë ngushtë me shumë partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Si rezultat i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, IAL-të deri më tani kanë bashkëpunuar me më shumë se njëqind akademikë ndërkombëtarë nga SHBA-ja, Evropa dhe Azia Juglindore, duke punuar me studentët kosovarë dhe stafin akademik. Institucionet e Arsimit të Lartë në Kosovë kanë marrë pjesë në Programin Tempus që nga viti 2001. Këto projekte kanë rezultuar në modernizimin, inicimin dhe zbatimin e reformave strukturore, aktiviteteve të ndërtimit të kapaciteteve dhe zhvillimit të kurrikulave. Pjesa më e madhe e stafit akademik ka përfituar nga këto projekte në ndërtimin e kapaciteteve të tyre, përmes trajnimit, rritjes së kapaciteteve kërkimore dhe mësimore përmes mobilitetit, vizitave studimore dhe shkëmbimit të përvojave me IAL-të e tjera të BE-së dhe rajonale (Website of the National Erasmus+ office, 2019).

Ndonëse arsimi i lartë përjetoi reforma thelbësore, ka argumente *pro dhe kundër* nëse janë bërë reforma substanciale ose sipërfaqësore. Procesi i reformës është duke u zhvilluar, por do të duhet më shumë kohë derisa të ofrojë një produkt cilësor, domethënë studentë të aftë dhe

konkurrues për tregun e hapur dhe një mjedis, që është i lirë nga mosmarrëveshjet e së kaluarës dhe ku ndërtimi i paqes dhe pajtimi janë thellësisht të rrënjosura në shoqëri. Kurse nxitja për reforma erdhi nga palët e interesuara ndërkombëtare, aktorët vendas ende përpiqen për pronësinë e procesit si një mënyrë për ta çuar atë më tej. Janë bërë hapa, por rezultatet ende nuk janë parë. (*Proceedings of the 4th International Barcelona Conference on Higher Education, Vol. 5.* <http://www.guni-rmies.net>.) (Tahirsylaj, 2008)).

Në IAL-të publike ka mungesë të theksuar të stafit me tituj adekuat shkencor, me kualifikime e profile të nevojshme për lëndët që ata ose ato zhvillojnë dhe ligjërojnë.

“Bazuar në të dhënat e njohura e të verifikuara nga Agjencia për Akreditim, duke përjashtuar deri në një masë të caktuar Universitetin e Prishtinës, rezulton se kjo situatë është shqetësuese. Problematika e mungesës së profilit pedagogjik e shkencor është faktor thelbësor në ngecjet për sigurimin e cilësisë”, thuhet në raport.

Për mungesë të së paku të tre pedagogëve me titull doktor shkence (pa përfshirë këtu fare profilin tyre në relacion me programin) në vitin akademik 2017/2018 Agjencia për Akreditim kishte suspenduar 131 programe të institucioneve të arsimit të lartë publik dhe privat në Kosovë, shkruan gazeta inFokus (Zeqirja Shabani , Gazeta Infokus, 2018).

Sipas Tahirsylaj zhvillimet e përgjithshme politike janë pasqyruar edhe në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë. Universiteti i Prishtinës mbetet i kontrolluar plotësisht nga shqiptarët pa asnjë nxënës serb, por që mbledh studentë nga komunitetet e tjera lokale, si: boshnjake, turke, rome, egjiptiane dhe ashkali. Gjithashtu, UP ka bërë përpjekje për të filluar reformat e lidhura me Deklaratën e Bolonjës, edhe pse kjo nuk është zyrtarisht pjesë e procesit ende. Universiteti i Mitrovicës (universiteti në gjuhën serbe) gjendet në veri të Kosovës dhe është plotësisht i kontrolluar nga serbët dhe vepron sipas planprogrameve të universiteteve në Serbi. Nuk ka studentë shqiptarë, por mbledh nxënës nga komunitetet serbishtfolëse: boshnjake, gorane dhe rome.

(*Proceedings of the 4th International Barcelona Conference on Higher Education, Vol. 5.* <http://www.guni-rmies.net>.) (Tahirsylaj, 2008)

Prandaj duke marrë parasysh historinë e re të Kosovës ku gjatë viteve '90 u aplikua një aparteid nga ana e regjimit serb dhe luftën e viteve 1998-1999, për pasojë kanë ende ndarjet etnike edhe në sistemin e AL-së në Kosovë.

Kërkimi shkencor- Fillet e arsimit të lartë dhe shkencës në Kosovë datojnë qysh me hapjen e institucioneve të para shkencore-hulumtuese. Realisht institucionet e para janë ato hulumtuese dhe shkencore si pararendëse të institucioneve të arsimit të lartë siç janë:

Qendra e Studimeve Kosovare, themeluar në vitin 1943 në Prizren (Instituti i parë shkencor, prof. Selman Riza), Enti Veterinar Bakterologjik, themeluar në vitin 1946, (Instituti i Veterinarisë funksionon edhe sot), Instituti për Hulumtime Bujqësore në Pejë, themeluar në vitin 1949, Instituti Albanologjik i Prishtinës, themeluar në vitin 1953, pastaj ajo që mendohej si fillet e arsimit të lartë në Kosovë, SHLP në vitin 1958 e deri te akti i themelimit të Universitetit të Prishtinës më 1970, i cili më të drejtë konsiderohet si maja e arritjeve të asaj kohe.

Kosova si shteti me i ri në Evropë sa i përket kërkimit shkencor synon zhvillimin e shkencës dhe kërkimit shkencor përmes integritit në hapësirën evropiane të Kërkimeve Shkencore dhe në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

Ka të rregulluar kornizën ligjore për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore dhe Programin Kombëtar të Shkencës. Në këtë drejtim ka nxjerrë Ligjin nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore. Ky ligj definon mandatin dhe qëllimet e Programit Kombëtar të Shkencës ku dhe synon identifikimin e prioriteteve kombëtare shkencore, krijimin e kushteve për investime infrastrukturore, forcimin e pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare kërkimore-shkencore, si dhe përpunimin e një programi sistematik për arsimimin e hulumtuesve. Zbatimi Programit - përgjegjësi e Këshillit Shkencor të MASHT-it (Ligji 04/L-135, 2013).

Sipas "ISI web of knowledge" shihet qartë se Kosova renditet e fundit në listë sa i përket publikimeve shkencore, jo vetëm në krahasim me vendet e BE-së, por edhe në rajon (ISI Web of Knowledge, 2019). Megjithatë në tre vitet e fundit ka një progres të shumfishtë në publikime.

Numri i artikujve të publikuar në revistat e “ISI web of knowledge”			
Universitetet	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej
	Deri 1999	2016	Deri 2018
Universiteti i Prishtinës	191	156 (175)	1.288 (1.381)?
Universiteti i Tiranës	401	393	3.681
Universiteti i Shkupit	587	704	9.045
Universiteti i Zagrebit	43.041	3.886	71.750
Universiteti i Munihut	278.201	17.144	336.700
http://apps.webofknowledge.com , (ISI Web of Knowledge, 2019)			

Investimet për kërkime shkencore në Kosovë dhe fondi për shkencë është mjaft i limituar dhe mbete një sfidë edhe për një kohë të gjatë. Por megjithatë ndarja e një fondi të veçantë për shkencën nga qeveria tregon se Kosova gradualisht po hyn në grupin e shteteve që bëjnë shkencë – të shteteve që krijojnë dije të reja universale.

GDP-ja e Kosovës konsiderohet rreth 6 miliardë euro (5,98 sipas ASK-së) dhe sikur të ndiqej trendi i vendeve të zhvilluara për investime në kërkime shkencore p.sh. 2% nga GDP-ja për shkencë do të ishte: 120.000.000 euro, ndërsa 3% nga GDP-ja do të ishte: 180.000.000 Euro.

Sipas ligjit për shkencë do të duhej të ndahej 0.7% e buxhetit të shtetit që për vitin 2019 është 2.400.000.000 euro dhe rrjedhimisht 0.7%: do të ishte 14.800.000 euro (obligim ligjor), ndërsa në realitet Këshilli shkencor i MASHT-it për vitin 2018 në fondin për shkencë kishte të ndara 560.000 euro ose rreth 0.025% e buxhetit.

Thembra e Akilit e AL-së mbetet shpërputhja midis sistemit të AL-së në Kosovë dhe tregut të punës, gjë që është evidente dhe pranohet edhe nga MASHT-i. Edhe pse pohohet nga IAL-ja se programet e tyre janë të harmonizuara me ekonominë, të gjitha raportet dhe statistikat e dëshmojnë të kundërten, duke dhënë evidenca për numrin në rritje të të papunëve të diplomuar.

Po synohet dhe po punohet që përmes mbështetjes së Komisionit Evropian, projekteve bilaterale dhe multilaterale, veçanërisht Qeveria Austriake nëpërmjet projekteve, ndër ta ALLED2 të ndihmohet në uljen e këtij hendeku dhe të krijohen disa praktika të mira të harmonizimit me tregun e punës dhe ndërlidhjes me industrinë dhe nivelet paraprake të arsimit.

2.3.1 Legjislacioni, Politikat dhe Strategjitë e AL-së

2.3.1.1 Aspekti ligjor i AL-së në Kosovë

Politika në fushën e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës është e rregulluar me akte ligjore dhe nënligjore. Organizimi i sektorit të Arsimit të Lartë në Kosovë rregullohet me Ligjin për Arsimin e Lartë (Nr. 04 / L-037), i miratuar në gusht të vitit 2011. Sistemi i arsimit të lartë në Kosovë funksionon përmes universiteteve publike dhe institucioneve private të arsimit të lartë. E drejta për edukim është e përcaktuar sipas nenit 47 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Sipas nenit 47 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës “Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike.” Për më tepër “Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.”

Neni 2 i Ligjit për Arsimin e Lartë në Kosovë vendos parimet bazë mbi të cilat zhvillohet arsimi i lartë në Republikën e Kosovës.

Sipas këtij ligji, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë është përgjegjëse për planifikimin e zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë në konsultim me bartësit e akredituar të arsimit të lartë. Për më tepër MASHT-i është gjithashtu përgjegjës për krijimin e Agjencisë së

Akreditimit të Kosovës për nxitjen e cilësisë së institucioneve private të arsimit të lartë përmes proceseve të licencimit, inspektimit dhe akreditimit të realizuara me anë të metodave profesionale.

Në vitin 2013, MASHT-i kishte inicuar procesin e ndryshimit të ligjit për arsimin e lartë madje ligji ishte proceduar deri në Kuvendin e Kosovës, por ky i fundit do ta kthente mbrapa me sugjerimin për të ofruar mundësi për më shumë ndryshime thelbësore. Duhet të theksohet se procesi i rishikimit të Ligjit për Arsimin e Lartë është kritikuar për mungesë transparence, mospërfshirjen e aktorëve përkatës si dhe për mungesë të diskutimit adekuat publik. Një nga arsyt kryesore për nevojën e ndryshimit të ligjit për arsimin e lartë ka të bëjë me parandalimin e ndikimit në autonominë politike dhe akademike të universiteteve publike, duke sugjeruar që këto ndryshime të ndiqen me rishikimin e statuteve të universiteteve publike. Është më se e domosdoshme që ligji për arsimin e lartë në Kosovë duhet të ndryshohet, mirëpo një proces i tillë duhet të udhëhiqet me maturi dhe analizë të detajuar paraprake. Kjo për të shmangur nevojën që shpesh del të jetë prezente ku ligjet e sapomiratuara dhe ende pa hyrë në fuqi shfaqet nevoja e ndryshimit të tyre.

Vlen të theksohet fakti se arsimit të lartë në Kosovë i kushtohet kujdes në politikat qeveritare, por ka ngecje në zbatimin e politikave të përcaktuara, përfshirë Planin Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021. Këto ngecje nuk kanë të bëjnë vetëm me mungesën e buxhetit, por edhe me çështje të natyrës organizative, ku kërkohet një angazhim i veçantë për jetësimin e masave strategjike nga ana e MASHT-it, si dhe një shkallë e lartë koordinimi me institucionet e tjera të nivelit qendror e nganjëherë edhe me ato lokale (KEEN).

2.3.1.2 Qëllimet e Arsimit të lartë (politikat, strategjitë, orientimet programore)

Ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë përmes nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, krijimtarisë artistike, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit

është proklamuar si një nga objektivat e institucioneve shetërore (PSAK 2017-2021 MASHT, 2017).

Qëllimi i Ligjit të arsimit të lartë është krijimi i bazës ligjore për rregullimin, funksionimin, financimin, sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në përputhje me standardet evropiane, si dhe rolin e shtetit dhe shoqërisë në zhvillimin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës (Ligji Nr.04/L-037 përAL).

Ligji aktual për arsimin e lartë në Kosovë sikur edhe shumë ligje të tjera përveç anëve pozitive bart më vete edhe disa aspekte për të cilat vlerësojmë se pengojnë ecjen përpara të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.

Mbi bazën e një analizë të mirëfilltë kemi evidentuar disa nga zbrastësitë, të cilat i ka për momentin ligji për arsimin e lartë në Kosovë:

- Mungesa e standardeve adekuate dhe pse jo rigoroze e procesit të akreditimit të bartësve të arsimit të lartë, si atyre publike ashtu edhe atyre private;
- Miratimi i akteve nënligjore, të cilat burojnë nga Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë;
- Implementimi në mënyrë konsekuente i Ligjit për Arsimin e Lartë.

Arsimi i pasluftës në Kosovë sikur edhe shumë fusha të tjera fillimisht do të kalojë nëpër një periudhë jo të lehtë tranzicioni dhe do të rregullohet me akte ligjore të miratuara nga ana e Administratës së UNMIK-ut në Kosovë. Ligji për arsimin e lartë 2002/3, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 25 korrik 2002 dhe i shpallur nga PSSP-ja më 12 maj 2003 (Rregullorja e UNMIK-ut 2003/14), do t'i vendosë bazat ligjore për funksionimin e arsimit të lartë në Kosovë. Disa nga objektivat e arsimit të lartë të përshkruara me ligj janë “krijimi, zhvillimi, mbrojtja dhe transmetimi i njohurive përmes mësimdhënies dhe punës kërkimore e shkencore; ofrimi i mundësive për të gjithë banorët e Kosovës të aftë për të përfituar nga ky arsim gjatë gjithë jetës së tyre.” (GAP2008).

Sipas këtij ligji, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, përmes Udhëzimit Administrativ është përgjegjëse për planifikimin e zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë në konsultim me bartësit e akredituar të arsimit të lartë. Ministria e Arsimit është gjithashtu

përgjegjëse për krijimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës për nxitjen e cilësisë së institucioneve private të arsimit të lartë përmes proceseve të licencimit, inspektimit dhe akreditimit të realizuara me anë të metodave profesionale (GAP, 2008).

Sikur edhe në shumicën e ligjeve të tjera edhe ligji për arsimin e lartë, një pjesë të mirë të implementimit do ta lërë që ta përcaktojë me akte nënligjore, kështu me akt nënligjor të përcaktohet: licencimi i bartësve privatë të arsimit të lartë (neni 11.1); themelimi e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (neni 4.3); procedura për akreditim (neni 11.2); kryerja e vlerësimeve për cilësinë (neni 11.10); formati i diplomave (neni 12.7); përcaktimi i metodologjisë për caktimin e fondeve për institucionet private (neni 23.2), si dhe shumë udhëzime të tjera administrative.¹ Pikërisht duke u mbështetur në këtë ligj në shkurt të vitit 2004, MASHT-i do ta nxjerrë Udhëzimin Administrativ nr. 2004/11 për themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (AAK). Sipas këtij udhëzimi administrativ, Agjencia do të ushtrojë veprimtari të pavarur profesionale jofitimprurëse, që të nxisë cilësinë në arsimin e lartë të Kosovës (UA 11/2004 , p. Neni 2.1 dhe 2.2 i). Ligji i Arsimit të lartë nuk do të arrijë asnjëherë që të implementohet në mënyrë adekuate. MASHT-i nuk do të arrijë asnjëherë që të nxjerrë të gjitha aktet nënligjore të parapara me këtë ligj. Pikërisht si rezultat i kësaj MASHT-i do jetë në fokus të kritikave nga organizata të ndryshme prezente në Kosovë (OSBE.Rap.Implementimi i ligjeve te KS) .

Ligji i vitit 2003 do të shfuqizohet në vitin 2011 me miratimin e ligjit nr.04/L-037 për arsimin e lartë. Ligji i ri për arsimin do të përputhet me realitetin e ri në Kosovë, të krijuar asokohe me Pavarësinë e Kosovës. Si i tillë ky ligj do të bazohet në standarde shumë të avancuara, por që do të hasë në vështirësi të ndryshme për t'u zbatuar në praktikë.

Siç dihet AL është i lidhur ngushtë me veprimtarinë kërkimore-shkencore.

Kosova e ka të rregulluar kornizën ligjore për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore dhe Programi Kombëtar i Shkencës. Në këtë drejtim ka nxjerrë Ligjin nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore. Ky ligj definon mandatin dhe qëllimet e Programit Kombëtar të Shkencës ku synon identifikimin e prioriteteve kombëtare shkencore, krijimin e kushteve për investime

infrastrukturore, forcimin e pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare kërkimore-shkencore si dhe përpunimin e një programi sistematik për arsimimin e hulumtuesve. Propozohet nga Qeveria, miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i cili duhet të sigurojë fonde për realizimin e tij. Zhvillimi i Programit Kombëtar të Shkencës – është detyrë e Këshillit Kombëtar të Shkencës. Zbatimi Programit - përgjegjësi e Këshillit Shkencor të MASHT-it (Ligji04/L-135, 2013).

Objektivat kryesore të Programit Kombëtar të Shkencës janë:

Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore për veprimtari kërkimore-shkencore; zhvillimi i infrastrukturës kërkimore-shkencore; ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore; forcimi i lidhjeve midis shkencës, shoqërisë dhe ekonomisë; avancim në veprimtarinë kërkimore-shkencore; pjesëmarrjen shkencëtarëve kosovarë edhe në projektet ndërkombëtare shkencore.

Pengesë madhore në realizimin e këtij programi mbetet buxheti i limituar dhe mungesa e një sinergjie me investimet private në shkencë dhe kërkime shkencore.

2.3.1.3 Legjislacioni sekondare- Udhëzimet Administrative dhe rregulloret

Fushat që rregullojnë dhe analiza krahasuese me fokus në ato që merren me rregullimin e cilësisë dhe menaxhimit të AL publik dhe privat

Ekzistojnë një numër i caktuar i akteve nënligjore përmes të cilave implementohen politikat e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.

Udhëzimi administrativ nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë përcakton kompetencat e Agjencisë së Kosovës për Akreditim në procesin e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimeve. Kur analizohet në detaje ky akt nënligjor vërehet që ekzistojnë disa dispozita ligjore, të cilat në fakt është dashur të jenë pjesë e ligjit dhe jo që të njëjtat të përcaktohen me akt nënligjor. Përveç aspekteve procedurale dhe administrative, të cilat është më se e natyrshme të definojnë me akt nënligjor, aspektet e karakterit të përgjithshëm që kanë të bëjnë me procesin e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë duhet të përfshihen në kuadër të ligjit për arsimin e lartë.

Megjithatë një çështje tjetër që vlen të përmendet me këtë rast dhe që shfaqet si dukuri jo vetëm me rastin e ligjit për arsimin e lartë është fakti se paralel me Udhëzimin Administrativ nr.15/2018, ende është në fuqi Udhëzimi Administrativ nr.14/2003. Të dy këto udhëzime i referohen në një formë apo tjetër procesit të akreditimit të institucioneve private.

Ajo që nuk ka asnjë shpjegim logjik është fakti se si ka mundësi që ligji mbi të cilin është miratuar Udhëzimi Administrativ 14/2003, është shfuqizuar me rastin e miratimit të ligjit të ri për arsimin e lartë në vitin 2011, ndërsa vetë Udhëzimi Administrativ vazhdon të mbetet në fuqi duke pasur për bazë ligjin e shfuqizuar. Po e themi edhe njëher një dukuri e tillë është prezente pothuajse në secilën fushë të arsimit në Kosovë.

Por t'i kthehemi edhe njëherë Udhëzimit Administrativ nr.14/2003. Sipas këtij udhëzimi për licencimin e bartësve të arsimit të lartë, nuk janë specifikuar qartë kriteret për licencimin e bartësve privatë të arsimit të lartë dhe për më tepër kriteret prezente janë më tepër të karakterit subjektiv. Kriter i një rëndësie të veçantë për licencim është edhe lista e profesorëve dhe kualifikimet e tyre, të cilat duhet t'i dorëzohen MASHT-it. Dispozitat ligjore të këtij Udhëzimi Administrative nuk e specifikojnë se cili duhet të jetë proporcioni i profesorëve me diploma (Këtu mendohet kryesisht diploma të studimeve të doktoraturës, vërejtje e autorit), apo hapësira specifike e objektit të bartësve privatë, nuk ka ndonjë numër të dhënë për klasa të ligjëratave dhe amfiteatrove në proporcion studentë- klasë, bibliotekë me inventar dhe numër të pasur të librave të fushave të ndryshme, laboratore dhe pajisje të nevojshme të punës.

Një anomali ligjore e llojit të vet ndodh edhe me vetë procesin formal të akreditimit të institucioneve private të arsimit të lartë në Kosovë. Ekzekutivi i vendit përkatësisht MASHT-i në mënyrë permanente shkel dispozitat ligjore gjatë procesit të akreditimit, pasi sipas legjislacionit në fuqi akreditimi duhet të bëhet nga Agjensioni për Akreditim i Kosovës e jo nga MASHT-i. Në aspektin formal-juridik Ligji e parasheh që procesi i akreditimit i takon Agjensionit për Akreditim ndërsa, ai për licencim i takon MASHT-it (Rap ÇOHU).

Një problem tjetër më vete është "paaftësia" e zyrtarëve shtetërorë të MASHT-it për ta bërë dallimin në mes të procesit të licencimit dhe atij të akreditimit. Në aspektin e përgjithshëm procesi i "licencimit" nënkupton marrjen e lejes apo autorizimit për leje pune dhe proces që duhet t'i paraprijë procesit të akreditimi. Ministria ka ngecur edhe në metodologjinë e përdorur

për vlerësimin e këtyre institucioneve, duke bërë pyetësorë që nuk janë adekuat dhe nga i cili nuk mund të nxirrej një vlerësim rreth përmbushjes së obligimeve të këtyre institucioneve dhe për gjendjen ekzistuese të tyre (Rap.Monitorim i Procesit të Licencimit dhe Akreditimit të BPrAL, pp. 8-9).

Ekzistojnë edhe një numër i akteve nënligjore (udhëzimeve administrative), të cilat janë të miratuara e që janë në funksion të zbatimit të Ligjit për Arsimin e Lartë. Një pjesë janë të nxjerra mbi bazën e ligjit të vitit 2003, ndërsa një pjesë tjetër mbi bazën e ligjit për arsimin e lartë të miratuar në vitin 2011.

Një prej udhëzimeve administrative nr.02/2013 mbi akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, përcaktohen kërkesat dhe procedurat për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Pikërisht me këtë udhëzim vendosen kushtet që duhen plotësuar nga institucione që synojnë procesin e akreditimit. Gjithashtu ky akt nënligjor e mbulon një zbrastësi juridike që ka ekzistuar nga fillimi i zbatimit të ligjit të parë për Arsimin e Lartë në Kosovë (pra ligjit të vitit 2003) dhe ajo është vendosja e kriterëve për vlerësimin e cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë (UA 02/2013).

Por me gjithë vendosjen e këtyre kriterëve tanimë me akt nënligjor, vlen të theksohet fakti se në aspektin praktik këto kriterë pothuajse është e vështirë që me përpikëri të plotësohen nga institucionet e arsimit të lartë në Kosovë.

Mungesa e një akti nënligjor për vendosjen e kriterëve bazë për emërimin apo zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë si dhe në të njëjtën kohë mungesa e një dispozite ligjore, e cila do të përcaktojë mundësinë e shkarkimi të tyre nga ana e MASHT-it, ka qenë një çështje që e ka vendosur vazhdimisht MASHT-in në qendër të kritikave të mekanizmave të ndryshëm, qofshin vendorë apo edhe ndërkombëtarë. Përfundimisht për t'i dhënë përgjigje kësaj çështjeje, MASHT-i në vitin 2018 do ta miratojë Udhëzimin Administrativ nr.06/2018 për kriteret dhe procedurat e emërimit të anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Për t'i dhënë një dimension më "gjithëpërfshirës" dhe transparent, me këtë akt nënligjor përbërja e KSHCAKA-së do të jetë nga gjashtë anëtarë vendorë dhe 3 anëtarë ndërkombëtarë. Gjithashtu promovohen vlerat e pëfshirjes së të dy gjinive në përbërjen e Këshillit, duke u garantuar 3 vende anëtarë për gjininë e kundërt.

Komisioni Evropian në vlerësimin e tij vjetor për progresin e Kosovës në agjendën e integritimeve evropiane gjithsesi që një vend të posaçëm i ka kushtuar edhe politikës së arsimit. Ajo që vihet në dukje dhe pothuajse si frazë që është përsëritur nga njëri raport vjetor te tjetri është që *“sistemi arsimor i Kosovës vazhdon të jetë i prekur nga kufizimet e resurseve njerëzore dhe kufizimet e buxhetit”*.

Ky është një indikacion shumë i rëndësishëm për të kuptuar edhe sot që në arsimin e lartë sikur edhe në fushat e tjera të arsimit dy dalin të jenë problemet kryesore buxheti i kufizuar dhe resurset akademike adekuate.

2.4 Praktikrat për menaxhimin e cilësisë në AL

2.4.2 Korniza e Kosovës për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë

MASHT-i është përgjegjës për planifikimin e zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë. MASHT-i është gjithashtu përgjegjës për licencimin e institucioneve të arsimit të lartë, ndërsa AKA-ja është institucioni që kryen vlerësimin e jashtëm të cilësisë. AKK-ja është përgjegjëse për zhvillimin strategjik dhe mirëmbajtjen e KKK-së, duke përfshirë të gjitha llojet e kualifikimeve, duke përfshirë nivelet 6, 7 dhe 8. MASHT-i, përmes Qendrës Kombëtare për njohje dhe informim akademik (NARIC), e themeluar në vitin 2008, është përgjegjës për zhvillimin e politikave dhe praktikave për njohjen e kualifikimeve të fituara jashtë shtetit dhe dhënien e këshillave dhe informacioneve në lidhje me njohjen akademike të diplomave të lëshuara në vende të tjera. Vendimet për njohjen e kualifikimeve të fituara jashtë vendit bëhen nga Këshilli Kombëtar për Njohje, i cili përbëhet nga shtatë anëtarë: një udhëheqës/përfaqësues nga zyra NARIC dhe gjashtë ekspertë të brendshëm (p.sh. MASHT-i), si dhe ekspertë të jashtëm me përvojë relevante në arsimin e lartë ndërkombëtar dhe në procesin e Bolonjës. Në vitin 2008 MASHT-i ka themeluar edhe Këshillin Shtetëror të Arsimit të Lartë, një këshill ekspertësh me një rol këshillues, i cili ofron këshilla për reformat arsimore në arsimin e lartë. (AKK, Raporti i referencimit të KKK me KEK, 2016, p. 25)

Në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë, MASHT-i ka themeluar Agjencinë e Kosovës për Akreditim, e cila përbëhet nga një organ profesional dhe një organ administrativ. Këshilli Kombëtar i

Cilësisë (KKC) është organ qeverisës, i cili ka përgjegjësinë e përgjithshme për funksionimin e AKA-së.

Ndër përgjegjësitë kryesore të KKC-së janë: (a) përcaktimi i objektivave të procesit të vlerësimit të institucioneve të arsimit të lartë, (b) miratimi i procedurave dhe kriterëve të vlerësimit të jashtëm, të hartuara nga AKA-ja, (c) krijimi i grupeve profesionale të vlerësimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL), (d) marrja e vendimeve për akreditimin bazuar në raportet e ekipeve profesionale të vlerësimit (AKK, Raporti i referencimit të KKK me KEK, 2016, p. 26).

Funksionet e Organit Administrativ- AKA së, janë: (a) të përcaktojnë standardet dhe procedurat e akreditimit, (b) të lëshojë rekomandime për IAL-të, të cilat aplikojnë për akreditim të institucionit, ose të programit dhe (c) t'i japë rekomandime MASHT-it për licencimin e IAL-ve.

AKA-ja është bërë gjithashtu një anëtare e Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë për Arsimin e Lartë (ENQA).

Inspektorati i Arsimit në kuadër të MASHT-it ka një rol të rëndësishëm në ngritjen e cilësisë së AL-së, nëpërmjet inspektimeve të rregullta informative, speciale, kontrolluese dhe emergjente që kryhen në mbështetje të planit vjetor të Inspektoratit të Arsimit, kurse ato emergjente e speciale në bazë të kërkesave të organeve dhe palëve të interesuara që janë të rregulluara sipas nenit 4 të Ligjit për Inspeksionin e Arsimit i nxjerrë më 8 shtator 2004 dhe të amendementuar në vitin 2018.

Ky institucion nëpërmjet fushëveprimit të vet synon ta menaxhojë me efikasitet mbarëvajtjen e punës së IAL-ve.

Përveç asaj që u cek më lart, nuk ekziston një kornizë e qartë nacionale për sigurimin e cilësisë së AL-së, por sistemi është i bazuar në udhëzuesit (ESG) e ENQA-së që kryesisht nxiten nga AKA-ja gjatë procesit të akreditimit të IAL-ve. Ekziston një autonomi ndoshta e keqpërdoruar nga ana e IAL-ve sa i përket zhvillimit të mekanizmave të sigurimit të brenshëm të cilësisë dhe që nuk ka procedura të unifikuara dhe të sqaruara në plotni.

2.4.3 Modelet ekzistuese- kurrikula, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimi i studentëve

Kurrikulat - në shumicën e institucioneve të arsimit të lartë për studimet Bachelor organizohen në çdo 3 vjet dhe vetëm në pak raste në 4 vjet. Programet BA që Universiteti i Mitrovicës ofron, zgjasin 4 vjet. Kurrikula e IAL-ve vlerësohet dhe akreditohet vazhdimisht nga Agjencia e Akreditimit. Të gjitha kurrikulat tregojnë qartë numrin e lëndëve të detyrueshme, numrin e lëndëve zgjedhore, numrin e orëve mësimore dhe ushtrimeve, numrin e ECTS, llogaritjen e ECTS dhe emrat e profesorëve. Po ashtu të gjitha IAL-të duhet të përshkruajnë qartë rezultatet e mësimi për çdo modul (Overview of the Higher Education System, Kosovo Erasmus+ Office , p. 13).

Metodat e mësimdhënies - Në përgjithësi ekziston kërkesa që metodat e mësimdhënies të përshkruhen qartë për çdo modul kur IAL-të i nënshtrohen vlerësimit të jashtëm nga Agjencia e Akreditimit. IAL-të duhet të përshkruajnë metodat e mësimdhënies dhe mësimi, metodat e vlerësimit dhe kriteret për të kaluar, raportin midis pjesës teorike dhe praktike të mësimdhënies dhe literaturës bazë që do të përdoret në secilin modul. Në universitetet publike, në bazë të rregullave të brendshme, ligjëratat organizohen në grupe të mëdha (në ato programe studimi që lejojnë për Fakultetin Juridik) të studentëve ose grupeve të vogla me së paku tetë nxënës (p.sh. Fakulteti i Mjekësisë). Në kolegjet private, nxënësit ndahen në grupe më të vogla që përbëhen nga maksimumi 30 studentë. Lëndët jepen përmes leksioneve, ushtrimeve, punës në klasë, prezentimeve dhe seminareve (Ibid).

Vlerësimi i Studentëve - Metodatat e vlerësimit zakonisht përshkruhen në çdo program lëndor dhe u dërgohen studentëve gjatë javës së parë të semestrit. Format më të zakonshme të vlerësimit të studentëve janë provimet. Sidoqoftë, mund të organizohen provime të ndarë në 50% në testet dhe të merren në konsideratë elementë të tjerë, si pjesëmarrja e studentëve me zakonisht 10%, prezantimi i eseve me zakonisht 20%; seminare me zakonisht 20%. Nivelet e studentëve vlerësohen nga notat 5 (dështuar) deri në 10 (të shkëlqyera) (Po aty, p.14). Është me rëndësi të thuhet se zakonisht në pothuajse shumicën e silabuseve gjen përshkrim të përsëritur të mënyrës së vlerësimit të studentëve, e cila trajtohet si diçka mjaft teknike dhe jo si një tërësi elementesh metodike për vlerësim. Në përfundim të studimeve studentët marrin

diplomën e tyre, duke përfshirë të gjitha informatat që kanë të bëjnë me programin e studimeve të ndjekura, diplomën akademike, ECTS arritur, nivelin e KKK-së. Studentët gjithashtu mund të marrin shtojca të diplomave (diploma supplement). Të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Kosovë kanë Zyrat e tyre për Sigurimin e Cilësisë dhe sistemi i tyre i sigurimit të cilësisë përcaktohet me rregullore. Ato janë të hapura për vlerësimi nga AKA-ja.

2.4.4 Sigurimi i Cilësisë në procedurat e pranimit të studentëve- Cilësia Funksionale

Kriteret e pranimit të studentëve janë të përcaktuara me ligj dhe statut të IAL-ve.

Pas mbarimit të shkollës së mesme të gjithë nxënësit duhet t'i nënshtrohen provimit të maturës, i cili rregullohet me Ligjin për Provimet Përfundimtare dhe Provimin e Maturës Shtetërore. Studentët që me sukses e kalojnë provimin e maturës kanë të drejtë të hyjnë në arsimin e lartë.

Të gjitha universitetet publike organizojnë provime pranimi që zakonisht organizohen në dy afate kohore, në qershor dhe në shtator (kjo e fundit zbatohet vetëm për njësitë akademike të universiteteve që nuk kanë arritur kuotën e studentëve të paraparë).

Kuotat e studentëve janë propozuar nga universitetet dhe miratohen nga MASHT-i. Renditja e nxënësve bazohet në provimin e maturës dhe në bazë të rezultateve të provimeve.

Vetëm disa institucione private të arsimit të lartë organizojnë provime pranimi. Zakonisht studentët pranohen në studimet bachelor vetëm pas përfundimit të suksesshëm të provimit të maturës. Kuotat përcaktohen nga vetë IAL-të në shumicën e rasteve, përveç nëse numri i studentëve është i kufizuar nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës në fusha të caktuara si Arkitektura ose Mjekësia (Overview of the Higher Education System, Kosovo Erasmus+ Office , p. 13). Vlen të theksohet se shumica e IAL-ve private regjistrimet i bëjnë deri në tetor, duke pritur të përfundojë afati i shtatorit i regjistrimeve në IAL-të publike dhe të mbledhin nxënësit që nuk ia kanë dalë që të regjistrohen aty.

2.4.5 Shërbimet për zhvillimin dhe përkrahjen e studentëve

IAL-të gjithashtu kanë zyra karriere dhe zyra informacioni që u japin studentëve informacion rreth studimeve të tyre. Zyrat e Sigurimit të Cilësisë janë zyrat përgjegjëse për të organizuar

anketime dhe vlerësime të tjera për studentët dhe stafin akademik, rezultatet e të cilave shërbejnë për të përmirësuar më tej cilësinë.

Udhëzime Akademike - Çështjet akademike në shumicën e institucioneve të arsimit të lartë rregullohen nga statutet ose nga rregulloret për studimet akademike. IAL-të ofrojnë udhëzime akademike për studentët për përgatitjen e tezës BA ose MA, ose për punime dhe dokumente të tjera.

Këshillimi Psikologjik nuk ka këshilla psikologjike formale ose të njohura të ofruara në IAL-të në Kosovë.

Orientimi dhe këshillimi për karrierë - Jo të gjitha njësitë akademike në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë kanë zyrat e tyre të karrierës. Megjithatë shumica e IAL-ve ofrojnë një gamë të gjerë të mbështetjes dhe ndihmës për studentët e diplomuar. Zyrat ofrojnë kurse të ndryshme që u mundësojnë atyre të përgatiten në mënyrë profesionale dhe të bëhen të aftë për të kërkuar punë. Deri më tani, aktivitetet e zyrave të karrierës kanë qenë të bazuara në zyra dhe në internet.

Mobiliteti i studentëve dhe ndërkombëtarizimi- Një nga tetë parimet në të cilat bazohet arsimi i lartë në Kosovë bën thirrje për fokus evropian dhe ndërkombëtar të arsimit të lartë dhe promovimin e mobilitetit të studentëve dhe stafit. IAL të synuara në PSAK bëjnë gjithashtu një referencë të veçantë për ndërkombëtarizimin, duke ofruar programe ndërkombëtare të studimit dhe promovimin e mobilitetit të stafit dhe studentëve (PSAK 2017-2021 MASHT, 2017).

Kosova merr pjesë në skemat e mobilitetit evropian si Programi i Shkëmbimit të Evropës Qendrore për Studentët e Universitetit (CEEPUS), Tempus, Erasmus Mundus dhe Erasmus + Learning Mobility, si dhe përfiton nga forma të ndryshme të mbështetjes dypalëshe dhe shumëpalëshe. Sidoqoftë, mundësitë për lëvizshmëri të stafit dhe studentëve mbeten të kufizuara.

Pengesat kryesore për mobilitet në largim janë numri i kufizuar i bursave në dispozicion, kërkesat e vizave dhe njohuritë e pamjaftueshme të anglishtes midis stafit akademik dhe studentëve. Për mobilitet hyrës, pengesa kryesore është çështja e gjuhës. Për shembull,

studentët e Kosovës kanë përfituar vetëm 331 nga 4,163 mobilitete të financuara nga Programi Erasmus Mundus në shtatë vendet e Ballkanit Perëndimor; nga ana tjetër Kosova priti vetëm 5 nga 398 mobilitetet e shtetasve të BE-së në vendet e Ballkanit Perëndimor. (Overview of the Higher Education System, Kosovo Erasmus+ Office)

Një raport më i mirë i lëvizjeve dalëse dhe hyrëse arrihet në CEEPUS, ku në pesë vjet, 58 persona nga stafi dhe studentët e Kosovës kanë përfituar nga mobiliteti në vendet pjesëmarrëse, ndërsa Kosova ka pasur 46 mobilitete hyrëse.

2.6 Sigurimi i jashtëm i cilësisë

2.6.1 Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) është themeluar në pajtim me Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Kosovë në mars të vitit 2008 nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) (Ligji nr.2002/03, 2003)).

AKA-ja duhet të garantojë sigurimin e jashtëm të cilësisë së punës arsimore dhe kërkimore-shkencore në Institucionet publike dhe private të arsimit të lartë në Kosovë, si një institucion i pavarur për akreditimin dhe riakreditimin e BPPAL për një periudhë të caktuar kohore.

Roli i saj primar është që, përmes procesit të akreditimit, të përkrahë zhvillimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë dhe gjithashtu, përmes punës së saj transparente dhe profesionale, duhet ta sigurojë shoqërinë dhe ekonominë se cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies është krahasueshme me standardet ndërkombëtar (AKA <http://www.akreditimi-ks.org>2018, 2018).

Përgjegjësitë primare të AKA-së janë që krahas akreditimit të institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë, ta bëjë akreditimin e programeve të tyre dhe programeve të reja në institucionet e akredituara, si dhe të ushtrojë në vazhdimësi kontroll të cilësisë në institucionet e akredituara. Sistem i akreditimit duhet të jetë i besueshëm, transparent dhe ndërkombëtarisht i krahasueshëm, duke promovuar aplikimin e kompetencave kombëtare dhe

ndërkombëtare në fushën e akreditimit. Me qëllim të realizimit të këtyre përgjegjësi, AKA-ja zhvillon bashkëpunim të përhershëm në lëmin e sigurimit të cilësisë në rrafshin evropian dhe global (Po aty).

Krahas promovimit dhe sigurimit të cilësisë në IAL, AKA-ja ka për qëllim të përkrahë konkurrencën dhe hapjen e sektorit të AL-së për ofertues vendorë dhe të huaj në interes të studentëve, ekonomisë dhe shoqërisë, duke nxitur ide dhe nisma inovative në arsimin e lartë. Qëllim tjetër shumë i rëndësishëm është siguri i krahasueshmërisë së diplomave të lëshuara nga bartësit e arsimit të lartë kosovar me diplomat e lëshuara në nivel ndërkombëtar, duke nxitur njohjen dhe integrimin e AL-së të Kosovës në hapësirën evropiane të arsimit të lartë dhe duke kontribuar aktivisht në zhvillimin e saj (Po aty).

Po ashtu në rrafsh kombëtar synon të mbajë komunikim të vazhdueshëm me IAL-të, mësimdhënësit dhe studentët e tyre, por edhe me opinionin publik dhe vendimmarrësit politikë përmes informimit të tyre të qartë dhe me kohë.

Përcjell në vazhdimësi zhvillimet arsimore në vend dhe në Evropë, të cilat i shoqëron me përditësim të informatave, duke hartuar rregulla dhe procedura të bazuara në standarde dhe kritere për vlerësim, e të cilat i publikon dhe i ndan me publikun.

Çka është akreditimi dhe cilat janë funksionet kryesore të tij?

Sipas AKA-së (AKA, 2018) akreditimi është një procedurë formale dhe transparente e kontrollimit të cilësisë, ku një organ i pavarur në bazë të standardeve të definuara dhe ndërkombëtarisht të njohura, vërteton nëse institucionet e arsimit të lartë përkatësisht programet e tyre të studimeve i përmbushin kërkesat minimale të cilësisë.

Akreditimi garanton shoqërinë dhe të gjithë akterët e tjerë se cilësia e mësimdhënies dhe e studimit i përmbush standardet minimale ndërkombëtare, duke e rritur transparencën në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të arsimit. Pastaj përmes procedurave të akreditimit merret vendimi për statusin dhe njohjen për një kohë të caktuar të institucioneve dhe programeve të studimit të ofruara nga IAL-të. Është shumë më rëndësi të potencohet se AKA-ja ushtron funksionin e mbrojtjes së studentëve nga ofertat e paverifikuara më vulën e cilësisë duke sjellë transparencë dhe krahasueshmëri dhe duke rritur mundësitë e zgjedhjes në tregun e

arsimit dhe të punës si në vend, ashtu edhe jashtë. Pra krijon bazën për konkurrencë lojale dhe të drejtë në mes të institucioneve të akredituara publike ose private të arsimit të lartë në vend. Gjithashtu lehtëson mobilitetin ndërkombëtar përmes njohjes së dyanshme të studimeve dhe përmirësim i mundësive të të diplomuarve në tregun europian të punës (Po aty).

2.6.2 Praktika aktuale e sigurimit të jashtëm të cilësisë

Procedura e akreditimit sipas AKA-së janë të bazuara në standarde ndërkombëtare të shtrirë në katër hapa kryesorë:

- Vlerësimi i brendshëm - vetëvlerësimi i institucionit që është subjekt i procesit të vlerësimit të cilësisë, që rezulton me dorëzimin e raportit të vetëvlerësimit;
- Vlerësimi i jashtëm nga një grup ekspertësh dhe vizita në vend (në institucionin që vlerësohet) siç parashihet nga Agjencia;
- Marrja e vendimit për akreditim nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë;
- Plani i përmirësimit në dritën e rekomandimeve të dhëna nga ekipi i ekspertëve të vlerësimit.

Të gjithë këta hapa janë të shoqëruara me procedura që kalojnë nëpër dhjetë faza si në vijim:

1. Këshillimi
2. Prezentimi i projektit
3. Aplikimi
4. Kompletimi
5. Vizita e ekspertëve të jashtëm në institucion
6. Raporti i ekspertëve
7. Qëndrimi i institucionit
8. Vendimi i KSHC-së
9. Shpallja zyrtare e akreditimit
10. Shpenzimet (AKA, 2018)

Gjatë procesit të akreditimit institucioni arsimor që konkurren mbulon të gjitha shpenzimet e procedurës së akreditimit, duke përfshirë edhe shpenzimet për ekspertë, sipas legjislacionit në fuqi.



Tabela 6

Paraqitja grafike e procedurave të akreditimit




Tabela 7

Paraqitja grafike e procedurave për riakreditimit

Burimi: www.akreditimi-ks.org

Sipas ligjit, AKA-ja obligohet t'i publikojë konkluzionet, rekomandimet dhe këshillat.

AKA-ja përbëhet nga një organ profesional dhe një organ administrativ. Këshilli Kombëtar i Cilësisë (KKC) është organ qeverisës, i cili ka përgjegjësinë e përgjithshme për funksionimin e AKA-së.

Ndër përgjegjësitë kryesore të KKC-së janë: (a) përcaktimi i objektivave të procesit të vlerësimit të institucioneve të arsimit të lartë, (b) miratimi i procedurave dhe kriterëve të vlerësimit të jashtëm, të hartuara nga AKA-ja, (c) krijimi i grupeve profesionale të vlerësimit të institucioneve të arsimit të lartë (IAL), (d) marrja e vendimeve për akreditimin bazuar në raportet e ekipeve profesionale të vlerësimit.

Funksionet e organit administrativ- AKA së, janë: (a) të përcaktojë standardet dhe procedurat e akreditimit, (b) të lëshojë rekomandime për IAL-të, të cilat aplikojnë për akreditim të institucionit, ose të programit dhe (c) t'i japë rekomandime MASHT-it për licencimin e IAL-ve.

AKA-ja është bërë gjithashtu një anëtare e Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë për Arsimin e Lartë ENQA (AKK,Raporti i referencimit te KKK me KEK, 2016, p. 25).

Institucionet e akredituara të arsimit të lartë në Kosovë

Institucionet publike të arsimit të lartë:

1. Akademia e Kosovës për Siguri Publike
2. Fakulteti i Studimeve Islame
3. Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani"
4. Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka"
5. Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"
6. Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka"
7. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
8. Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"
9. Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj

Institucionet private të arsimit të lartë:

1. Akademia Evolucion
2. Kolegji AAB
3. Kolegji Arbëri
4. Kolegji AUK
5. Kolegji Biznesi
6. Kolegji Dardania
7. Kolegji ESLG
8. Kolegji FAMA
9. Kolegji Globus
10. Kolegji Heimerer
11. Kolegji i Shkencave Mjekësore “Rezonanca”
12. Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike “Tempulli”
13. Kolegji Iliria
14. Kolegji ISPE
15. Kolegji Juridica
16. Kolegji “Pjeter Budi”
17. Kolegji Riinvest
18. Kolegji UBT
19. Kolegji Universi
20. Kolegji Universum
21. Kosovo Art Academy

Për herë të parë pas shumë vitesh të funksionimit të AKA-së është themeluar Komisioni për ankesa i AKA-së. Ky komision është themeluar duke u bazuar në nenin 22 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), në Udhëzimin Administrativ nr. 16/2018 për plotësimin dhe ndryshimin e UA për Akreditim nr. 15/2018, datë 28.11.2018 dhe në vendimin nr.499/01B më 11.11.2018. Komisioni i përkohshëm për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit për ankesa në AKA më 20.11.2018 ka marrë vendim për emërimin e anëtarëve të komisionit për ankesa të

AKA-së. Sipas këtij udhëzimi emërohen tre anëtarët e përhershëm të komisionit për ankesa të AKA-së dhe dy anëtarët alternativë/rezervë të komisionit për ankesa të AKA-së.

Puna e tij është trajtimi i ankesave të IAL-ve, dhe ky proces përveç që përbën përmbushjen e një kriteri shumë të rëndësishëm për rivlerësim nga ENQA-ja dhe EQAR-i, dëshmon rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së AKA-së, përmes ofrimit të mundësive të palëve për ankesë ndaj vendimeve të KSHC-së (UA Nr.15/2018, 2018).

Mirëpo përpos vlerësimit me ekspertë në këtë vit dhe tërheqjes së disa vendimeve për akreditim në bazë të vlerësimit të stafit akademik, AKA-ja nuk ka bërë asnjë veprim në drejtim të monitorimit, nuk ka rritur resurset e saj njerëzore dhe nuk ka investuar në fusha të tjera që janë të nevojshme për funksionimin e agjencisë. Në vitin e fundit, AKA-ja ka shkëputur komunikimin me IAL-të, që janë palët kryesore të interesit për procesin e akreditimit dhe në këtë mënyrë palët gjithnjë e më pak po janë të informuara për procesin e vendimmarrjes së AKA-së. Sipas mendimit tonë nuk mjafton bërja e procesit të akreditimit transparent përmes medieve dhe shoqërisë civile, sepse transparenca fillimisht fillon me IAL-të. Vendimet e akreditimit afektojnë fillimisht IAL-të, pastaj shoqërinë e gjerë.

AKA-ja gjatë vitit 2018, për shkak të mungesës të së paku tre pedagogëve me titull doktor shkence (pa përfshirë këtu fare profilin tyre në relacion me programin) në vitin akademik 2017/2018 ka suspenduar 131 programe të institucioneve të arsimit të lartë publik dhe privat në Kosovë. Këshilli Shtetëror i Cilësisë së Agjencisë së Kosovës për Akreditim mori këtë vendim për suspendim të pas procesit të riakreditimit të këtyre institucioneve. Kjo gjendje vazhdon edhe më tutje dhe rreziku për mosriakreditim është i lartë. Prandaj është mjaft e theksuar mungesa e titujve shkencorë dhe akademikë e stafit, me kualifikime e profile të nevojshme për lëndët që ata ose ato zhvillojnë dhe ligjërojnë. Bazuar në të dhënat e verifikuara nga Agjencia për Akreditim, duke përfshirë deri në një masë të caktuar Universitetin e Prishtinës, rezulton se kjo situatë është shqetësuese. Problematika e mungesës së profilit pedagogjik e shkencor është faktor thelbësor në ngecjet për sigurimin e cilësisë.

Prandaj, për shkak të situatës së theksuar mësipër përkatësisht mungesës e së paku të tre pedagogëve me titull doktor shkence, rreziku për mosriakreditim të IAL-ve mbetet prezent edhe për një kohë të gjatë.

Mosharmonizimi i programeve studimore në të gjitha nivelet me nevojat e tregut të punës në vend e më gjerë, është njëri ndër problemet më serioze më të cilat ballafaqohen institucionet arsimore publike universitare. IAL-të nuk kanë krijuar mekanizma të qëndrueshëm për të parashikuar, ndierë dhe analizuar ndryshimet shoqërore që duhet të përkthehen në programe studimore.

Problem tjetër janë programet e përsëritura dhe identike të IAL-ve. Në shumë raste IAL-të publike dhe private kanë arritur të akreditojnë programe me formë dhe përmbajtje të njëjta.

KAPITULLI III

3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

3.1 Popullata dhe kampioni

Në këtë hulumtim të dhënat e mbledhura janë primare dhe sekondare. Të dhënat primare janë të dhënat që janë mbledhur nga autori i hulumtimit. Këto të dhëna janë mbledhur përmes metodës së *grup fokusit eksplorues* me ekspertët e arsimit për të kuptuar çështjet më të rëndësishme që i shohin ata sa i përket administrimit dhe menaxhimit të cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë gjatë periudhës 2000-2019. Përmes metodës së intervistave gjysmë të strukturuar me përgjegjësit, bërësit e politikave dhe menaxhuesit e arsimit të lartë, intervista me përgjegjësit e zyrave për sigurimin e cilësisë si dhe me drejtorin e AKA-së.

Pastaj anketimi me pyetësorë të strukturuar me studentët e IAL-ve publike dhe private. Anketimi në kuadër të këtij hulumtimi përbën një pjesë shumë të rëndësishme të kërkimit shkencor me anë të instrumenteve të njëjta dhe të standardizuara (pyetësorëve, shkallëzimeve) etj., ku studentët janë anketuar për temën në fjalë si bindje apo qëndrim i të anketuarve lidhur me temën duke mbledhur në këtë mënyrë të dhëna parësore .

Pra, të dhënat parësore janë “Ato të dhëna që hulumtuesi apo një pjesëtar i ekipit tonë i mbledh drejtpërsëdrejti” (Jashari P. D., 2014) (Leksionet e dhëna në lëndën: Metodatat e Kërkimit, me Prof. dr. Hasan Jashari, datë: 29. 11. 2014, vendi: Universiteti i Evropës Juglindore).

Në të dhënat sekondare janë përfshirë publikimet nga MASHT-i, organizatat dhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare që i referohen arsimit (Banka Botërore, Komisioni Evropian, ENQA, OECD,) etj. Pra, të dhënat dytësore janë “të dhëna të mbledhura nga dikush tjetër - që nuk është pjesë e ekipit tonë” (Po aty). Po ashtu, janë përfshirë edhe publikimet e programeve dhe projekteve për arsim që janë implementuar në Kosovë gjatë periudhës që e mbulon hulumtimi apo edhe më herët. Veçanërisht, do të merren në analizë publikimet e projekteve të Bashkimit Evropian, Komisionit Evropian (përmes IPA-s , Tempus-it etj), si dhe organizatave të tjera ndërkombëtare etj.

Përshtypjet e menaxhmentit dhe profesoratit lidhur me cilësinë dhe arritjet - nuk janë pjesë e studimit. Mendimi i ekspertëve është pjesë e verifikimit dhe e dhënies së mendimit.

Fokusi kryesor është mendimi dhe perceptimi i studentëve për procesin, për institucionin dhe për rolin e tyre, dhe ku e shohin rolin e tyre pas studimeve, që jep një perspektivë të studentit mbi gjendjen e AL-së.

Meqë ky është hulumtimi i parë i këtij lloji i IAL-ve në fokus, që kanë histori dhe gjenezë të ndryshme, përvoja të ndryshme dhe natyrshëm entuziazmi i studentëve supozohej se është i ndryshëm. Kategoria e IAL-ve publike apo private dhe marrëdhënia kontraktuale e studentit me universitetin (rrjedhimisht pritjet mund të jenë të ndryshme), më kanë shtyrë që të dyfishoj mostrën për të pasur të dhëna më stabile (me një kredibilitet më të lartë) dhe me një përfaqësim prej rreth 3% të studentëve në vend (2,65%).

Pyetëtori është analizuar dhe i është përshtatur kontekstit vendor nga pyetëtorët e projekteve të BE-së për vlerësimin e IAL-ve.

Janë përfaqësuar komponentët kryesorë përmes të cilave vlerësohet cilësia e IAL-ve.

Drafti i parë i pyetëtorit është pilotuar me studentë dhe profesorë të IAL-ve në periudhën parahulumtuese dhe më ka mundësuar t'i riformuloj një pjesë të pyetjeve dhe të testoj pyetjet verifikuese.

Pjesë e këtij hulumtimi kanë qenë katër IAL-të më të mëdha në Kosovë prej 32 sa janë gjithsej, ku pyetëtori është realizuar me 265 studentë (66 meshkuj, 199 femra dhe asnjë pa përgjigje).

Siç u tha më lart, hulumtimi është zhvilluar me grupe të ndryshme që është menduar se do t'i kontribuojë tezës sonë. Kategoritë e synuara në hulumtimin tonë kanë qenë: ekspertët e arsimit, studentët dhe përgjegjësit për sigurim të cilësisë.

Intervista me *fokus grupi* është realizuar me 7 ekspertë të arsimit (2 femra, 5 meshkuj): profesorë, ish-kryetarë dhe anëtarë të Këshillit Shtetërorë të Cilësisë nga Agjencia e Akreditimit (bordi dhe ekzekutivi), prorektorë, dekanë, drejtorë të departamentit të AL-ve në

MASHT dhe ekspertë të jashtëm. Përzgjedhja e tyre është bërë duke u bazuar në përvojën dhe kontributin e tyre që i kanë dhënë arsimit të lartë në Kosovë që nga paslufta e deri tani, me drejtues ose ish-drejtues të IAL-ve.

3.2 Vendi i studimit

Si parim udhëheqës në përzgjedhjen e institucioneve për hulumtim ka qenë kriteri gjeografik, përfaqësim i drejtë i BAPrPAL me numrin më të madh të studentëve dhe me përvojë më të gjatë në ofrimin e arsimit të lartë në Kosovë. Nga bartësit publikë të AL-ve janë përfshirë UP “Hasan Prishtina” në Prishtinë dhe UPz “Ukshin Hoti” në Prizren. Ndërsa nga BAPrL janë përfshirë Kolegji AAB në Fushë Kosovë dhe Kolegji Fama në Prishtinë (që të dyja këto kanë degë të tjera nëpër Kosovë).

Janë mbledhur edhe informacione nga raportet e AKA-së, nga mediet e shkruara përmes monitorimit, duke analizuar çështje të arsimit të lartë që janë trajtuar viteve të fundit në Kosovë dhe më gjerë.

3.3 Procesi dhe instrumentet e hulumtimit

Ky hulumtimi është realizuar përmes kombinimit të metodave kualitative dhe kuantitative, meqë vlerësohen si të përshtatshme nga studiues të ndryshëm për të nxjerrë rezultate të besueshme gjatë hulumtimit të dukurive dhe fenomeneve të ndryshme.

Metodat kryesore që u përdorën në punim janë:

1. Metoda e *grup fokusit* eksplorues. Kështu, “...grup fokusi është një metodë për mbledhjen e të dhënave cilësore...ndryshimi është se grupi i fokusit (siç e thotë edhe vetë emri) largohet nga intervistat tek për tek, dhe bëhet një intervistë në grup” (Matthews, B. dhe Ross, L. 2012:235). Tri janë karakteristikat e *grup fokusit* “Bashkon një grup me 5 deri në 13 vetë, të cilët kanë diçka të përbashkët që lidhet me temën e hulumtimit për të marrë pjesë në një diskutim për këtë temë, që moderohet nga hulumtues” (Po aty).

2. Metoda e shqyrtimit të literaturës ekzistuese që ka të bëjë me këtë temë, publikimeve dhe librave të ndryshëm, ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve administrative, strategjive për arsimin e lartë, publikimeve hulumtuese nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare që merren me arsimin e lartë, publikime nga Institutet e ndryshme (think tanks etj) etj.

Shtjellimi dhe shtrirja e koncepteve teorike për administrimin dhe menaxhimin e cilësisë, për politikat dhe trendet në arsimin e lartë në hapësirën evropiane për arsim të lartë, për rolin e dijes si aset në kohën e globalizmit dhe sinteza e këtyre koncepteve përbën bazën mbi të cilën ndërtohet ky hulumtim. Po ashtu, kategoritë kryesore të kontekstit të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, përkatësisht procesi hulumtues bëhet duke analizuar literaturën dhe publikimet ekzistuese.

3. Metoda e intervistës gjysmë të strukturuar me përgjegjësit, bërësit e politikave dhe menaxhuesit e arsimit të lartë. Karakteristikat kryesore të kësaj metode janë:
 - a. Përdorimi i të njëjtit grup temash apo pyetjesh për çdo intervistë.
 - b. Temat apo pyetjet mund të paraqiten në rend apo mënyra të ndryshme, siç mund të jetë e përshtatshme për çdo intervistë.
 - c. Lejohen pjesëmarrësit t'u përgjigjen pyetjeve apo të diskutojnë për çështjen në mënyrën e tyre, duke përdorur fjalët e veta" (Matthews dhe Ross, vep.cit., f. 221).
4. Anketimi me pyetësorë të strukturuar me studentët. Anketimi përbën një pjesë shumë të rëndësishme të kërkimit shkencor me anë të instrumenteve të njëjta dhe të standardizuara (pyetësorëve, shkallëzimeve) etj., ku individët anketohen nga intervistuesi për temën në fjalë.

Anketimi me pyetësorë të strukturuar përdoret me rastin e hulumtimit të cilësisë në arsimin e lartë si bindje apo qëndrim i të anketuarve për temën.

Hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave është realizuar në 6 faza:

1. Është bërë kërkesa për marrje të lejës nga IAL-të publike dhe private për realizimin e hulumtimit me studentë në njësitë e tyre akademike.

2. Janë zhvilluar takime me profesorët dhe stafin mësimdhënës për realizimin e hulumtimit nëpër amfiteatro.
3. Personalisht janë shpërndarë pyetësorë me studentë në lidhje me perceptimet e tyre për cilësinë e AL-së.
4. Janë zhvilluar intervista gjysmë të strukturuar/pyetësorë me koordinatorët për sigurimin e cilësisë, lidhur me punën e tyre dhe instrumentet dhe procedurat që i aplikojnë.
5. Janë zhvilluar intervista gjysmë të strukturuar përmes *fokus grupit* me ekspertët e arsimit, në lidhje me perceptimet e tyre për menaxhimin e cilësisë në AL, mekanizmat që ekzistojnë dhe aplikueshmërinë e tyre.
6. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave.

Pyetësorët u janë dërguar personalisht nga autori i këtij hulumtimi, duke iu lënë hapësirë kohore prej rreth 30 minutash për t'i plotësuar ato. Intervistat janë realizuar personalisht dhe kanë zgjatur nga 40 deri në 60 minuta dhe fokus grupi 2 orë e 30 minuta.

Ky hulumtim është realizuar gjatë vitit akademik 2018/2019.

3.4 Analiza e të dhënave dhe vlerësimi i konsistencës

Analizën e të dhënave cilësore për t'i ofruar auditorit një lehtësi për kuptimin e të dhënave të mbledhura nga hulumtimi është aplikuar një taksonomi standarde në tri teknika kryesore dhe vlerësimi i konsistencës së të dhënave:

- Klasifikimi
- Interpretimi
- Përshkrimi

Analiza e pyetësorëve është bërë me programin SPSS si instrument më i përshtatshëm për analiza të hulumtimeve në fushën e shkencave sociale dhe humane. Të dhënat janë pasqyruar përmes grafikëve të segreguara në përqindje dhe skema të qarta dhe lehtësisht të lexueshme.

3.5 Etika

Për gjatë gjithë realizimit të hulumtimit janë marrë parasysh dhe janë respektuar çështjet etike. Në çdo projekt hulumtues principet etike duhet të jenë udhërrëfyes që nga fillimi e deri në përfundim të punës kërkimore shkencore (Wellington.J, 2000:3). Në rastin e hulumtimit tim, janë ruajtur dhe respektuar parimet etike në të gjitha fazat e realizimit të hulumtimit.

Synimi i autorit gjatë realizimit të fokus grupit, intervistave gjysmë të strukturuar, anketave me pyetësorë të strukturuar ka qenë që krahas punës cilësore profesionale t'i vërë në dukje parimet etike-morale të shoqëruara me standarde të larta profesionale dhe morale. Gjetjet e këtij hulumtimi, në rend të parë i hyjnë në përdorim IAL-ve si një referencë e matur.

KAPITULLI IV

4. RASTE STUDIIMI

4.1 Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

Universiteti i Prishtinës është themeluar me Ligjin për themelimin e Universitetit të Prishtinës, të cilin e miratoi Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës më 18 nëntor 1969. Kuvendi themelues i Universitetit të Prishtinës u mbajt më 13 shkurt 1970, kurse dy ditë më vonë, më 15 shkurt 1970 u mbajt edhe mbledhja solemne e Kuvendit dhe pikërisht kjo datë u shpall Dita e Universitetit të Prishtinës (UP, 2019).

Tani Universiteti i Prishtinës i ka 17 fakultete, nga të cilat 14 janë fakultete akademike, ndërsa 3 janë fakultete të shkencave të aplikuara.

Universiteti i Prishtinës ka këto njësi akademike:

1. Fakultetin Filozofik
2. Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore
3. Fakultetin e Filologjisë
4. Fakultetin Juridik
5. Fakultetin Ekonomik
6. Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës
7. Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike
8. Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike
9. Fakultetin e Mjekësisë
10. Fakultetin e Arteve
11. Fakultetin e Bujqësisë
12. Fakultetin e Shkencave Sportive
13. Fakultetin e Edukimit
14. Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj

Mekanizmat e cilësisë: “Me qëllim të kontrollimit të cilësisë, Senati i UP-së ka aprovuar tri lloje të instrumenteve të evaluimit të cilësisë: pyetësorët për staf akademik, pyetësorët për staf administrativ dhe pyetësorët për studentë.

Krahas këtyre pyetësorëve për cilësi, në përputhje me Statutin e UP-së, vlerësimi i studentëve për mësimdhënien dhe mësimnxënien për lëndë të veçanta organizohet në baza semestrale nëpërmjet pyetësorëve anonimë për ligjërata dhe kjo koordinohet nga dekanët e fakulteteve (ose prodekanët për mësim) në bashkëpunim me shefat e departamenteve me iniciimin e prorektorit për zhvillim të cilësisë” (Uni-pr, 2109).

Mekanizmat përkrahës: po ashtu, në Universitet ekzistojnë një numër mekanizmash për përmirësimin e cilësisë. “Cilësia e aktiviteteve hulumtuese të personelit akademik të UP-së matet nëpërmjet publikimeve në revista shkencore me recension ndërkombëtar dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore në vend dhe në konferenca ndërkombëtare. Bazuar në numrin e punimeve në revistat me recension ndërkombëtar bëhet edhe avancimi i stafit akademik.

Mblidhen të dhënat nga fakultetet për performancat e studentëve, si: përqindja e kalueshmërisë në provime, organizimi i kolokuiumeve, kohëzgjatja e studimeve etj.

Mekanizëm tradicional konsiderohet edhe akreditimi i programeve të studimit nga Senati i UP-së, ku secili program i ri i studimit duhet të kalojë në strukturat e fakultetit e pastaj të marrë edhe pëlqimin e Senatit”.

Vlerësimi i lëndëve dhe i mësimdhënësve

Duke synuar që procesi i mësimdhënies të përmirësohet vazhdimisht, Universiteti i Prishtinës e konsideron të rëndësishme vlerësimin e studentit për lëndën në përgjithësi, si dhe për cilësinë e mësimdhënies dhe të mësimdhënësve në veçanti. Ky proces realizohet përmes pyetësorëve për vlerësim të lëndëve dhe mësimdhënësve (UP,Vjetari, 2019).

Universiteti I Prishtinës ka 147 programe të studimit, Bachelor 65, Master 65 dhe Doktoraturë 17.

Stafi akademik në UP është 1087, stafi administrativ 512, studentë aktualë 37985.

4.2 Universiteti I Prizrenit "Ukshin Hoti"


Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" në Prizren është themelur në vitin 2010 pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për themelim. Universiteti i Prizrenit është universiteti i dytë publik në Kosovë. Në vitin 2010 numri i studentëve ishte afër 1700, ndërsa tani në vitin 2014 numri i studentëve është rreth 10.000. Universiteti është i akredituar nga viti 2010. Për herë të fundit i është nënshtruar procesit të akreditimit vitin e kaluar dhe është riakredituar. Momentalisht Universiteti ofron studime në ciklin Bachelor dhe Master.

Programet e ciklit të parë të akredituara nga AKA-ja janë:

- Fakulteti Ekonomik me drejtimet:
- Fakulteti Juridik
- Fakulteti i Shkencave kompjuterike me drejtimet:
- Fakulteti i Edukimit (në gjuhën shqipe, turke dhe boshnjake) me programet:
- Fakulteti i Filologjisë

Nga 2013-ta ka filluar edhe programi Master në Trashëgimi Kulturore dhe Menaxhim i Turizmit (UniPZ, 2019).

01- Struktura Organizative e Universitetit "UKSHIN HOTI" Prizren



Organogrami I Universitetit Ukshin Hoti në Prizren

Burimi: <https://uni-prizren.com>

Tabela 8

4.3 Kolegji AAB

Kolegji AAB është institucioni i parë jopublik i arsimit të lartë në Kosovë, i cili është themeluar në vitin 2002 si një institucion i arsimit të lartë në fushën e komunikimit masiv.

Në fillim të themelimit, ky institucion ofroi programe studimore nga fusha e Artit dhe Komunikimit Masiv, duke u zgjeruar pastaj me programe studimore në fusha të ndryshme.

AAB ka kampuset në Prishtinë, Ferizaj dhe Gjakovë.

AAB ofron programe studimore në fushën e Ekonomisë, Drejtësisë, Komunikimit Masiv, Arteve, Shkencave Sociale, Gjuhës Angleze dhe Kulturës Fizike në nivelin Bachelor dhe Master (Kolegji AAB, 2019).

Studimet në AAB zhvillohen në 13 fusha studimi të shpërndara nëpër fakultete përkatëse. Në kuadër të këtyre fakulteteve, veprimtarinë e vet e zhvillojnë 24 programe në nivelin Bachelor dhe 15 programe në nivelin Master të studimeve.

Programet e studimit në kolegjin AAB janë: Administratë publike: bachelor, shkenca politike dhe diplomaci: bachelor; Administratë publike dhe diplomaci- niveli master;

Programet e akredituara që ofrohen deri më tani janë:

- Programet e fushës së Ekonomikut
- Programet e shkencave kompjuterike
- Programet e fushës së Komunikimit Masiv
- Programet e fushës Juridike
- Programet e Administratës publike
- Programet e fushës së Kulturës Fizike dhe Sportit
- Fakulteti Filozofik dhe i Filologjisë
- Programet e fushës së Shkencave Sociale Aplikative
- Programet e fushës së arteve

Si mekanizëm për sigurimin e cilësisë në kolegjin AAB është zyra për sigurim të cilësisë, e cila udhëhiqet nga koordinatorët për sigurim të cilësisë në kuadër fakulteteve të kolegjit AAB.

Roli dhe detyrat e Zyrës për Sigurim të Cilësisë: Roli kryesor i ZSC-së është që të sigurojë mbështetje dhe udhëheqje profesionale, administrative, udhëzime dhe mbështetje për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet e institucionit dhe të ndihmojë organizimin e akreditimit institucional dhe të programeve studimore:

- të formulojë strategjitë, politikat, mekanizmat, procedurat dhe praktikat e ndryshme për sigurim dhe avancim të cilësisë akademike në institucion;
- të promovojë kulturën e cilësisë brenda institucionit;
- të zhvillojë udhëzuesin për sigurim të cilësisë, ku do të parashihen vlerësim i mësimdhënies, rishikimi i programeve dhe vlerësimi i studentëve;
- të këshillojë në aprovimin dhe zhvillimin e moduleve dhe programeve studimore;
- të hartojë strategji dhe të ndihmojë në avancimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- të koordinojë agjendën e aktiviteteve me koordinatorët e cilësisë në nivel të fushave studimore;
- të përgatisë të gjitha dokumentet në lidhje me akreditim apo riakreditim, raportet e ndryshme të vlerësimit të brendshëm në bashkëpunim me të gjitha fakultetet dhe të koordinojë vizitat e ekspertëve të huaj për akreditim apo riakreditim.

Po ashtu, si mekanizëm për Sigurim të Cilësisë janë edhe studentët tutorë. Studentët tutorë bëjnë fuqizimin e trekëndëshit: student – profesor – menaxhment apo administratë – student (AAB, zyra për sigurimin e cilësisë, 2019).




Figura 1 - Struktura për sigurimin e cilësisë

Tabela 9

Burimi: www.aab-edu.net

4.4 Kolegji FAMA

Kolegji „Fama“ është themeluar më 12 maj të vitit 2003. Ky kolegji punën e tij e në vitin 2003-2004 e ka filluar me 2 fakultete. Fakultetin e ekonomisë me departamentet: Menaxhment dhe Informatikë, Banka, Financa dhe Kontabilitet, si dhe Fakultetin e Shkencave Politike me departamentet: Administratë publike dhe diplomaci.

Ky kolegji në vazhdim rritet me numrin e fakulteteve dhe departamenteve të ndryshme, duke përfshirë edhe studimet e nivelit master.

Tani në vitin 2019, kolegji Fama, në nivelin bachelor ka këto programe:

BA – Ekonomik me specializim në: Banka, Financa dhe Kontabilitet si dhe Menaxhment.

BA- Juridik me specializim në: Civil –Komerical, Penal-kriminalistikë,

BA- në Shkenca politike dhe Administratë publike

BA- në Psikologji

BA- në Infermieri

BA- në Mami

BA- në Stomatologji (program studimor i integruar 5 vjeçar): Laborant i lartë dentar, Laborant mjekësor.

Kolegji FAMA, studimet e nivelit master i ofron në këto programe:

MA- Banka, Financa dhe Kontabilitet

MA – Menaxhment

MA –Psikologji

MA- Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci

MA-Administratë publike

Kolegji „Fama“ vepron në këto regjione të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Gjilan dhe Mitrovicë.

KOLEGJI FAMA në Prishtinë tashmë gjendet në vitin e 15-të të veprimtarisë së vet me afër 13000 studentë të regjistruar deri më sot dhe me 4000 studentë të diplomuar deri më sot në nivelin master dhe bachelor.

Filiala e KOLEGJIT FAMA në Prizren tashmë gjendet në vitin e 12-të (dymbëdhjetë) të veprimtarisë së vet me afër 3100 studentë të regjistruar deri më sot, dhe me afër 2000 studentë të diplomuar në nivelin e studimeve bachelor.

Filiala e KOLEGJI FAMA në Mitrovicë tashmë gjendet në vitin e 12-të (dymbëdhjetë) të veprimtarisë së vet me afër 2000 studentë të regjistruar deri më sot, dhe me 1000 studentë të diplomuar deri më sot në nivelin e studimeve bachelor.

Filiala e KOLEGJI FAMA në Gjilan tashmë gjendet në vitin e 12-të (dymbëdhjetë) të veprimtarisë së vet me afër 2020 studentë të regjistruar deri më sot dhe me 1400 studentë të diplomuar në nivelin e studimeve bachelor (Kolegji Fama , 2019).

Zyra për sigurim të cilësisë:

Kolegji FAMA ka rregullore për sigurim të cilësisë, qëllimi i së cilës është planifikimi i mekanizmave për sigurim të cilësisë. Në kuadër të kësaj rregulloreje është edhe Zyra për Sigurimin e Cilësisë me përshkrim të kompetencave.

Sistemi i sigurimit të cilësisë sigurohet nëpërmjet:

- Strukturave organizative të Kolegjit FAMA;
- Zyrës së Sigurimit të Cilësisë (Kolegji FAMA, 2019) .

KAPITULLI V

5. ANALIZA E REZULTATEVE TË HULUMTIMIT- VERIFIKIMI I ÇËSHTJEVE TË CILËSISË


5.1 Shqyrtimi dhe krahasimi rezultateve të hulumtimit bazuar në komponentët për sigurimin e cilësisë

Qëllimi i këtij hulumtimi është që përmes metodës kuantitative dhe kualitative të hulumtimit të verifikojmë nivelin e administrimit dhe menaxhimit të cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë, në baza shkencore sipas perceptimit të studentëve me gjithsej 265 respondentë, 3 intervista gjysëm të strukturuar me persona përgjegjës për sigurim të cilësisë dhe fokus grupi me 7 ekspertë nga fusha dhe institucione të ndryshme që kanë të bëjnë me cilësinë në AL. Hulumtimi është bërë me pyetësorë të strukturuar që përdoren nga projektet e BE-së për vlerësimin e cilësisë së IAL-ve. Pyetësi mbulon 14 fusha relevante të funksionimit të IAL-ve të adresuara përmes 23 pyetjeve kryesore. Pyetjet kryesore janë zbërthyer në 102 nënpyetje dhe adresojnë elementet kryesore të sigurimit të cilësisë funksionale, akademike, programore, metodologjike, të vlerësimit, përmbajtësore/ materialeve mësimore, orientimit shkencor, lidhjes me tregun e punës, kompetencave kryesore të BE-së për MGJGJ (EU key competences for LLL), shërbimeve për studentë, marrëdhënieve ndërkademi, e-mësimin, bashkëpunimi ndërkombëtar, infrastrukturës, statistikat etj. Të gjitha këto elemente të trajtuara janë në funksion të dhënies së një përgjigjeje më të plotë në pyetjet hulumtuese dhe në adresimin e hipotezave të ngritura.

Është e qartë se gjatë interpretimit të gjetjeve të këtij hulumtimi për arsye të volumit të madh të tyre dhe hapësirës megjithatë të limituar, jemi fokusuar në rezultatet me reprezentative në kuadër të 14 fushave dhe me nga një ose dy mostra të pyetjeve kryesore. Në të njëjtën mënyrë është vepruar edhe me krostabulimin e gjetjeve (kryqëzimin dhe krahasimin e tabelave). Gjithsesi, evidenca me rezultate të detajura është pjesë e shtojcës së këtij disertacioni. Po ashtu, në vijim të interpretimit të këtyre rezultateve është trajtuar dhe pasqyruar edhe

mendimi i ekspertëve të AL-së që kanë qenë pjesë e fokus grupit eksplorues dhe të intervistave gjysëm të strukturuar. Është mjaft me vlerë të potencohet se shumica e gjetjeve nga hulumtimi me studentë janë rikonfirmuar nga ekspertët e AL-së dhe kanë mendime të përafërta lidhur me menaxhimin e cilësisë në AL, sipas parametrave të trajtuara në hulumtim.

STATISTIKAT E PËRGJITHSHME



I-II. SITUATA E PËRGJITHSHME E STUDIMIT

Duke përdorur një perspektivë të përgjithshme: Cila është përshtypja juaj e përgjithshme për situatën e arsimit të lartë në fushën tuaj të studimit, në insitucionin tuaj të arsimit të lartë?





Fig. 1

Përshtypja e përgjithshme e studentëve të intervistuar për situatën në arsimin e lartë është e kënaqshme dhe e mirë për rreth 80% të tyre. Megjithatë afro 20% nuk janë të kënaqur me gjendjen në institucionin e tyre.

III. PROGRAMI I STUDIMIT- MËSIMDHËNIA E OFRUAR

Ju lutem, jepni mendimin tuaj për aspektet e mëposhtme të mësimdhënies të ofruara në programin tuaj të studimit

Niveli i përmbajtjes së lëndëve



keq kënaqshëm mirë shumë mirë

Fig. 2

Përmbajtjet e ofruara përmes lëndëve vlerësohen si të mira. Studentët e intervistuar konsiderojnë se programi i tyre i studimit është në nivelin e duhur. Më pak se 6% janë të pakënaqur me programin apo përmbajtjen e lëndëve.




Fig. 3

Vetëm 30% nga studentët e intervistuar konsiderojnë se programi i tyre i studimit ofron praktika profesionale në nivelin e duhur. Më shumë se gjysma e tyre janë të pakënaqur me programin apo punën praktike profesionale.




Fig. 4

Studentët e intervistuar konsiderojnë se programi i tyre i studimit ka një orientim ndërkombëtar por jo në nivelin e duhur. Mbi 30% shprehen si të pakënaqur me dimensionin ndërkombëtar të programit apo përmbajtjes së lëndëve.




Fig. 5

Afro gjysma e studentëve të intervistuar konsiderojnë se programi i tyre i studimit ofron pak ose aspak përfshirje të profesorëve të jashtëm-vizitorë. Vetëm 11.7 % konsiderojnë që ka një përfshirje shumë të mirë.




Fig. 6

Nga studentët e anketuar është kërkuar të vlerësojnë metodologjinë e mësimdhënies dhe rezultatet tregojnë se pjesa më e madhe e tyre janë të kënaqur me metodat e mësimdhënies.




Fig.7

Shumica e studentëve konsiderojnë që nuk ofrohen programe të mjaftueshme trajnimi për metodat empirike të studimit.

Ju lutem, tregoni aftësinë dhe cilësinë në mësimdhënie të profesorëve tuaj




Fig. 8

Nga studentët e anketuar është kërkuar të vlerësojnë aftësinë, cilësinë dhe intereaksionin e profesorëve gjatë procesit mësimor dhe pjesa më e madhe e tyre i vlerësojnë si të kënaqshme dhe të mira këto attribute. Por, megjithatë vlerësimi negativ prej më shumë se 20% të respondentëve është tregues për një deficit të dukshëm në cilësinë e mësimdhënies.




Fig. 9

Në më shumë se 40% të rasteve, profesorët preferojnë dhe rekomandojnë vetëm librat e tyre. Në mbi 50% të rasteve profesorët shfrytëzojnë dhe ofrojnë materiale të printuara si dispencat dhe skriptat, ndërsa në mbi 60% të rasteve profesorët përdorin materialet elektronike (këtu studentët u referohen sllajdeve dhe power point prezentimit dhe jo përdorimit të platformave on-line).




Fig. 10

Pjesa më e madhe e profesorëve rekomandojnë vetëm literaturë në gjuhën shqipe. Mbi 90% e të anketuarve pohojnë se materialet e përdorura janë kryesisht në gjuhën shqipe. Vetëm një numër i vogël prej 5%, të profesorëve përdorin apo rekomandojnë literaturë në gjuhën angleze. Ndërsa literatura në gjuhën gjermane apo atë serbe preferohet edhe më pak, me nga 1.1%.

IV. ORIENTIMI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE INTEGRIMI ME PRAKTIKËN

Ju lutem, jepni mendimin tuaj për kërkimin shkencor dhe elementët ku orientohet në studimet tuaja:




Fig. 11

Nga studentët e anketuar është kërkuar ta vlerësojnë orientimin e kërkimit shkencor dhe integrimin e teorisë me praktikën dhe 32.4% e vlerësojnë këtë proces si të kënaqshëm.

Ju lutem jepni mendimin tuaj mbi mundësitë e përfshirjes në praktikë apo intership




Fig. 12

Përfshirja e praktikës profesionale gjatë studimit është një pikë e dobët e programeve studimore në IAL. Kështu, 33.6% e studentëve të anketuar vlerësojnë se puna praktike është aspak e përfaqësuar në programet e tyre studimore, ndërkohë që 24% deklarojnë se puna praktike është pjesërisht e përfaqësuar.




Fig.13

Më shumë se 80% e studentëve të anketuar pohojnë se praktika profesionale e organizuar nga IA-tëL është pjesërisht, pak ose aspak e mjaftueshme. Më pak se 15% vlerësojnë se kanë mundësi të mjaftueshme të përfshirjes në punë praktike gjatë studimit.




Fig. 14

Afro 80% e studentëve të anketuar pohojnë se praktika profesionale nuk vlerësohet mjaftueshëm. Mbi 80% pohojnë se programet e studimit nuk ofrojnë mjaftueshm informacion për mundësitë e realizimit të punës praktike. Studentët po ashtu, ndjehen të papërkrahur nga IAL-të në gjetjen e mundësive për kryerjen e praktikës profesionale. Rreth 37% e tyre deklarohen si aspak të përkrahur, 26.7 si pak dhe 21.8 pjesërisht të përkrahur. Në përgjithësi, mungesa e përkrahjes në gjetjen e mundësive, periudha e trajnimit praktik dhe mungesa e vlerësimit të intershipit / praktikës mësimore, rezultojnë me një lidhje të pamjaftueshme midis elementëve teorikë dhe punës praktike gjatë studimit.

V. ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Ju lutem, jepni mendimin tuaj për aspektet e më poshtme të organizimit të studimeve dhe metodat e vlerësimit




Fig. 15

Në përgjithësi aspektet organizative të mësimdhënies dhe metodat e vlerësimit konsiderohen si të kënaqshme dhe të mira. Se përmbajtjet e lëndëve janë në përputhje të plotë me procesin e vlerësimit pohojnë mbi 80% të studentëve të intervistuar. Më pak se 5% janë plotësisht të pakënaqur dhe gjithsej rreth 13% të priturat e të cilëve nuk janë arritur.




Fig.16

Sistemi i vlerësimit konsiderohet të jetë transparent, korrekt dhe i pranuar mirë nga studentët. Të kënaqshëm e konsiderojnë procesin 23.6%, të mirë rreth 43% dhe shumë të mirë mbi 17%. Më pak se 6% janë plotësisht të pakënaqur dhe gjithsej rreth 10% të priturat e të cilëve nuk janë arritur.




Fig. 17

Megjithë subjektivizmin e theksuar që mund ta ketë i vlerësuar gjatë procesit të vlerësimit, sistemi i vlerësimit në IAL konsiderohet të jetë, maksimalisht korrekt dhe i pranuar mirë nga studentët. Nga studentët e intervistuar, të kënaqshëm e konsiderojnë procesin 27%, të mirë rreth 34% dhe shumë të mirë mbi 12%. Më pak se 9% janë plotësisht të pakënaqur dhe gjithsej rreth 17.5% të priturat e të cilëve nuk janë arritur e vlerësojnë procesin si të keq.

Korrektësia në vlerësimin e provimeve duket e konsoliduar dhe me premisa të përmirësimit të vazhdueshëm.

VI. PËRGATITJA PËR TREGUN E PUNËS

Ju lutem, jepni mendimin tuaj mbi mënyrën se si universiteti/ kolegji juaj promovon lidhjen midis profesionit dhe tregut të punës në studimet tuaja




Fig. 18

Pjesa më e madhe e studentëve të intervistuar, rreth 90%, nuk besojnë që shërbimet e IAL-së ndihmojnë në gjetjen e një pune pas diplomimit. Më pak se 9% e repondentëve vlerësojnë që shërbimet si zyra e karrierës, ndihmojnë në lidhjen me tregun e punës.




Fig. 19

IAL-të përkrahin pjesërisht iniciativat e studentëve për lidhje me tregun e punës gjatë studimit. Mbi 43% e tyre konsiderojnë që janë të përkrahur pak, rreth 26% si përkrahje të pjesshme dhe më pak se 20% konsiderojnë që iniciativat e studentëve gëzojnë përkrahje nga IAL-të.




Fig. 20

Afro gjysma e studentëve të intervistuar konsiderojnë që kanë mungesë të informacionit për takimet që organizohen me qëllim të lidhjes me tregun e punës. Rreth 31% konsiderojnë që janë pjesërisht të informuar dhe pak mbi 20% pohojnë se janë mjaftueshëm apo shumë mirë të informuar.




Fig.21

Pjesa më e madhe e studentëve të intervistuar mbi 40% konsiderojnë që njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale janë pjesërisht dhe mbi 26% mjaftueshëm dhe shumë mirë, në përputhje me tregun e punës. Diçka mbi 30% e studentëve të intervistuar konsiderojnë që njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale janë pak ose aspak në përputhje me tregun e punës.




Fig. 22

Pjesa më e madhe e studentëve të intervistuar, mbi 80%, konsiderojnë që programet e gjuhëve të huaja që ofrohen nga IAL-ja, janë të pjesshme ose të pakëta. Më pak se 20% i konsiderojnë këto programe si të mjaftueshme në kontekstin e integritit në tregun e punës.




Fig. 23

Në lidhje me njohuritë dhe shkathtësitë kompjuterike, pjesa më e madhe e studentëve të intervistuar, mbi 80%, konsiderojnë që programet e teknologjisë informative që ofrohen nga IAL-të, ofrohen pjesërisht ose janë të pakëta. Më pak se 20% i konsiderojnë këto programe si të mjaftueshme në kontekstin e integritit në tregun e punës. Është e dukshme një ngjashmëri në përgjigjet për programet e gjuhëve të huaja dhe atyre për njohuritë digjitale.

VII. PËRKRAHJA NGA STAFI AKADEMIK DHE VLERËSIMI I MËSIMDHËNIES

Ju lutem, jepni mendimin tuaj për cilësinë e informacionit, ligjërimit nga stafi akademik në programin tuaj të studimit

Gatishmëria e stafit akademik për përkrahje (gjatë orarit të punës, ose nëpërmjet komunikimit elektronik)




Fig. 24

Afër 80% e studentëve të intervistuar pohojnë gatishmërinë e stafit akademik për të përkrahur studentët në zhvillimin e tyre. Edhe pse pak mbi 20% e respondentëve e vlerësojnë gatishmërinë për përkrahje me notë negative, mund të konstatohet që IAL-të kanë staf akademik të motivuar mjaftueshëm për përkrahjen e studentëve në zhvillimin e tyre profesional.

Diskutimi i detyrave (eseve, seminareve, punimeve) dhe provimeve




Fig. 25

Afër 90% e studentëve të intervistuar pohojnë se diskutimi i detyrave, seminareve, eseve e punimeve me stafin akademik është në nivel të kënaqshëm, në pjesën më të madhe të mirë dhe mbi 25% shumë të mirë. Pak mbi 10% e respondentëve e vlerësojnë keq këtë proces. Duket se ka një staf të motivuar dhe të gatshëm për përkrahje të studentëve.

Ju lutem, jepni mendimin tuaj në lidhje me vlerësimin e lëndëve (kurseve)/ programit të studimit nga studentët




Fig. 26

Afër 80% e studentëve të intervistuar pohojnë kanë informacione të mjaftueshme në lidhje me vlerësimin e rezultateve.




Fig. 27

Më shumë se gjysma e studentëve të intervistuar pohojnë se përfshirja e studentëve në përgatitje për vlerësim/akreditim të programeve është në një shkallë më të gjerë. Megjithatë mbi 40% e konsiderojnë nivelin e përfshirjes si të dobët apo shumë të dobët. Megjithatë, ekziston një korrektësi solide dhe konsistencë substanciale në mes të programit dhe vlerësimit pa paragjykuar cilësinë e programeve.

VIII. PËRKRAHJE PËR MOBILITET - QËNDRIM STUDIMOR JASHTË VENDIT

Jepni mendimin tuaj rreth mundësive dhe përkrahjes së universitetit ose kolegjit tuaj për të studiuar jashtë vendit




Fig. 28

Më shumë se gjysma e studentëve të intervistuar konsiderojnë që IAL-ja, ku ata studiojnë ka interesim të ulët për programet e përbashkëta me universitetet jashtë vendit. 26,5% konsiderojnë që ka vetëm pjesërisht interesim dhe diku rreth 15% konsiderojnë që bashkëpunimi është i mjaftueshëm dhe shumë i mirë.




Fig. 29

Pyetjes nëse ka mbështetje dhe këshillime për studime jashtë vendit, 63% e studentëve vlerësojnë me pak dhe aspak. Të pjesshme i konsiderojnë 22.9% e studentëve dhe më pak se 15% konsiderojnë që kanë këshillime dhe mbështetje të mjaftueshme.




Fig. 30

Pyetjes nëse ka mbështetje për gjetjen e internshipeve jashtë vendit, rreth 70% e studentëve vlerësojnë me pak dhe aspak. Të pjesshme i konsiderojnë 20.5% e studentëve dhe më pak se 10% konsiderojnë që kanë këshillime dhe mbështetje të mjaftueshme.




Fig. 31

Me programet që ofrohen lëndë/programme në gjuhën angleze rreth 50% e studentëve të intervistuar janë të pakënaqur. Në përgjithësi, vërehet një mungesë e dukshme e mobilitetit, bashkëpunimit me institucione jashtë vendit, transferit të kredive dhe shkëmbimeve ndërkombëtare. Njohje e rezultateve të arritura gjatë periudhës së studimit jashtë vendit është po ashtu një sfidë e IAL-ve.

IX. SALLAT-AMFITEATROT-KLASAT

Ju lutem, jepni mendimin tuaj rreth sallave të ligjëratave dhe ushtrimeve të disponueshme për mësimdhënie.




Fig.32

Disponueshmëria e sallave të ligjëratave dhe ushtrimeve për mësimdhënie vlerësohet si e kënaqshme nga 32% e studentëve. Rreth 40% e studentëve pohojnë se situata me hapësirat fizike është e mirë dhe shumë e mirë.




Fig.33

Në përgjithësi kushtet teknike dhe hapësira është vlerësuar si e mirë dhe solide.

X. BIBLIOTEKA/SALLA LEXIMI

Ju lutem, jepni mendimin tuaj rreth bibliotekës/bibliotekave të disponueshme në universitetin/kolegjin tuaj




Fig. 34

Gjysma e studentëve pohojnë se u mungon literatura adekuate për studimet e tyre.




Fig. 35

Mbi 55% e studentëve vlerësojnë se kanë vështirësi në revista dhe libra akademike.




Fig. 36

Mbi 55% e studentëve deklarojnë se mungojnë dukshëm shërbimet përkrahëse për studime dhe qasja në burime shkencore.

XI. INFRASTRUKTURA E IT-SË DHE E-LEARNING (TË MËSUARIT ONLINE)

Ju lutem, jepni opinionin tuaj rreth IT-ve dhe pajisjeve kompjuterike për studentët kur mësimi elektronik ofrohet në studimet tuaja. Si i qaseni/Si i përdorni shërbimet online?




Fig. 37

Afro 70% e studentëve deklarojnë se kanë probleme me pajisje dhe qasje të pakufizuar në mjete audiovizuale/DVD të nevojshme për programin e studimit.




Fig. 38

Afro gjysma e studentëve të intervistuar pohojnë se u mungon mbështetje për mësimin dhe mësimdhënie nga shërbimet online.




Fig. 39

Digjitalizimi, e-learning (e-brary) janë të kufizuara ose mungojnë në tërësi. Afro gjysma e studentëve të intervistuar pohojnë se u mungojnë platformat dhe shërbimet online të IAL-ve.

XII. KLIMA E STUDIMIT

Ju lutem, jepni mendimin tuaj për aspektet e mëposhtme të klimës sociale në universitetin/kolegjin tuaj




Fig. 42

Aspektet e komunikimit ndërmjet studentëve dhe të klimës sociale në IAL nga mbi 80% e studentëve vlerësohen si të kënaqshme dhe shumë të mira.




Fig. 43

Aspektet e komunikimit ndërmjet studentëve dhe stafit akademik në IAL nga mbi 80% e studentëve vlerësohen si të kënaqëshme dhe shumë të mira.

Cili është mendimi juaj i përgjithshëm mbi mësimdhënien dhe eksperiencën e mësimnxënies në fushën tuaj të studimit në institucionin tuaj?





Fig. 44

Pyetjes se a do t'ia rekomandonin këtë institucion dhe program ndonjë të afërmi, studentët shfaqen pjesërisht të kënaqur rreth 37% dhe po aq të pakënaqur me IAL-në ku studiojnë. Vetëm 25% e tyre janë plotësisht të kënaqur.

Nëse do t'ju duhet të zgjidhni përsëri a do të zgjidhnit sërish programin tuaj të studimit dhe institucionin aktual për herë të dytë?



- Do ta zgjidhja të njëjtin program studimi dhe universitetin përsëri
- Do të zgjidhja të njëjtin program por në një universitet tjetër
- Do të zgjidhja një program tjetër studimi
- Nuk do të shkoja në universitet përsëri


Fig. 45

Më shumë se 60% e studentëve janë të pakënaqur me universitetin dhe/apo drejtimin. Vërehet një mungesë perspektive për punësim dhe për të ardhmën.

XIII. ASPEKTE TË RËNDËSISHME TË STUDIMIT

Sa të rëndësishme janë për ju personalisht aspektet e mëposhtme të programit të studimit?

Lidhja e kursit/programit me tregun e punës



- aspak
- pak
- pjesërisht
- mjaftueshëm
- shumë

Fig. 46

Afro 30% e studentëve konsiderojnë që lidhja e kursit/programit me tregun e punës është e pjesshme, mbi 40% konsiderojnë se është e mjaftueshme dhe shumë e mirë, por megjithatë një e treta e respondentëve deklarohet se kjo lidhje ekziston pak ose aspak.




Fig. 49

Mbi 40% e studentëve deklarojnë se nuk kanë mundësi të mira punësimi pas përfundimit të studimeve.

XIV. STATISTIKA - INFORMACIONE DEMOGRAFIKE




Fig. 53

Pyetjes nëse ka qenë Institucioni aktual i arsimit të lartë zgjedhja e tyre e parë 30% thonë jo, qe lë për të kuptuar se ky kontigjent vjen kryesisht nga universitetet private dhe këta studentë kanë një relacion paraprak me Universitetin publik.

5.1.1 Reflektim mbi gjetjet e hulumtimit

Hulumtimi po tregon, edhe pse në rrethana të volitshme ligjore dhe me gjithë infrastrukturën përcjellëse, stimulim korrekt financiar të profesoriatit - cilësia mezi po e kalon mesataren.

Pa pasur qëllim të lidhjes kauzale, buxhet - cilësi, mund të jetë një indikator, por nuk është qëllimi i këtij studimi.

TIK - ofron shumë mundësi, por IAL-ve u mungon shfrytëzimi i këtij resursi për krijimin e platformave që studentëve do t'ju jep qasje në E-BRARY / E-learning, por edhe të Universiteteve partnere. IAL - çalojnë në digjitalizim dhe qasjen e studentëve përtej literaturës themelore që ju jep profesori dhe kjo mbetet një çështje problematike.

Studenti nuk arrin te informacioni në mungesë të një sistemi të të dhënave - informacioneve, pra është diçka e fragmentuar. Sistemi ende funksionon me PAPER BASED DOCUMENT apo Information.

-Sa i përket shfrytëzimit të burimeve të informacionit në gjuhë të huaj, ose duhet të fuqizohet politika e gjuhëve të huaja në shkolla të mesme dhe universitete, ose duhet të fuqizohet politika e përkthimeve. Por prioritet dhe politikë e qëndrueshme është fuqizimi i mësimit të gjuhëve të huaja.

IAL - ende nuk janë /nuk po ia dalin të ndërmarrin nisma dhe projekte të hulumtimit dhe zhvillimit në bashkëpunim me industri dhe as nisma të përbashkëta ndëruniversitare për të promovuar dhe nxitur zhvillimin ekonomik dhe social të shoqërisë ku veprojnë. Mungon përgjegjësia sociale e ndërmarrjeve, të cilat nganjëherë mjaftohen me projekte humanitare dhe solidariteti, mungon vetëdija ku kontributin në arsim dhe shkencë nuk e shohim si përgjegjësi të tyre dhe si nevojë për zhvillim të tyre dhe të shoqërisë.

Kjo do të mundësonte aktivizimin dhe përfshirjen e studentëve në projekte hulumtuese dhe zhvillimore (hartim-implementim) në të mirë të shkencës, teknologjisë dhe të ekonomisë.

Po ashtu, IAL-et nuk e kanë idenë e qasjes në Industrinë 4.0, as në aplikimin e SMART specializations, por as si qendra inovative dhe hulumtuese për të shpërndarë kompetencat profesionale dhe hulumtuese në shërbim të niveleve më të ulëta arsimore apo edhe ekonomisë dhe industrisë. Ky është një rast i humbur për të ndërlidhur dijen-studimin me nevojat e ekonomisë dhe shoqërisë.

Cilësia në AL nuk është qëllim më vete, por duhet të shihet në kontekst më të gjerë të imazhit të vendit, shoqërisë, zhvillimit dhe inovacionit. Pra cilësia është një lloj brendi për shoqëritë e zhvilluara.

Kriteri i matjes së cilësisë së arsimit të lartë nuk duhet të jetë punësimi klasik, por sa % e të rinjve krijojnë mundësi vetëpunësimi dhe ndërmarrësie me premisa inovative duke penetruar në tregje të reja.

Gara në mes të IAL-ve duhet të jetë se cilin treg po e synojnë studentët e tyre, prandaj gjetjet e këtij hulumtimi, në rend të parë i hyjnë në përdorim IAL-ve si një referencë e matur.

5.2 Krahasimi rezultateve sipas rasteve të studimit - Interpretimi i gjetjeve

Siç u tha në fillim të këtij kapitulli se qëllimi i këtij hulumtimi është që përmes metodës kuantitative dhe kualitative të hulumtimit të verifikojmë nivelin e administrimit dhe menaxhimit të cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë edhe sipas perceptimit të studentëve. Meqë hulumtimi është bërë me respondentë të katër IAL-ve, rrjedhimisht kemi bërë edhe krostabulimin e gjetjeve (kryqëzimi dhe krahasimi e tabelave).

Për arsye të volumit të madh të tyre dhe hapësirës megjithatë të limituar, gjatë krahasimit jemi fokusuar në rezultatet me reprezentative në kuadër të 14 fushave dhe me nga një ose dy mostra të pyetjeve kryesore. Në vijim është paraqitur krahasimi i gjetjeve.

I & II. SITUATA E PËRGJITHSHME E STUDIMIT

Duke përdorur një perspektivë të përgjithshme: cila është përshtypja juaj e përgjithshme për situatën e arsimit të lartë në fushën tuaj të studimit, në insitucionin tuaj të arsimit të lartë?




Fig. 54

III. PROGRAMI I STUDIMIT- MËSIMDHËNIA E OFRUAR

4. Ju lutem, jepni mendimin tuaj për aspektet e mëposhtme të mësimdhënies të ofruara në programin tuaj të studimit

Orientimi ndërkombëtar i mësimdhënies




Fig. 55

Orientimi ndërkombëtar i mësimdhënies vlerësohet si i mirë nga 33,3% e studentëve në Universitetin e Prizrenit deri në 27.6% në FAMA, ndërsa me shumë mirë vlerësojnë 31.5% në Universitetin e Prizrenit dhe nën 12% në universitetet e tjera. Në përgjithësi kanë vlera të barabarta të gjitha IAL-të, vërehet një përceptim më pozitiv në Universitetin e Prizrenit. Në përgjithësi orientimi ndërkombëtar i IAL-ve lë për të dëshiruar, pa marrë parasysh në procesin e akreditimit të programeve ato paraqesin silabuse komplet kompatible me universitete të zgjedhura kryesisht evropiane.

Përfshirje e profesorëve të ftuar në mësimdhënie (nga jashtë fakultetit tuaj)




Fig. 56

Në përgjithësi përfshirje e profesorëve të ftuar në mësimdhënie nga jashtë fakulteti nuk është inkurajuese. Vërehet që Kolegjet private edhe pse supozohet që kanë mundësi financiare dhe procedurale nuk demonstrojnë përfshirje të theksuar të profesorëve të ftuar.

35. Ju lutem, tregoni aftësinë dhe cilësinë në mësimdhënie të profesorëve tuaj

Cilësia e mësimdhënies




Fig. 57

Aftësia në mësimdhënie dhe cilësia e mësimdhënies vlerësohet nga 60% si i kënaqshëm, mirë dhe shumë mirë. Vërehet një entuziazëm tek Universiteti i Prizrenit si institucioni më i ri nga institucionet në fokus.

7. Ju lutem tregoni materialet që përdoren nga profesorët tuaj




Fig. 58

Studentët pohojnë se literatura dhe materialet e përdorura për mësimdhënie janë pothuajse të gjitha në gjuhën shqipe nga 84-100%. Një përqindje e vogël në gjuhën angleze me maksimum 12% në AAB dhe në gjuhën gjermane 1.6% në UP deri 2.0% në AAB.

IV. ORIENTIMI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE INTEGRIMI ME PRAKTIKËN

8. Ju lutem jepni mendimin tuaj mbi mundësitë e përfshirjes në praktikë apo intership

(psh. praktikë pune ose punësim sezonal)

Programi i studimit ofron njohuri për praktikën profesionale, (p.sh nëpërmjet punësimit, projekteve etj)




Fig. 59

Studentët deklarohen mbi mundësitë e përfshirjes në punë praktike apo intership si pjesërisht të përfshirë në pjesën më të madhe në të gjitha IAL-të. Pak dhe aspak të përfshirë konsiderohen kryesisht studentët e UP-së, AAB dhe FAMA me vlerësimin.

V. ORGANIZIMI I STUDIMEVE

10. Ju lutem, jepni mendimin tuaj për aspektet e mëposhtme të organizimit të studimeve dhe metodat e vlerësimit.

Qasja në klasa (jo pritje ose mbivendosje oraresh)




Fig. 62

Këtu shihet qartë përparësia e IAL-ve private sa i përket infrastrukturës fizike në raport me ato publike.

Korrektësi në vlerësimin e provimeve




Fig.63

Në raport me korrektësinë në vlerësimin e provimeve IAL-të private dhe publike kanë rezultate të përafërta. Dallon më pak Universiteti i Prishtinës dhe është brenda të priturve tona, duke pasur parasysh kriteret pak ca më tradicionale të vlerësimit.

VI. PËRGATITJA PËR TREGUN E PUNËS

11. Ju lutem, jepni mendimin tuaj mbi mënyrën se si universiteti/ kolegji juaj promovon

lidhjen midis profesionit dhe tregut të punës në studimet tuaja

Ndihmon në gjetjen e një pune pas diplomimit (zyra e karrierës në universitet)




Fig. 64

Pyetjes se a ndihmon IAL-ja në gjetjen e një pune pas diplomimit (zyra e karrierës në universitet), pothuajse të gjitha IAL-të e kanë të paarritshme këtë detyrë dhe që të gjitha në masën në mes të 60-80% të përgjigjeve janë negative.

Njohuritë/aftësitë profesionale përputhen me tregun e punës




Fig. 65

Ndjesia e studentëve të intervistuar, lidhur me njohuritë/aftësitë profesionale dhe përputhjen e tyre me tregun e punës, rezulton mjaft e përafërt në katër IAL-të. Nga 38.9% deri në 44.9% e respondentëve konsiderojnë që njohuritë/aftësitë e tyre profesionale, vetëm pjesërisht përputhen me tregun e punës. Nga 3.7% deri në 14.3% konsiderojnë që njohuritë/aftësitë profesionale të tyre nuk përputhen (aspak) me tregun e punës dhe me fare pak janë nga 18.4% deri në 30% të studentëve. Vërehet një lloj optimizmi te studentët e IAL-ve publike, të cilët njohuritë/aftësitë profesionale i konsiderojnë si të mjaftueshme deri në masën 24.2%. Shumë të sigurt janë vetëm nga 8% deri në 13% e studentëve.

Ofron njohuri në gjuhët e huaja




Fig. 66

Ndjesia e studentëve të intervistuar, lidhur me njohuritë/aftësitë profesionale dhe përputhjen e tyre me tregun e punës, rezulton mjaft e përafërt në katër IAL-të. Nga 38.9% deri në 44.9% e respondentëve konsiderojnë që njohuritë/aftësitë e tyre profesionale, vetëm pjesërisht përputhen me tregun e punës. Nga 3.7% deri në 14.3% konsiderojnë që njohuritë/aftësitë profesionale të tyre nuk përputhen (aspak) me tregun e punës dhe me fare pak janë nga 18.4% deri në 30% të studentëve. Vërehet një lloj optimizmi te studentët e IAL-ve publike, të cilët njohuritë/aftësitë profesionale i konsiderojnë si të mjaftueshme deri në masën 24.2%. Shumë të sigurt janë vetëm nga 8% deri në 13% e studentëve.




Fig. 67

Kjo fushë duket një problem i madh dhe larg arritjeve mesatare nga të gjitha IAL-të e hulumtuara dhe çuditërisht IAL-të publike rezultojnë më mirë se ato private, kurse ndërlidhja me tregun e punës është pothuajse inekzistente.

VII. PËRKRAHJA NGA STAFI AKADEMIK DHE VLERËSIMI I MËSIMDHËNIES

12. Ju lutem, jepni mendimin tuaj për cilësinë e informacionit, ligjërimit nga stafi akademik në programin tuaj të studimit

Përfshirja e studentëve në një shkallë më të gjerë në përgatitje për vlerësime/akreditim të programeve




Fig. 68

Duket se ka një staf të motivuar dhe të gatshëm për përkrahje të studentëve; ekziston një korrektësi solide dhe konsistencë substanciale në mes të programit dhe vlerësimit pa paragjykuar cilësinë e programeve. Mirëpo përfshirja e studentëve në një shkallë më të gjerë në përgatitje për vlerësime dhe akreditim të programeve pothuajse në të gjitha institucionet duket e paarrtshme dhe ka hapësirë për përmirësim të dukshëm.

VIII. PËRKRAHJE PËR MOBILITET - QËNDRIM STUDIMOR JASHTË VENDIT

14. Jepni mendimin tuaj rreth mundësive dhe përkrahjes së universitetit ose kolegjit tuaj për të studiuar jashtë vendit

A vërehet interesi i universitetit/kolegjit ndaj programeve të përbashkëta me universitete jashtë vendit




Fig. 69

Këtu vërehet një mungesë e dukshme e mobilitetit, bashkëpunimit me jashtë, transferit dhe shkëmbimeve ndërkombëtare dhe mungesë mbështetje dhe këshillime nga të gjitha IAL-të për studime jashtë vendit.

Mbështetje për gjetjen e intershipeve/praktikave të punës jashtë vendit




Fig. 70

Edhe në këtë rast nuk ka dallim të madh në mes të IAL-ve publike dhe private dhe që të gjitha ngecin dukshëm në gjetjen e intershipeve/praktikave të punës jashtë vendit.




Fig. 71

IAL- publike kanë një epërsi të theksuar në raport me ato private, edhe pse edhe ato nuk është se qëndrojnë shumë lart në këtë pikë.

IX. SALLAT- AMFITEATROT-KLASAT

15. Ju lutem, jepni mendimin tuaj rreth sallave të ligjëratave dhe ushtrimeve të disponueshme për mësimdhënie.




Fig. 72

Kushtet teknike dhe hapësira është vlerësuar mirë dhe solide në përgjithësi, mirëpo IAL-të private janë dukshëm më mirë në këtë aspekt.

X. BIBLIOTEKA/SALLA LEXIMI

16. Ju lutem, jepni mendimin tuaj rreth bibliotekës/bibliotekave të disponueshme në universitetin/kolegjin tuaj

Gjendet literatura e nevojshme për studimet tuaja




Fig. 73

Mungojnë dukshëm shërbimet përkatëse për studime dhe qasje në burime shkencore në të gjitha IAL-të, nuk gjendet literatura e nevojshme për studime dhe qasje e kufizuar në libra dhe revista akademike dhe njëri nga IAL-të private (AAB) duket se ka një avancim në raport me të tjerat.

XI. INFRASTRUKTURA E IT-së DHE E-LEARNING-UT (TË MËSUARIT ONLINE)

17. Ju lutem, jepni opinionin tuaj rreth IT-së dhe pajisjeve kompjuterike për studentët kur mësimi elektronik ofrohet në studimet tuaja. Si u qaseni/Si i përdorni shërbimet online?

Mbështetja për përdoruesit dhe për studimin e pavarur (psh.platformat mësimore online)




Fig. 76

Digjitalizimi, e-learning (e-brary) janë të kufizuara ose mungojnë pothuajse në tërësi me pak ose fare mbështetje për mësimin dhe mësimdhënien nga shërbimet online, pa asnjë program të mësimin nga distanca apo sistemin telematik të studimeve. Çuditërisht IAL-të private mbesin mbrapa atyre publike.

XII. KLIMA E STUDIMIT

18. Ju lutem, jepni mendimin tuaj për aspektet e mëposhtme të klimës sociale në universitetin/kolegjin tuaj

Nëse do t'ju duhet të zgjidhni përsëri, a do të zgjidhnit sërish programin tuaj të studimit dhe institucionin aktual për herë të dytë?




Fig. 78

Vërehet një skepticizëm në të gjitha rastet dhe si duket këtu gjen shprehje mungesa e këshillimit dhe orientimit në karrierë në fazat e mëhershme të shkollimit, apo edhe për shkak të mungesës së perspektivës së punësimit përmes programeve aktuale.

XIII. ASPEKTE TË RËNDËSISHME TË STUDIMIT

21. Sa të rëndësishme janë për ju personalisht aspektet e mëposhtme të programit të studimit?




Fig. 79

Këtu duket së studentët e IAL-ve private i japin më shumë rëndësi këtij aspekti edhe pse ka një skepticizëm dhe paqartësi.

XIV. STATISTIKA - INFORMACIONE DEMOGRAFIKE

22. Tani dëshirojmë t'ju pyesim për disa informacione demografike shtesë.

Keni qenë më parë të regjistruar në një Institucion tjetër të Arsimit të Lartë?




Fig. 80

Këtu kemi një dallim substancial në mes të IAL-ve private dhe publike, ku si duket studentët adresë të parë për studim i kanë IAL-të publike dhe në pamundësi për t'u regjistruar vazhdojnë studimet në IAL-të private.

5.3 Analiza e hulumtimit të mekanizmave dhe politikave për sigurimin e cilësisë

5.3.1 Sfidat për menaxhimin efektiv të cilësisë sipas ekspertëve të AL

Siç është shpjeguar edhe të kapitulli për metodologjinë e aplikuar në kuadër të këtij hulumtimi, mendimi i ekspertëve të arsimit përbën një shtyllë të rëndësishme të formulimit të mendimit profesional dhe analitik. Intervista është realizuar me 7 ekspertë të arsimit (2 femra, 5 meshkuj) përmes teknikës së grupit focus-it: profesorë, ish-kryetarë dhe anëtarë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë nga Agjencia e Akreditimit (bordi dhe ekzekutivi), prorektorë, dekanë, drejtorë të departamentit të AL-ve në MASHT dhe ekspertë të jashtëm. Përzgjedhja e tyre është bërë duke u bazuar në përvojën dhe kontributin e tyre që i kanë dhënë arsimit të lartë në Kosovë që nga paslufta e deri tani edhe si drejtues ose ish-drejtues të IAL-ve apo hartues dhe zbatues të politikave arsimore.

Pyetjes se cilat kanë qenë sfidat kryesore në menaxhimin e cilësisë së AL-ve në Kosovë nga paslufta e deri më tani, ekspertët mendojnë se sfidat kryesore kanë qenë:

- Ripërtitja nga dëmtimi i shkaktuar gjatë kohës së luftës (1989-1999) në kohën kur AL ka punuar jashtë objekteve të destinuara për këtë qëllim.
- Rikthimi i tërë sistemit të arsimit në Kosovë në rrjedhat normale dhe rindërtimi i tij pas një periudhe të gjatë të funksionimit si sistem paralel në rrethana të jashtëzakonshme.
- Zënia e hapit të zhvillimit dhe reformimit të AL-së në Kosovë me atë në Evropë dhe përgatitja joadekuate me sfidat e reja të AL-së.
- Reformimi i AL-së në frymën e Deklaratës së Bolonjës dhe zhvillimi e promovimi i një kulture të cilësisë që do ta bënte AL të Kosovës pjesë të hapësirës evropiane të arsimit të lartë.

- Implementimi i reformave të promovuara në kuadër të procesit të Bolonjës nën kushte të presionit për më shumë vende studimi, por edhe për më shumë programe studimore.
- Menaxhimi dhe kontrolli i numrit të institucionave private të AL-së, që lulëzuan shpejt në periudhën e pasluftës.
- Pas një periudhe të gjatë me vetëm një Institucion të arsimit të lartë (Universiteti i Prishtinës) në Kosovë, një sfidë tjetër ka qenë edhe paraqitja e BPrAL e më vonë edhe rritja e numrit të institucioneve publike të arsimit të lartë.
- Në këto rrethana, është zhvilluar procesi aspak i lehtë i themelimit dhe konsolidimit të strukturave dhe mekanizmave të sigurimit të cilësisë brenda institucioneve të arsimit të lartë si dhe atyre të vlerësimit të jashtëm.
- Sfida tjetër, menjëherë pas lufte, AL-në kanë filluar ta administrojnë / menaxhojnë të politizuarit dhe të diplomuarit jashtë objekteve, duke zënë edhe pozita akademike.
- Gjetja e një modeli të mirë të politikave qeveritare për zhvillimin e indikatorëve të matshëm të cilësisë për Institucionet e Arsimit të Lartë në Kosovë që do të ishte kriter për financimin e IAL-ve nga MASHT-i dhe Qeveria.
- Mbajtja e një kontinuiteti në proceset dhe procedurat e zhvillimit të cilësisë në AL.
- Rishikimi dhe harmonizimi i programeve të studimit konform nevojave të tregut.

Por çfarë janë mundësitë sipas ekspertëve për adresimin adekuat të këtyre sfidave në të ardhmën? Ekspertët mendojnë se:

- Mundësitë për adresimin e këtyre sfidave në të ardhmen janë të mira, por kërkojnë përkushtim nga të gjitha palët e involvuara, duke filluar nga MASHT-i, AKA-ja, IAL-të publike dhe private si dhe partnerët ndërkombëtarë.
- Ndoshta edhe procesi i integrimi evropiane do t'i obligonte akterët politikë të Kosovës që Arsimin e Lartë ta bëjnë prioritet shtetëror, dhe kështu domodoshmërisht do të ngritej edhe cilësia e shumëpritur.
- Përmes shfrytëzimit adekuat të strukturave të themeluara më herët dhe përcjelljes së trendit të zhvillimeve dhe praktikave të mira në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.
- Rishikimi dhe harmonizimi i programeve konform nevojave të tregut dhe ndërlidhja më e mirë me ekonominë dhe industrinë.
- Përkushtimi adekuat i stafit të AL-së si dhe fokusimi i tyre në promovimin e punës së pavarur, duke kultivuar dhe promovuar punën e pavarur në sektorin privat.
- Stimulimi dhe mbështetja materiale dhe logjistike nga Qeveria.
- Ndryshime rrënjësore në strukturat menaxhuese, të kontrollit dhe të llogaridhënies.

Lidhur me çështjen se a janë hartuar nga qeveria politika adekuate arsimore për të përmirësuar menaxhimin e cilësisë së AL-së? - Cilat janë rezultatet pozitive dhe cilat janë ato negative të këtyre politikave të AL-së? - Ekspertët kanë mendim të unifikuar dhe shprehen si në vijim:

- Politikat qeveritare për zhvillimin, ngritjen dhe menaxhimin e cilësisë në Arsimin e Lartë kanë qenë të pjesërishme. Këto politika janë hartuar edhe me përkrahjen e partnerëve ndërkombëtarë dhe si të tilla kanë synuar që me hapa të shpejtë të bëjnë konsolidimin e mekanizmave për vlerësim dhe kontroll të cilësisë dhe aplikimin e standardeve adekuate dhe praktikave të mira. Ka munguar veprimi për zbatim.
- Ka pasur disa përpjekje të qeverisë për të hartuar politika adekuate arsimore, por për arsye të ndryshme nuk kanë treguar rezultatet e pritura! Në përgjithësi mund të thuhet se si rezultat i këtyre politikave sot kemi IAL-të publike që gjithnjë e më shumë po humbin peshën, rëndësinë dhe hapësirën në AL të Kosovës.
- Si rezultat pozitiv e shohin përkrahjen e reformave sipas Deklaratës së Bolonjës dhe zhvillimit të legjislacionit të AL-së në këtë frymë, ku bënë pjesë edhe themelimi dhe funksionalizimi i Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe fillimi i procesit të akreditimit të IAL-ve në Kosovë. Me këto zhvillime fillon edhe zhvillimi i një sistemi për vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të cilësisë së AL-së.
- Rezultate pozitive mund të konsiderohen ato që kanë të bëjnë me organizimin dhe strukturimin adekuat të institucioneve të arsimit të lartë si dhe të sektorit të arsimit të lartë në përgjithësi. Rezultate konkrete janë edhe themelimi dhe konsolidimi i strukturave përgjegjëse për sigurimin e cilësisë si dhe anëtarësimi i AKA-së në struktura përkatëse evropiane.
- Rezultatet negative sipas ekspertëve të AL-së konsiderohen: mungesa e përkushtimit të Qeverisë dhe MASHT-it për të zhvilluar arsim cilësor në vend.
- Ndërhyrjet politike në punën dhe pavarësinë e Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe në pavarësinë universiteteve publike.

- Institucione private të Arsimit të Lartë profitabile në vend që të janë jofitimprurëse, ato përkundrazi i kemi IAL-të private (fitimprurëse-biznese), të cilat për çdo ditë e më shumë po e gllabërojnë hapësirën e AL-së (të pa merituar) në Kosovë.
- Mungesa e kontinuitetit të proceseve për sigurimin dhe menaxhimin e cilësisë nga MASHT-i.
- Disa nga rrethanat e pafavorshme të krijuara në proces e sipër, të cilat mund të konsiderohen edhe si “efekte anësore”, kanë qenë edhe ndikimi i tregut të arsimit të lartë nga vendet fqinje, të cilat kanë qenë në faza të ndryshme (më të vonuar sesa ne) të konsolidimit të këtyre mekanizmave.
- Buxhet jo i mjaftueshëm për të zhvilluar sistem të mirë të zhvillimit dhe menaxhimit të cilësisë në IAL-të publike.
- Një rezultat negativ në raport me strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, ka qenë përjashtimi i AKA-së nga mekanizmat në nivel evropian (EQAR).

Sa i përket dokumenteve strategjike të AL-së, legjislacionit dhe rolin e tyre në implementimin e politikave për përmirësimin e cilësisë së AL-së, si dhe a kanë qenë adekuate dhe sa janë zbatuar në funksion të përmirësimit të cilësisë së AL-së ?- ekspertët pajtohen se ngecja më e madhe ka të bëjë me zbatimin e tyre dhe adresimi në mënyrë teknike i reformave dhe jo si një frymë që sjellë ndryshime pozitive. Më detajisht shprehen se:

- Dokumentet strategjike të AL-së kanë qenë më shumë teknike sesa praktike; implementimi i tyre në të shumtën e rasteve ka dështuar.

- Dokumentet strategjike (që gati gjithmonë janë përgatitur me ndihmën e institucioneve të huaja), shpeshherë edhe kanë qenë adekuate dhe në harmoni me nevojat e vendit, por fatkeqësisht nuk janë zbatuar në funksion të përmirësimit të AL-së (shpeshherë për arsye të papërgjegjshmërisë së akterëve lokalë ose qendrorë). Prandaj implementimi i pjesshëm ose asimetrik i tyre ka qenë shqetësim i vazhdueshëm.
- Në mungesë të implementimit të plotë dhe promovimit të tyre, roli i tyre në reformën e AL-së ka pasur influencë minore.
- Hapa të rëndësishëm janë bërë në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, aplikimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies, përmirësimi i shërbimeve për studentë etj., derisa ngecje e theksuar mund të konstatohet në “komunikimin” e mangët me tregun e punës dhe ish-student/me alumni (për të marrë një feedback).
- Legjislacioni (Ligji për Arsimin e Lartë) është zhvilluar në frymën e reformave sipas Deklaratës së Bolonjës, mirëpo në shumë çështje mbetet i paqartë dhe interpretohet sipas rastit.
- Ligji për AL-të në Kosovë ka ndikuar pjesërisht në përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë.

Ndërsa ku bëhët fjalë përkrashjen e BE-së dhe sa janë të përshtatshme programet e BE-së (p.sh. Tempus) për përkrashjen e sistemit arsimor të Kosovës - me theks në përmirësimin e cilësisë së AL-së. Pastaj se a janë kuptuar sa duhet këto programe nga akterët lokalë dhe a kanë qenë në gjendje akterët evropianë të formulojnë programe komplekse për t'iu përshtatur kontekstit dhe kapacitetit lokal?- ekspertët kanë mendime të diversifikuara dhe shprehen se:

- Programet e BE-së për përkrashjen e AL-së në Kosovë kanë qenë dhe mbetin shumë të rëndësishme për zhvillimin e AL-së në Kosovë. Në periudhën që po vlerësohet, janë

implementuar shumë programe për zhvillimin e kurrikulave në partneritet me universitetet nga Evropa dhe rajoni, janë implementuar programe “Tempus” për zhvillimin e udhëzuesve dhe proceseve për sigurimin e brendshëm të cilësisë në IAL-të publike dhe private në Kosovë. Janë zhvilluar programe që nxisin zhvillimin e hulumtimit shkencor (programet PhD), është përkrahur themelimi i AKA-së dhe zhvillimi i kapaciteteve.

- Këto programe jo gjithëmonë janë përkrahur nga IAL-të, për shkak të mungesës së kapaciteteve për t'i zhvilluar projektet dhe absorbuar fondet. Njëkohësisht duhet të ceket se ka munguar edhe përpjekja dhe interesimi i një pjese të stafit akademik të IAL-ve për të aplikuar në këto programe, por edhe mbështetja institucionale (nga vetë IAL).
- Sa u përket vetë programeve të ofruara nga partnerët evropianë, ato në të shumtën e rasteve kanë qenë në përputhje me nevojat e AL-së në Kosovë, por ka pasur edhe raste kur kanë qenë të ngutshme, pa përgatitje paraprake si dhe ka ndodhur që të ketë përputhje të madhe në mes të programeve të ofruara nga akterë të ndryshëm në të njëjtën kohë.
- Programet e BE-së, kryesisht kanë qenë të disanjuara në formë të përshtatshme për të përkrahur sistemin arsimor të Kosovës. Në veçanti, programet TEMPUS kanë “shoqëruar” në kontinuitet ngritjen e sistemit për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë.
- Të kuptuarit e rëndësisë së këtyre programeve dhe shkalla e pjesëmarrjes në to, ka përjetuar ngritje- rënie nëpër vite dhe atë në varësi nga strukturat udhëheqëse në nivel nacional dhe atë të institucioneve të arsimit të lartë, pra, në faza të caktuara, duke patur një qasje adekuate të strukturave menaxheriale, këto programe janë shfrytëzuar në mënyrën dhe nivelin e duhur duke bërë hapa të rëndësishëm përpara në proces.

Njëri nga ekspertët mendon se BE-ja aplikon programe standarde dhe që nuk janë shfrytëzuar sa duhet nga vendorët dhe ndanë këtë mendim:

- Programet e BE-së (janë programe standarde që aplikohen gjithandej në shtetet e BE-së), kanë qenë dhe janë të përshtatshme, por fatkeqësisht rrallë herë janë shfrytëzuar mjaftueshem nga IAL-të dhe shumë rrallë herë kanë treguar zhvillim të qëndrueshëm për institucionin pas përfundimit të investimeve (shpeshherë vetëm për arsye të papërgjegjshmërisë së akterëve vendimmarrës).
- Programet evropiane zakonisht janë bërë në bashkëpunim me stafin lokal dhe bazuar në nevojat e vendit, mirëpo akterët vendimmarrës shpeshherë nuk kanë treguar interes të mjaftueshem për implementimin dhe futjen e tyre si programe integrale të IAL.

Kurse një ekspert mendon krejtësisht ndryshe duke potencuar se programet e BE-se nuk kanë qenë në harmoni me nevojat vendore dhe nuk kanë qenë të qëndrueshme duke shtjelluar argumentimin e tij si në vijim:

- Programet e propozuara shpesh nuk kanë qenë konform nevojave vendore.
- Projektet e përzgjedhura nga MASHT-i dhe të aprovuara nga BE-ja kanë pasur jetëgjatësi aq sa ka zgatur investimi dhe zgjatja e projektit. Vazhdimësia e shumicës së këtyre projekteve, kur janë bartur te vendorët, në mungesë të mbështetjes materiale dhe promovuese, thuajse kanë përfunduar.
- Këto programe, si gjatë implementimit e madje edhe me vonë shpesh janë identifikuar si projekte të individëve të caktuar dhe me ndërrimin e menaxhmentit nuk kanë pasur vazhdimësi.
- Po ashtu, mungesa e vazhdimësisë së implementimit strategjik të programeve prioritare nga menaxhmenti paraparak e ka dëmtuar dukshëm përmirësimin e cilësisë në AL.

Cili është mendimi i ekspertëve për rolin dhe rëndësinë e donatorëve bilateralë (nga shtete të caktuara) në funksion të zhvillimit dhe zbatimit të programeve dhe politikave për përmirësimin e cilësisë?. Shumica prej tyre e vlerësojnë lart rolin dhe rëndësinë e donatorëve, duke potencur ndikimin e madhe të tyre në reformimin e sistemit arsimor. Ata mendojnë se:

- Shumë prej këtyre programeve kanë qenë kruciale për zhvillimin e politikave dhe sistemeve për përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë. Duhet patjetër të ceket roli i Austrisë në përkrahjen e programeve për përmirësimin e cilësisë në AL në Kosovë.
- Roli i donatorëve ka qenë shumë i rëndësishëm në faza të caktuara të zhvillimeve. Krahas mjeteve të dedikuara, donatorët kanë qenë të përfshirë edhe në procesin e identifikimit të nevojave dhe artikullimit të masave që duhen ndërmarrë. Në këtë kontekst, në fushën e arsimit të lartë, vlen të theksohen projektet e përkrahura nga Austria që kanë ndikuar shumë në ngritjen e kapaciteteve në fushën e sigurimit të cilësisë dhe jo vetëm.
- Nga ana tjetër, roli dhe efikasiteti i përkrahjes së donatorëve ka qenë i ndikuar edhe nga angazhimi i institucioneve të Kosovës. Koordinimi i mirë i donatorëve ka qenë dhe është i nevojshëm (nganjëherë ka munguar) që të adresohen më mirë nevojat.

Njëri nga ekspertët ndan një mendim ndryshe dhe pohon si në vijim:

- Mendoj se këto donacione kanë ndihmuar individ ose institucione te veçanta, por nuk kanë pasur ndonjë ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë në AL.

Kur kemi të bëjmë me harmonizimin e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës (ekonomisë dhe industrisë), të gjithë ekspertët janë skeptikë. Ata konfirmojnë gjetjet e

hulumtimit duke u pajtuar se kemi një shpërputhje të madhe të kërkesave me ofertën, gjë që vë në dyshim cilësinë e programeve studimore, por edhe pamjaftueshmërinë e të dhënave të plota nga tregu i punës. Ata mendojnë se:

- Të dhënat janë fragmentare dhe të pamjaftueshme për të sjellë konkludime të tilla.
- Nga ana tjetër, në përgjigje ndaj trendeve aktuale, nevojitet një analizë që nuk kufizohet vetëm në kërkesat e tregut kosovar, por edhe më gjerë. Duke marrë në konsiderim zhvillimet aktuale, është e nevojshme që studentët, por edhe institucionet e arsimit të lartë dhe Qeveria, t'i marrin në konsiderim të dhënat nga analiza e tregut të punës në një shkallë më të gjerë.
- Programet e studimit për fushat e rregulluara profesionale (mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinë, infermieri, etj.) deri diku i përshtaten tregut të punës, kurse programet e tjera më shumë kanë përmbajtje teorike akademike sesa zhvillim të njohurive dhe shkathtësive për nevojat e tregut të punës. Mungesa e zhvillimit më të lartë ekonomik dhe tregut jo të rregulluar të punës ka ndikuar në këtë gjendje. Këtu ndikon edhe mospërfshirja e partnerëve nga industria dhe biznesi-punëdhënësve në hartimin e kurrikulave që do të përshtateshin me nevojat e tregut të punës.
- Prandaj mund të konkludohet se programet e studimit nuk janë të harmonizuara me kërkesat e tregut në Kosovë edhe për këto arsye:
Në Kosovë nuk kemi të dhëna të besueshme statistikore rreth nevojave të tregut të punës dhe nuk ekziston bashkëpunim i mjaftueshëm në mes të IAL-ve dhe tregut të punës në Kosovë.
- Po ashtu, hiperproduksioni i kuadrove intelektuale vendore tejkalon mundësitë e kapaciteteve vendore për punësim, si në sektorin publik, ashtu edhe në sektorin privat.

Ndërsa pyetjes se a kanë arritur BPrPAL që të përmirësojnë performancën e tyre në raport me menaxhimin e cilësisë dhe cilët janë shembujt konkretë? - Ekspertët e kanë relativisht të vështirë të gjëjnë shembuj konkretë dhe janë më retorikë, por edhe të shkurtër në përgjigje, duke kërkuar përgjegjësi më të madhe nga IAL-të dhe pohojnë:

- Pjesërisht. Mendoj se Institucionet e Arsimit të Lartë në Kosovë, si ato publike edhe ato private, ende nuk e kanë të qartë se përgjegjësia për sigurimin e cilësisë është përgjegjësi e tyre. Ato janë të obliguara që në interes të studentëve dhe të të gjitha palëve të tjera, duke përfshirë edhe qeverinë si financuese, të ofrojnë arsim cilësor që mundëson zhvillimin e një qytetari të ndërgjegjshëm dhe të gatshëm për tregun e punës.
- Një shembull i mirë i përmirësimit të performancës së menaxhimit të cilësisë mund të mirret rritja e numrit të publikimeve shkencore në Universitetin e Prishtinës në këto dy vitet e fundit.

Krahas përgjigjeve në pyetjet analitike, ekspertët japin një varg rekomandimesh, por edhe në formë deklaratash. Pyetjes se çka rekomandoni për të përmirësuar AL-në në përgjithësi dhe menaxhimin e cilësisë së AL-së në veçanti? - ata rekomandojnë:

- Thënë në mënyrën më të përmbledhur, cilësia në arsimin e lartë nuk do të duhej të thjeshtohet deri në atë masë sa të nënkuptojë vetëm një program studimi të shkruar mirë (një botëkuptim, i cili është mjaft i shpeshtë), por një kompleks i komponentëve të cilat mbizotëron suksesi dhe performanca e të diplomuarve në tregun e punës në një shkallë të gjerë.
- Rekomandojnë përkushtim maksimal të IAL-ve për sigurimin dhe menaxhimin e cilësisë, si dhe përkrahje nga Qeveria dhe MASHT-i për të gjitha proceset që kanë të bëjnë me sigurimin dhe menaxhimin e cilësisë.

- Përfshirja me e madhe e studentëve në proceset e menaxhimit të cilësisë është e domosdoshme.
- Njëra prej mundësive do të ishte që IAL-të t'i marrin (adaptojnë) programet e studimit nga shtetet e BE-së, sepse këto shtete, në njërin anë i përcjellin parametrat e tregut të punës dhe në anën tjetër programet e BE-së u ofrojnë studentëve dhe të diplomuarve tanë akses më të lehtë në vazhdimin e studimeve si edhe në tregun e punës në shtetet e BE-së.
- Promovimin dhe mbështetjen e individëve/profesionistëve të dëshmuar pozitivë me integritet të lartë profesional, vlera pozitive dhe me guxim reformues e intelektual.
- Përzgjedhja e menaxherëve të AL-ve të bazohet në programe e assesi përmes influencës politike dhe influencave të tjera që për bazë nuk kanë cilësinë.
- Rekomandim tjetër është që të mos lejohen improvizime kozmetike të këtyre proceseve në BPrAL por ato të jenë konkrete dhe të matshme.
- Duhet promovuar dhe mbështetur profesionistët e përgatitur me ide dhe vlera pozitive dhe reformatore, personat e dëshmuar, pa marrë parasysh përkatësitë politike-partiake. Politikat aktuale nuk promovojnë kuadro cilësore, profesionale dhe me aftësi pozitive reformuese.

Si përfundim në pyetjen për ndonjë sugjerim dhe këshillë që mund të mos jetë përfshirë në kuadër të pyetjeve, ata japin këto sugjerime:

- Një temë që patjetër duhet të përfshihet është informimi i publikut për cilësinë dhe menaxhimin e saj në IAL në Kosovë që do të ndikonte në rritjen e

besueshmërisë në IAL si dhe në rritjen e transparencës dhe konkurrencës në mes të IAL-ve.

- Të organizohen më shumë takime dhe tryeza të rrumbullakëta për proceset e sigurimit dhe menaxhimit të cilësisë me të gjitha palët e interesuara;
- Të gjinden mëyra se si të motivohet stafi akademik i IAL-ve për ngritjen e cilësisë;
- Të fuqizohet roli i vlerësimeve interne/eksterne të stafit të AL-së në ngritjen e cilësisë;
- Të fuqizohet roli i regulloreve të IAL-ve për zgjedhjen/avancimin e stafit akademik;
- Të rritet përgjegjësia dhe llogaridhënia (personale) e stafit akademik të IAL-ve në ngritjen e cilësisë;
- Të përfshihet implementimi i nevojave të tregut në programet studimore të AL-ve;
- Mbështetja dhe promovimi i personave të dokumentuar për cilësi dhe me përgjegjësi, jo vetëm nga rangu vendor, por edhe nga ai ndërkombëtar;
- Përzgjedhja e stafit menaxherial dhe edukativ në AL, të bazohet në programe cilësore në konkurrencë të barabartë;
- Organizimi i trajnimeve konkrete dhe gjithëpërfshirja e stafit akademik;
- Të mos eksperimentohet me sisteme të reja dhe të padëshmuara në sistemin edukativ.

Ndërsa për fund kanë shtruar edhe një pyetje apo dilemë se: a duhen favorizuar të doktoruarit në BE me IAL?

5.3.2 Sfidat për menaxhimin e cilësisë sipas Koordinatorëve për Sigurimin e Cilësisë të IAL-ve

Në intervistat e realizuara me Koordinatorë për Sigurimin e Cilësisë në kuadër të IAL-ve publike dhe private del në pah se ekzistojnë shumë elemente të përbashkëta formale sa i përket sigurimit të cilësisë.

Në njërën apo mënyrën tjetër vërehet se kriteret dhe mekanizmat për sigurimin e cilësisë në kuadër të IAL-ve kryesisht janë të ndërlidhura me kriteret dhe kërkesat e AKA-së për SC dhe vijnë si rezultat i ndikimit të sigurimit të jashtëm të cilësisë dhe jo si kërkesë dhe nevojë e brendshme e IAL-ve.

Ekzistojnë ngjashmëri, por edhe dallime sa i përket sfidave, procedurave dhe mënyrës së menaxhimit të cilësisë në kuadër të institucioneve përkatëse.

Sfidat kryesore në menaxhimin e cilësisë në IAL-të private konsiderohen:

- Përmbyshja e kriterëve formale për akreditim;
- Përqendrimi i madh i energjisë dhe burimeve të institucionit për përmbyshjen e kriterëve të AKA-së;
- Ndryshimi i shpeshtë i legjislacionit nga ana e MASHT-it dhe AKA-së dhe koha e shkurtër për implementimin e tyre;
- Dallimet dhe diskriminimi i sektorit privat në raport me sektorin publik;
- Përceptimi se siguri i cilësisë është proces i lidhur direkt me procesin e akreditimit, dhe jo që procesi i sigurimit të cilësisë duhet të jetë proces i rregullt dhe normal i punës së përditshme të institucionit.

Ndërsa sfidat kryesore në IAL publike konsiderohen:

- Përshtatja trendeve të reja sipas standardeve të Bolonjës;
- Akreditimi i parë institucional në vitin 2008;

- Reformimi i kurrikulave, duke filluar të përcaktohen edhe rezultatet e të nxënit.

Lidhur me procedurat e shkruara për sigurimin e cilësisë (*për vlerësimin dhe monitorimin e studentëve*) IAL-të kanë bërë një avancim në këtë drejtim, duke hartuar rregullore ku parashihen proceset e sigurimit të cilësisë, të cilat nuk lidhen vetëm me vlerësimin dhe monitorimin e studentëve, mirëpo përfshijnë edhe kurrikulat, vlerësimin e stafit nga ana e studentëve, vlerësimin e brendshëm për akreditim dhe raporte të rezultateve të përgjithshme.

Vlen të theksohet se IAL-të private duket se prijnë sa i përket hartimit të këtyre dokumenteve, por që në raport me vlerësimin e studentëve si IAL private edhe ato publike bazohen kryesisht në metodat e vlerësimit të përshkruara në kurrikulat përkatëse, të cilat dallojnë nga njëri program te tjetri apo edhe prej njërit kurs në tjetrin. Standardizimi i silabuseve ka ndikuar në përmirësim të procesit të vlerësimit , por që ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm.

Gjatë diskutimit me koordinаторët për SC të IAL-private janë prezentuar disa rregullore në nivel të institucionit për procedurat e sigurimit të cilësisë, duke filluar nga Strategjia Zhvillimore, e cila ka të përfshirë një kapitull për sigurimin e cilësisë, pastaj Udhëzuesin për Sigurimin e Cilësisë, Rregulloret për Studime Bachelor dhe Master, planet vjetore dhe semestrale në të cilat parashihen proceset e sigurimit të cilësisë, të cilat nuk lidhen vetëm me vlerësimin dhe monitorimin e studentëve, mirëpo më shumë përfshijnë:

- Standardizimin, monitorimin dhe implementimit e silabuseve
- Vlerësimin e brendshëm për akreditim
- Monitorimin e suksesit të studentëve

Edhe Universiteti i Prishtinës si IAL më i madhi në vend ka procedura të shkruara për sigurimin e cilësisë të përmbledhura në Rregulloren për Sigurim të Cilësisë, por për dallim nga ato private njësit akademike janë përgjegjëse për SC në raport me vlerësimin dhe monitorimin e studentëve.

Për shembull në rastin e kolegjit AAB dhe UP-së, rregulloret janë të publikuara në ueb-faqet e tyre (AAB-së² dhe UP³).

² <https://aab-edu.net/en/about-aab/policies-and-regulations/>

³ www.uni-pr.edu

E përbashkëta negative e të dy formave të IAL-ve (private dhe publike) është mungesa e evidencës së përqindjes mesatare të kalueshmërisë së studentëve në një afat të provimeve (gjatë pesë viteve të fundit).

Në të dy rastet IAL-të nuk kanë statistika, gjë që ndikon negativisht në procesin e përmirësimit të cilësisë së vlerësimit dhe monitorimit të studentëve.

Ngjajshëm si më lart kemi të bëjmë edhe me procedurat e shkruara për vlerësimin e stafit mësimdhënës ku ekzistojnë rregullore në nivel të institucionit për procedurat e sigurimit të cilësisë. Ndër të tjera, merren për bazë edhe planet vjetore dhe semestrale në të cilat parashihen proceset e sigurimit të cilësisë që përfshijnë edhe standardizimin, monitorimin dhe implementimin të silabuseve.

IAL-të private (në këtë rast AAB) në kuadër të vlerësimit të punës së stafit bëjnë edhe:

- Monitorimin e platformës online – përkatësisht monitorimi i punës së stafit akademik për sa i përket publikimit të materialeve elektronike në platformat online;
- Pjesëmarrja nëpër takime javore me staf akademik të organizuar nga dekani;
- Vlerësimi i brendshëm për akreditim;
- Trajtime dhe aftësi për kolegët në fushën e kurrikulës, metodologjisë së mësimdhënies, etj.
- Vlerësimet e stafit akademik nga studentët, vlerësimet për administratën dhe shërbimet studentore pas përfundimit të semestrit;
- Hartimi i raporteve semestrale pas përfundimit të semestrit.

Vlerësimet e studentëve për staf, lëndët përkatëse dhe administratën janë vlerësime online ‘anonime’ nga studentët dhe organizohen dy herë brenda vitit akademik.

Çështje mjaft e hapur mbetet mënyra dhe përmbajtja e vlerësimit të studentëve për stafin ku më tepër matet kënaqshmëria e studentëve me performancën e profesorëve sesa vlerësimi i bazuar në kritere dhe parametra të qarta lidhur me përmbajtjen dhe cilësinë e studimeve.

IAL-të publike kanë procedura standarde të vlerësimit të stafit mësimdhënës, ku këto i ka të përfshira në rregulloren për sigurim të cilësisë dhe për shfrytëzim të rezultateve të vlerësimit.

Edhe në këtë rast është i paraparë vlerësimi që bëhet nga ana e studentëve për profesorë, por nuk ka një evidencë për përcjellje të rezultateve të vlerësimit.

Pyetjes se si keni arritur ta mbikëqyrni punën e stafit akademik në realizimin e kriterëve të cilësisë në institucionin tuaj?

IAL-private potencojnë se përpos pyetësorëve të studentëve, një mekanizëm tjetër që shërben për vlerësim të stafit është hartimi i raporteve semestrale nga dekanët. Pas përfundimit të çdo semestri, secili fakultet është i obliguar që të hartojë një raport semestral të fakultetit në të cilën raportohet mbarëvajtja e procesit mësimor, përkatësisht raportohet se a ka pasur orë të humbura, arsyetimet në lidhje me orët e humbura, numri i zëvendësimeve që janë bërë për orët e humbura, të dhëna në lidhje me vijueshmërinë e studentëve, numri i publikimeve të stafit në portalin E-profesor dhe në fund raporti i suksesit në të cilin shkruhet përqindja e kalueshmërisë në tri afatet e provimeve qershorit, shtatorit dhe nëntorit.

Duhet të potencohet se kjo evidencë për përqindjen e kalueshmërisë në tri afatet e provimeve nuk është paraqitur nga asnjëri institucion dhe si duket është vetëm një dispozitë e shkruar, por që të paktën nuk është prezentuar dhe as nuk është publike.

Ndërsa tek IAL-të publike procesi i mbikëqyrjes së punës të stafit akademik është proces i decentralizuar ku përgjegjës është menaxhmenti i njësisë akademike përkatëse. Çdo njësi akademike ka në strukturën e vet organizative dekanin dhe prodekanët, të cilët janë përgjegjës për mbikëqyrje dhe që i raportojnë menaxhmentit të univeristetit për progresin apo problemet e hasura gjatë mbarëvajtjes së procesit mësimor. Menaxhmenti i universitetit në bashkëpunim me menaxhmentët e njësive akademike bëjnë vlerësimet e stafit akademik në baza semestrale. Në bazë të vlerësimeve bëhet edhe monitorimi i performancës së mësimdhënësve gjatë procesit mësimor.

Nuk ka ndonjë evidencë se ku përfundojnë efektet e këtyre vlerësimeve dhe as cilat janë saksionet apo benefitet e këtyre vlerësimeve për stafin.

Këshillat profesionale që zyrat për zhvillim akademik (ZZhA- për sigurim të cilësisë) ua ofrojnë profesorëve/ligjëruesve dhe asistentëve në funksion të përmirësimit të cilësisë ka për

qëllim t'u ndihmojë dhe të përkrahë institucionin në sigurimin e cilësisë dhe akreditimin institucional të programeve të studimit. Në këtë kontekst ZZHA e IAL-ve publike përmes Koordinatorëve për Zhvillim Akademik bëjnë shpërndarjen e informatave që ndërlidhen me procesin e sigurimit të cilësisë dhe të akreditimit. Në kuadër të kësaj, ZZHA ofron këshilla lidhur me standardet e cilësisë, përpilimit të rezultateve të të nxënësve, llogaritja e ECTS kredive, njohja e kredive nga mobilitetet, përpilimi i raporteve të vetëvlerësimit, etj.

Zyrat për zhvillim akademik të IAL-ve private theksojnë se nuk ka këshilla profesionale për sigurim të cilësisë, mirëpo secilit profesor i kërkohet që të përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë e tyre sipas kontratës së punës. Nëse gjatë monitorimit të tyre, apo nëse në çastin kur një profesor merr përqindje të ulët nga vlerësimi i përgjithshëm i studentëve apo merr komente negative nga studentët, dekanati i fakultetit përkatës në bashkëpunim me prorektorin për çështje mësimore sigurohet që të adresojë vërejtjet te profesori përkatës, dhe më pastaj të vendoset se si të procedohet tutje. Stafit akademik i kërkohet që të harmonizojnë silabuset e tyre, të implementojnë me saktësi silabusin e tyre ashtu siç është dorëzuar për akreditim, të përdorin E-Service dhe të publikojnë ligjëratat e tyre për studentë, të bëjnë të paktën një publikim shkencor brenda një vitit akademik, të marrin pjesë në projekte dhe konferenca vendore dhe ndërkombëtare si dhe të përfshijnë studentët në këto projekte dhe aktivitete të tjera me interes për ta.

Pyetjes se cilat janë kërkesat nga stafi lidhur me procedurat për sigurimin e cilësisë, ZZHA të IAL-ve publike thonë se kërkesat e stafit për procedurat e sigurimit të cilësisë ndërlidhen me informatat e nevojshme për proces të akreditimit; shpërndarja e orëve dhe ECTS-ve për angazhim të studentëve gjatë studimeve; informata mbi mekanizmat e cilësisë; informata mbi rezultatet e të nxënësve etj.

Kur bëhet fjalë për zhvillimin profesional dhe trajnime për stafin akademik në lëmin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë IAL-të nuk ofrojnë evidencë apo raport për këtë. IAL-të private në këtë rast AAB potencon se organizon trajnime për stafin akademik në baza vjetore që përfshijnë këto fusha: sigurimin e cilësisë (gjitha komponentët e saj), metodat e mësimdhënies,

metodat e vlerësimit për studentë, metodologjinë e punimeve shkencore dhe publikimin e tyre në revista ndërkombëtare etj.

Kurse IAL-të publike përgjigjen se në fillim të implementimit të standardeve të cilësisë në vitin 2009 kanë ofruar trajnime më të shpeshta të organizuara gjithashtu edhe me ekspertë ndërkombëtarë. Tani zyra është e hapur përmes koordinatoreve për zhvillim akademik që në baza edhe ditore të ofrojnë këshilla për stafin akademik sa i përket çështjeve që ndërlidhen me sigurim të cilësisë. Por nuk prezantojnë ndonjë plan apo dëshmi të trajnimit të stafit gjatë viteve të fundit.

Pyetjes se a po e luan si duhet rolin e vet Agjencia e Kosovës për Akreditim në menaxhimin e sigurimit të cilësisë, institucionet private dhe publike të AI-së dallojnë në mendime.

Përderisa IAL-të publike shprehen se deri tani AKA-ja ka pasur rol shumë të rëndësishëm në ngritjen e cilësisë, IAL-të private mendojnë se AKA-ja nuk është duke kryer rolin e saj, për shkak të disa ndryshimeve që kanë ndodhur në menaxhment dhe se ende dëmi i shkaktuar nuk është rikuperuar plotësisht. Përpos vlerësimit me ekspertë në këtë vit dhe tërheqjes së disa vendimeve për akreditim në bazë të vlerësimit të stafit akademik, AKA-ja nuk ka bërë asnjë veprim në drejtim të monitorimit, nuk ka rritur resurset e saj njerëzore dhe nuk ka investuar në fusha të tjera që janë të nevojshme për funksionimin e Agjencisë. Sipas tyre në vitin e fundit, AKA-ja ka shkëputur komunikimin me IAL-të, që janë palët kryesore të interesit për procesin e akreditimit, dhe në këtë mënyrë palët gjithnjë e më pak po janë të informuara për procesin e vendimmarrjes së AKA-së. Për mua, nuk mjafton bërja e procesit të akreditimit transparent përmes mediave dhe shoqërisë civile, sepse transparenca fillimisht fillon me IAL-të. Vendimet e akreditimit i afektojnë IAL-të fillimisht dhe pastaj shoqërinë e gjerë.

Mendimi i IAL-ve për kriteret dhe standardet për akreditim që ka vendosur AKA-ja në dy vitet e fundit, dallojnë në qasje, por jo edhe në përmbajtje.

Kolegjet private mendojnë se pas vitit të parë të implementimit të tyre, është e nevojshme që AKA-ja të bëjë një tryezë diskutimi me të gjithë IAL-të dhe ekspertët ndërkombëtarë të

akreditimit të përfshirë në procesin e akreditimit për të vlerësuar nëse të gjitha standardet dhe udhëzuesit kanë qenë të përshtatshëm për sistemin tonë të sigurimit të cilësisë. Ato mendojnë se disa standarde duhet të rishikohen, disa të largohen dhe disa të tjera të shtohen, mirëpo i gjithë ky proces duhet të bëhet në bazë të një procesi të mirëfilltë vlerësimi dhe me pjesëmarrje të gjerë të të gjithë akterëve.

Sipas tyre kriteret nuk janë shumë të ashpra, vetëm disa prej tyre janë më inovative për sistemin tonë të sigurimit të cilësisë, mirëpo në asnjë mënyrë ato nuk mund të ndikojnë negativisht në vlerësimin e përgjithshëm për një institucion.

Përfundimisht, mendojnë se Manuali i ri i AKA-së, së bashku me shtojcat e tij, është një dokument gjithëpërfshirës i mirëfilltë, i cili i është dashur AKA-së vite më parë dhe si i tillë duhet të vazhdojë të implementohet.

IAL-të publike mendojnë se këto standarde janë vazhdim i standardeve paraprake dhe nuk janë kërkesa të reja, për shkak se ndërlidhen ngushtë me European Standards and Guidelines(ESG) dhe janë në linjë me kërkesat dhe standardet e procesit të Bolonjës. Andaj mendojnë se AKA-ja ka bërë vetëm ndryshimin e formave të Raporteve të Vetëvlerësimit ndërsa në standard nuk ka shumë ndryshim, përveç SWOT analizave, të cilat janë vendosur për secilën fushë të vlerësimit në Raport të Vetëvlerësimit të AKA-së.

Në kuadër të intervistave janë kërkuar edhe rekomandimet tyre për të ardhmen për përmirësimin e cilësisë.

Rekomandimet kryesore janë:

- çdo institucion duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme që siguri i cilësisë të mos jetë një proces formal, i cili fillon dhe përfundon me procesin e akreditimit të kryer nga AKA-ja, mirëpo të jetë një proces normal, i cili bën pjesë në planifikimin dhe menaxhimin ditor të institucionit;
- përpos procesit të vlerësimit periodik të cilësisë, i cili ndodh me rastin e akreditimit, institucionet duhet të prezantojnë një sërë mekanizmash të tjerë, të cilat kanë për synim të ndërgjegjësojnë secilin pjesëtar të komunitetit akademik brenda tyre për

përgjegjësitë dhe obligimet e tyre që ata kanë ndaj studentëve dhe procesit mësimor akademik;

- të mos vazhdohet me improvizim të sigurimit të cilësisë vetëm për të përmbushur kërkesat formale të AKA-së, sepse atëherë nuk do të vërejmë asnjë progres në drejtim të përmirësimit të cilësisë të arsimit të lartë;
- të zgjatet afati i akreditimit të programeve të studimit, e cila është 3 deri në 5 vjet, të bëhet deri në 8 vjet. Kjo për shkak se në të shumtën e rasteve IAL-të shume shpesh po e gjejnë veten të humbura në proces të përmbushjes së standardeve formale, mirëpo në praktikë, për shkak mospasjes hapësirë dhe kohë mbi reflektimin dhe analizën mbi cilësinë që ofron institucioni, ata po çalojnë në përmbushjen e standardeve reale të cilësisë.

Sipas drejtorit aktual (ushtrues detyre) të AKA-së, me gjithë përpjekjet për të fuqizuar rolin e AKA-së, duke krijuar komisionin për trajtimin e ankesave të IAL-ve, që përbën përmbushjen e një kriteri shumë të rëndësishëm për rivlerësim nga ENQA dhe EQAR, dëshmon edhe rritjen e transparencën dhe llogaridhënies së AKA-së, përmes ofrimit të mundësive të palëve për ankesë ndaj vendimeve të KSHC-së (UA Nr.15/2018, 2018), AKA-ja mbetet me kapacitete të kufizuara. Mirëpo, përpos vlerësimit me ekspertë në këtë vit dhe tërheqjes së disa vendimeve për akreditim në bazë të vlerësimit të stafit akademik, AKA-ja nuk ka bërë asnjë veprim në drejtim të monitorimit, nuk ka rritur resurset e saj njerëzore dhe nuk ka investuar në fusha të tjera që janë të nevojshme për funksionimin e Agjencisë.

Në vitin e fundit, AKA-ja jo vetëm që ka shkëputur komunikimin me IAL-të, që janë palët kryesore të interesit për procesin e akreditimit, dhe në këtë mënyrë palët gjithnjë e më pak po janë të informuara për procesin e vendimmarrjes, por KSHC-ja pothuajse ka shkëputuar komunikimin edhe me stafin ekzekutiv dhe profesional të AKA-së.

Kjo gjendje vazhdon edhe më tutje dhe rreziku për përkeqësim të mëtejshëm të raporteve në mes të KSHC-së dhe komisionit për ankesa është i lartë.

Gjithnjë sipas drejtorit të AKA-së, KSHC-ja në disa raste ka ndërmarrë veprime dhe vendime të paharmonizuara me kërkesat profesionale dhe se është mjaft e theksuar mungesa vullnetit të

tyre për të bashkëpunuar me stafin ekzekutiv dhe me IAL-të. Pastaj nxjerrja e kriterëve të reja teknike për akreditim dhe mosinformimi me kohë dhe i saktë i IAL-ve do të rezultojë me mosakreditim të shumicës së IAL-ve, duke përjashtuar deri në një masë të caktuar Universitetin e Prishtinës. Sipas tij rezulton se kjo situatë është shqetësuese.

Megjithatë, edhe sipas tij problematika e mungesës së profilit pedagogjik e shkencor është faktor thelbësor në ngecjet për sigurimin e cilësisë. Prandaj, për shkak të situatës së theksuar mësipër përkatësisht mungesës e së paku të tre pedagogëve me titull doktor shkence rreziku për mosriakreditim të IAL-ve mbetet prezent edhe për një kohë të gjatë.

Shqetësim tjetër mbetet, mosharmonizimi i programeve studimore në të gjitha nivelet me nevojat e tregut të punës në vend e më gjerë, si njëri ndër problemet më serioze më të cilat ballafaqohen institucionet arsimore private dhe publike universitare.

Problem tjetër janë programet e përsëritura dhe identike të IAL-ve. Në shumë raste IAL-të publike dhe private kanë arritur të akreditojnë programe me formë dhe përmbajtje të njëjta.

5.4 Diskutimi dhe vërtetimi i hipotezave

Arsimi i Lartë nuk ka një referencë të qartë në ndonjë strategji zhvillimore të vendit që do të përcaktonte qëllimet dhe orientimet strategjike të dijes, kërkimit shkencor dhe zhvillimit. Nuk ka një referencë se çfarë cilësie kërkohet nga ekonomia e vendit dhe rrjedhimisht referenca e vetme për cilësinë mbetet korniza evropiane e cilësisë, rangimet ndërkombëtare etj.

Gjetjet nga hulumtimet dhe diskutimet me ekspertë në kuadër të këtij projekti kërkimor i vërtetojnë hipotezat e ngrituara nga autori.

Në vijim në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur gjetjet kryesore që e vërtetojnë secilën hipotezë:

- H.1 Supozohet se hapja e pakontrolluar dhe stihike e shumë bartësve publikë dhe privatë të AL-së në një periudhë të shkurtër kohore, pa përgatitje të mirë paraprake dhe me resurse të kufizuara të stafit akademik ka ndikuar në rënien e cilësisë në arsimin e

lartë. Pra, masivizimi i bartësve të AL-së në raport me cilësinë (kuantitet dhe jo kualitet).

Nga hulumtimi i realizuar del se hiperprodhimi i kuadrove i mjegullon parametrat e cilësisë, duke shkaktuar hiperproduksion të diplomave (kuantitet) dhe jo patjetër hiperproduksion të dijeve (kualitet). Pra, për shkak të hapjes së paplanifikuar mirë të shumë IAL-ve, shoqëria sfidohet me hiperkualifikime në letër përmes diplomave, ndërsa indikatorët e tregut të punës tregojnë deficit të dijeve dhe shkathtësive të nevojshme për industrinë dhe ekonominë (rreth 10 mijë të papunë me diploma).

Dimensioni kuantitativ i akreditimit (numrii profesorëve me PhD) në dëm të dimensionit kualitativ pa kapacitete për vlerësim të thelluar dhe referime se çka është cilësi për këtë shoqëri, shembuj të tjerë multiplikimi i programe të akredituara në lëmitë që prodhojnë hiperproduksion të kuadrove (jurist, economist) dhe rrjedhimisht nxitje për të bërë doktoratura në po të njëjtat fusha për të përgatitur kuadro të njëjta.

Rrjedhimisht edhe nën-hipotezat e ngritura vërtetohen ku shumica e ekspertëve të AL-së mendojnë se mosgatishmëria për ndryshime e stafit të institucioneve bartëse të arsimit të lartë ka ndikuar në performancën jo të mirë dhe rënien e cilësisë.

Nga ajo që u tha më lart vërtetohet edhe se themelimi i AKA-së me gjithë përpjekjet për futjen rregullsisë dhe ndaljen e ofertave jocilësore të IAL-ve, akreditimi i një numri të madh të programeve dhe institucioneve në një hapësirë relativisht të kufizuar si për nga numri i popullsisë dhe asaj gjeografike, si duket ka ndikuar më shumë në nxitjen e kuantitetit sesa në menaxhimin real të cilësisë sipas parametrave ndërkombëtarë.

Kjo dëshmohet me rritjen e numrit të papunësuarve të diplomuar në IAL. Një i diplomuar në 2010 dhe pa punuar asnjëherë në profesionin e tij, çfarë është pritja që ai/ajo mund të japë nga profesioni i tij nëse punësohet më 2019, pra a janë të vlefshme në rrethana të reja dijet e arritura një dekadë më herët, të cilat nuk janë aplikuar asnjëherë.

Nuk ekzistojnë mekanizma për riorientim dhe rikualifikim të të rinjve të diplomuar në AL për të përditësuar dhe riorientuar kompetencat e tyre sipas kërkesave të tregut të punës dhe nevojave të tyre për të mësuarit gjatë gjithë jetës (LLL).

Në diskursin publik përmendet cilësia, por nuk ekziston një forum në nivel vendi që merret me çështjet e cilësisë së AL-ve.

Problem mbetet dizajnimi i programeve studimore që ndërtohen mbi bazën e vendimeve të akomodimit të stafit akademik në dëm të mekanizmave dhe lëndëve zgjedhore duke pamundësuar një akumulim të ECTS në bazë të kurrikulava dhe programeve të studimit të thurura sipas nevojës reale (tailor made curricula) të ekonomisë dhe industrisë.

Prandaj, politikat e qeverisë për menaxhimin e cilësisë në arsimin e lartë nuk kanë dhënë rezultatet e duhura në ngritjen e cilësisë së arsimit dhe besueshmërisë së publikut në komunitetin akademik dhe shkencor të vendit. Prandaj hulumtimi vërteton hipotezën në vijim:

- H.2 Mendohet se këto politika nuk kanë rezultuar me rritje të besueshmërisë së publikut dhe ekonomisë në resurset humane, duke mbetur edhe mëtej në shpërputhje me pritjet e industrisë për fuqi punëtore kualitative dhe me premisa inovative.

Në funksion të vërtetimit të kësaj hipoteze janë gjetjet që dëshmojnë se nuk promovohet mjaftueshëm mobiliteti i studentëve dhe kualifikimi i tyre në fusha ndërdisiplinare as brenda të njëjtit universitet e lëre më ndërmjet IAL-ve brenda dhe jashtë vendit.

Mungesa e prezencës së universiteteve në kërkim dhe zhvillim, në nxitjen e ndërmarrjeve hulumtuese e shkencore të profesoratis dhe studentëve, duke kufizuar përditësimin e stafit akademik dhe studentëve për t'u bërë pjesë e zgjidhjes së problemeve të shoqërisë dhe të ndjekjes së trendeve zhvillimore, duke lënë analizat dhe hulumtimet në suaza të projekteve të realizuara nga shoqëria civile.

Janë shumë të rralla praktikat e angazhimit të profesionistëve të fushave të ndryshme në ndarjen e përvojave të tyre me studentët dhe profesorët, janë raste të rralla kur profesorët individualisht e bëjnë.

- H.3 Supozohet se politikat e ngutshme dhe pa përgatitje të mjaftueshme, paqartësia mosharmonizimi i mirë i legjislacionit për arsimin e lartë dhe politizimi kanë ndikuar në uljen e cilësisë dhe mosrespektim të kriterëve akademike dhe shkencore.

Universitetet nuk janë hapur dhe nuk ia kanë dalë që të atraktojnë tregun në nivel rajonal e lëre më atë evropian, një adresë konkrete mund të ishin edhe studentët tanë në diasporë, të cilët janë bilingualë ose multilingualë për të kaluar një semestër në universitetet tona dhe që do të

kishte qëllime të shumëfishta prej mobilitetit e deri te kontributi në shkëmbime akademike dhe ruajtje të identitetit të tyre, por edhe sjelljes së përvojave të reja.

Në anën tjetër ftohen politikanët e ndryshëm për ligjërata, të cilët jodomosdoshmërisht janë modeli i duhur i suksesit apo veprimit të tyre politik, duke mos përjashtuar edhe politikanët ndërkombëtarë që ftohen më shumë për marketing sesa për të sjellë ndonjë vlerë të shtuar.

Shembull tjetër është përgatitja e pamjaftueshme e stafit akademik dhe politizimi i tyre që në shumicën e rasteve gjatë avancimit të tyre, nuk respektohen kriteret akademike dhe shpeshherë as ato ligjore.

Gjatë regjistrimit të studimeve pavarësisht se nuk kërkohet njohja e gjuhës së caktuar, ndërsa në anën tjetër në shumë raste literatura jepet tërësisht në gjuhë të huaj.

Një fakt tjetër i rëndësishëm është se mosanëtarësimi i Kosovës në Procesin e Bolonjës ka ndikuar negativisht në implementimin e reformave në arsimin e lartë dhe në qasjen pa pengesa në hapësirën evropiane të arsimit të lartë. Edhe mungesa e kapaciteteve dhe e përkrahjes së zyrës për zhvillim akademik për të aplikuar projekte ndërkombëtare dhe mosshfrytëzimi i mirë i programeve të BE-së për arsim të lartë ka ndikuar në uljen e impaktit të projekteve në rrjedhën e reformave arsimore.

Megjithatë, nëse do të veçonim ndonjë IAL-që ka bërë përparim në renditjen ndërkombëtare, atëherë padyshim Universiteti i Prishtinës mbetet lider i arsimit të lartë jo vetëm në Kosovë, por si duket edhe në tërë hapësirën mbarëshqiptare të AL-së.

Sipas Cybermetrics Lab, pjesë e Spanish National Research Council me seli në Madrid, në ueb faqen e vet, ka përditësuar listën e rangimit të IAL-ve (mbi 29.000 IAL) (Lab, 2019).

Bazuar në shënimet e Webometrics, shihet qartë se Universiteti i Prishtinës është lider i arsimit të lartë shqip, i vlerësuar me dy kritere nga Webometrics: (i) Excellence – me 35% të peshës totale, duke numëruar numrin e punimeve shkencore gjatë viteve 2013-2017 dhe (ii) Openess – me 10% duke numëruar numrin e citimeve sipas Google Scholar, por që ngec në Visibility.

Ndërsa nga IAL-të private, Kolegji AAB ka shënuar progresin më të madh ndër vite (Lab, 2019).

KAPITULLI VI

6. KONKLuzionet dhe Rekomandimet

6.1 Konkluzionet

(Legjislacioni, implikimet në praktikë, reflektime mbi menaxhimin dhe sigurimin e cilësisë)

6.1.1 Konkluzione të përgjithshme:

- Legjislacioni ose kuadri ligjor aktual nuk arrin të sigurojë dispozita dhe rregulla të qarta që i harmonizojnë kriteret dhe parametrat funksionale e strukturore universitare me nevojat akademike e kërkimore në kushtet e ndryshimeve të shpejta në shoqëri, shkencë, ekonomi dhe në zhvillimin teknologjik, përfshirë edhe ndryshimet në arsimin e lartë. Mungesa e rregullativës së plotë statutare lidhur me çështjet akademike, kanë kushtëzuar nxjerrjen e një serie të instrumenteve nënligjore për të mundësuar përshtatjen dhe zhvillimin institucional dhe funksional të IAL-ve. Pothuajse në shumicën e universiteteve të reja publike në zgjedhjen e organeve drejtuese bëhen shkelje flagrante të dispozitave statutare. Çuditërisht asnjë IAL, gjatë përzgjedhjes të stafit akademik nuk i referohen Ligjit për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve të vitit 2009, i cili e rregullon dhe e mirëmban KKK-në (LIGJI Nr. 03/L-060 per KKK, 2008). Në shumicën IAL-ve publike mungojnë rregullore për çështje procedurale dhe asnjëra nga to, edhe pse është detyrim i tyre, nuk i referohen ligjit për procedurën administrative. Ajo që nuk ka asnjë shpjegim të arsyeshëm logjik është fakti se si ka mundësi që ligji mbi të cilin është miratuar Udhëzimi Administrativ 14/2003, është shfuqizuar me rastin e miratimit të ligjit të ri për arsimin e lartë në vitin 2011, kurse vetë Udhëzimi Administrativ vazhdon të mbetet në fuqi, duke pasur për bazë ligjin e shfuqizuar. Po e themi edhe njëherë një dukuri e tillë është prezente pothuajse në secilën fushë të arsimit në Kosovë.

- Në kuadër të IAL-ve nuk ka strategji të qartë zhvillimore reale dhe as një model të qartë të AL-së që ndihmon zhvillimin e tyre në harmoni me kërkesat e kohës dhe trendet e zhvillimit. Ekzistojnë improvizime të sistemit me rregullativë ligjore pa vizion të qartë për të ardhmen, të cilat në shumicën e rasteve duken të pazbatueshme dhe me mungesa të theksuara të mekanizmave të kontrollit për zbatimin e tyre.
- Mungon një vizion nacional për zhvillim dhe orientim të arsimit në përgjithësi dhe AL-së në veçanti për harmonizim të programeve me nevojat aktuale apo me nevojat e së ardhmes të tregut të punës dhe industrisë. Oferta arsimore është zgjeruar në mënyrë rapide pa kriteret e qarta, pa planifikim të qëndrueshëm dhe pa e marrë për bazë nevojat e vendit, popullatës dhe kërkesën e tregut kosovar apo edhe rajonal të punës.
- Arsimi i lartë karakterizohet nga një zhvillim i paharmonizuar dhe i paekulibruar mes AL publik dhe privat, sipas numrit të bartësve, shpërndarjes së programeve të studimit dhe të studentëve me duplikime të ofertës edukative dhe kopjime të dobëta të njëra-tjetrës. E njëjta vlen edhe për shumicën e universiteteve publike të vendosura në 7 qendra të vendit dhe që kopjojnë njëra-tjetrën në strukturë, programe, staf dhe ofertë akademike, të cilat janë themeluar pa kriter dhe pa një analizë reale të nevojave duke krijuar konkurrencë të dëmshme edhe brenda vetë institucioneve publike të arsimit të lartë. Kjo logjikë i ka vënë në disavantazh të dyfishtë IAL-të publike në raport me njëra-tjetrën dhe me IAL-të private.
- Ekziston një shpërputhje në raport me kriteret ligjore sa i përket dhënies së statusit të universitetit IAL-ve publike, ku përveç Universitetit të Prishtinës, të tjerat nuk i plotësojnë kriteret ligjore dhe institucionale për këtë status. Ndërkohë IAL-ve private edhe pse disa mund të jenë shumfish më të mëdha dhe më të konsoliduara se ato publike, asnjëra prej tyre nuk e ka të akorduar statusin e universitetit, por vetëm të kolegjit.

- Programet e studimit dhe kurrikulat janë të paharmonizuara qoftë edhe për të njëjtat programe në kuadër të IAL-ve publike apo private. Ato nuk janë të profilizuara në shumicën e rasteve, si dhe mungon një harmonizim me nevojat e tregut, kompetencat e profesoratis dhe mekanizmat për sigurimin e cilësisë. Nuk ekzistojnë as programe të mirëfillta afatshkurtëra të specializuara për kualifikime komplementare, apo për avancim të dijeve shkencore në fusha të caktuara, duke mundësuar akumulimin e ECTS-ve dhe `qëndisjen` e kualifikimeve sipas nevojave të caktuara.
- Sigurimi i cilësisë është i shoqëruar nga probleme e vështirësi që lidhen me të kuptuarit të sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë dhe me mosinteresimin e mjaftueshëm të vetë IAL-ve veçanërisht për cilësinë e brendshme. Është krijuar përshtypja se IAL-të sigurimin e brendshëm të cilësisë e ndërlidhin vetëm me nevojat e akreditimit apo ri-akreditimit, pra vetëm përmes ndikimit të mekanizmave të jashtëm të cilësisë në kuadër të institucioneve të sistemit të cilësisë dhe akreditimit siç janë MASHT-i dhe AKA-ja. Në shumicën e rasteve e tëra që aplikohet në sigurimin e mbrendshëm të cilësisë është pjesa teknike e vlerësimit e përshkruar në silabuse dhe që varion shumë në varësi të kompetencave profesionale të profesorëve të caktuar. Rrjedhimisht IAL-të nuk kanë arritur që të krijojnë mekanizma efektivë universitarë për sigurimin e cilësisë. Kjo konfirmohet edhe nga renditja e dobët e universiteteve dhe kolegjeve tona sipas webometrics.info, Universiteti i Prishtinës është i renditur i 3790-ti në këtë listë, kurse universitetet e tjera publike në Kosovë jo vetëm që janë në fund të listës, por janë më poshtë se kolegjet private.

Një tjetër komponentë e rëndësishme e cilësisë është mungesa e mekanizmave për matjen e performancës së profesoratis dhe stafit tjetër universitar. Asnjë IAL në Republikën e Kosovës nuk ka krijuar mekanizma për matjen e performancës të profesorëve, duke pamundësuar procesin e identifikimit të dobësive të tyre gjatë realizimit të detyrave të tyre. Në disa raste realizohen anketime me studentë, por që në thelb kanë për bazë kënaqësinë e studentëve dhe jo kriteret reale të performancës.

- Kërkimi shkencor, si dhe lidhja e ngushtë midis hulumtimit dhe arsimit është në nivel mjaft të ulët, krahasuar me IAL-te evropiane. Njohuritë e fundit, të menduarit dhe të punuarit shkencërisht si komponent i rëndësishëm i arsimit të bazuar në hulumtime (RBE- Research-Based Education) janë larg arritjes së qëllimit për të krijuar kërkues kompetentë dhe inovativë, të cilët do t'i shërbenin zhvillimit shoqëror dhe ekonomik të vendit. Ndërsa të mos flasim për krahasime në dimensionin evropian dhe ndërkombëtar ku potenciali këtyre institucioneve është dukshëm i kufizuar.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mobiliteti është në nivel të kufizuar të bashkëpunimeve ndërinstitutionale, me një numër mjaft të kufizuar të programeve të përbashkëta të studimit, me shumë pak shkëmbime studentësh, por jo sa i përket edhe mobilitetit të profesoratit. Mobiliteti tepër i ulët i studentëve flet për një mbyllje në vetvete të IAL-ve, që reflekton me mungesë të bashkëpunimit në fushat e përafërta për të zhvilluar projekte kërkimore të përbashkëta. Kjo ndikon negativisht në përditësimin e dijeve dhe shkëmbimeve të dijeve dhe të arriturve shkencore në nivel ndërkombëtar.
- E-mësimi (e-learning), të mësuarit në distancë (open distance learning), të mësuarit digjital dhe përmes platformave online është në nivel shumë të ulët dhe mjaft i kufizuar. Nuk ekziston asnjë program telematik i studimit apo edhe platformë e përbashkët e IAL-ve si formë e bashkëpunimit ndërinstitutional e as me ndonjë universitet jashtë vendit.

6.1.2 Konkluzione specifike

Programi i studimit- mësimdhënia e ofruar

- Përshtypja e përgjithshme e studentëve të intervistuar për cilësinë e programeve në arsimin e lartë është e kënaqshme. Përmbajtjet e ofruara përmes lëndëve vlerësohen si të mira. Studentët konsiderojnë se programi i tyre i studimit është në nivelin e duhur. Më pak se 6% janë të pakënaqur me programin apo përmbajtjen e lëndëve. Në përgjithësi

aspektet organizative të mësimdhënies dhe metodat e vlerësimit konsiderohen si të kënaqshme dhe të mira. Se përmbajtjet e lëndëve janë në përputhje të plotë me procesin e vlerësimit pohojnë mbi 80% të studentëve të intervistuar.

Puna praktike

- Edhe pse nga hulumtimi del se studentët janë, në përgjithësi, të kënaqur me cilësinë e programeve, vetëm 30% nga ta konsiderojnë se programi i tyre i studimit ofron punë praktike profesionale, në nivelin e duhur. Më shumë se gjysma e tyre janë të pakënaqur me pjesën e punës praktike profesionale. Përfshirja e praktikës profesionale gjatë studimit është një pikë e dobët e programeve studimore në IAL. Afro 80% e studentëve të anketuar pohojnë se praktika profesionale nuk vlerësohet mjaftueshëm. Mbi 80% pohojnë se programet e studimit nuk ofrojnë mjaftueshmë informacion për mundësitë e realizimit të punës praktike. Studentët po ashtu, ndjehen të papërkrahur nga IAL në gjetjen e mundësive për kryerjen e praktikës profesionale. Në përgjithësi, mungesa e përkrahjes në gjetjen e mundësive, periudha e shkurtër e trajnimit praktik dhe mungesa e vlerësimit të intershipit/praktikës mësimore, rezultojnë me një lidhje të pamjaftueshme midis elementëve teorikë dhe punës praktike gjatë studimit.

Metodologjia

- Studentët e anketuar vlerësojnë metodologjinë e mësimdhënies dhe rezultatet tregojnë se pjesa më e madhe e tyre janë të kënaqur me metodat e mësimdhënies. Megjithatë, shumica e studentëve konsiderojnë se nuk ofrohen programe të mjaftueshme trajnimi për metodat empirike të studimit. Kurse sa i përket aftësive dhe cilësive të profesorëve pjesa më e madhe e studentëve i vlerësojnë si të mira këto attribute., është me vlerë të theksohet që profesorët preferojnë kryesishtë librat e tyre. Pjesa më e madhe rekomandojnë vetëm literaturë në gjuhën shqipe. Një numër i vogël prej 5%, të profesorëve përdorin apo rekomandojnë literaturë në gjuhën angleze. Ndërsa literatura në gjuhën gjermane apo atë serbe preferohet fare pak.

Vlerësimi

- Sistemi i vlerësimit konsiderohet të jetë transparent, korrekt dhe i pranuar mirë nga studentët. Me gjithë subjektivizmin e theksuar që mund ta ketë i vlerësuari gjatë procesit të vlerësimit, sistemi i vlerësimit në IAL konsiderohet të jetë, maksimalisht korrekt dhe i pranuar mirë nga studentët.

Përgatitja për tregun e punës

- Pjesa më e madhe e studentëve të intervistuar, rreth 90%, nuk besojnë që shërbimet e IAL-ve ndihmojnë në gjetjen e një pune pas diplomimit. IAL përkrahin vetëm pjesërisht iniciativat e studentëve për lidhje me tregun e punës gjatë studimit. Afro gjysma e studentëve të intervistuar konsiderojnë që kanë mungesë të informacionit për takimet që organizohen me qëllim të lidhjes me tregun e punës.
- Mbi 40% e studentëve konsiderojnë se njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale janë vetëm pjesërisht në përputhje me tregun e punës. Pjesa më e madhe e studentëve të intervistuar, mbi 80%, konsiderojnë që programet e gjuhëve të huaja që ofrohen nga IAL-të, janë të pjesshme ose të pakëta në kontekstin e integritimit në tregun e punës.
- Në lidhje me njohuritë dhe shkathtësitë kompjuterike, pjesa më e madhe e studentëve të intervistuar, mbi 80%, konsiderojnë se programet e teknologjisë informative që ofrohen nga IAL-të, ofrohen pjesërisht ose janë të pakëta. Është e dukshme një ngjashmëri në përgjigjet për programet e gjuhëve të huaja dhe atyre për njohuritë digjitale.

Përkrahja nga stafi akademik dhe vlerësimi i mësimdhënies

- Studentët pohojnë gatishmërinë e stafit akademik për të përkrahur ata në zhvillimin e tyre. Mund të konstatohet që IAL-të kanë staf akademik të motivuar mjaftueshëm për përkrahjen e studentëve në zhvillimin e tyre profesional.

Përkrahje për mobilitet - qëndrim studimor jashtë vendit

- Më shumë se gjysma e studentëve të intervistuar konsiderojnë që IAL-të, ku ata studiojnë ka interesim të ulët për programet e përbashkëta me universitetet jashtë vendit. Në përgjithësi, vërehet një mungesë e dukshme e mobilitetit apo bashkëpunimit me institucione jashtë vendit

Sallat-amfiteatrot/Biblioteka

- Disponueshmëria e sallave të ligjëratave dhe ushtrimeve për mësimdhënie vlerësohet si e kënaqshme. Në përgjithësi kushtet teknike dhe hapësira është vlerësuar si e mirë dhe solide.
- Gjysma e studentëve pohojnë se u mungon literatura adekuate për studimet e tyre. Mbi 55% e studentëve vlerësojnë që kanë vështirësi qasjeje në revista dhe literaturë akademike.

Infrastruktura e it-së dhe e-learning (të mësuarit online)

- Afro gjysma e studentëve të intervistuar pohojnë se u mungon mbështetja për mësim nga shërbimet online.

Klima e studimit

- Aspektet e komunikimit ndërmjet studentëve dhe relacionet ndërmjet studentëve dhe stafit akademik në IAL, nga mbi 80% e studentëve vlerësohen si të kënaqshme dhe shumë të mira.
- Pyetjes se a do t'ia rekomandonin këtë institucion dhe program ndonjë të afërm, studentët shfaqen pjesërisht të kënaqur rreth 37% dhe po aq të pakënaqur me IAL-në ku studiojnë. Vetëm 25% e tyre janë plotësisht të kënaqur.
- Më shumë se 60% e studentëve janë të pakënaqur me universitetin apo drejtimin.

6.2 Rekomandime

Qeveria do të duhej të shtyj përpara miratimin e Ligjit të ri për Arsimin e lartë dhe përmes tij të nxitenndryshimet dhe plotësimet statutores të IAL-ve për të garantuar një proces të vazhdueshëm të përmirësimit dhe zhvillimit institucional në frymën e kërkesave dhe nevojave të reja.

Duhet që të nxjerret ligji për Agjencinë Kosovare të Akreditimit e cila funksionon në bazë të dispozitave ligjore (UA) që burojnë nga ligji aktual për arsimin e lartë. Pastaj të nxjerren aktet nënligjore të cilat burojnë nga Ligji i ri për Arsimin e Lartë dhe Ligji për AKA-në dhe të harmonizohen mirë duke evituar dykuptimesin dhe paqartësitë eventuale lidhur me rolin dhe kompetencat e institucioneve gjegjëse.

IAL-private të shndërrohen me ligj në institucione jofitimprurese si parakusht i rëndësishëm për të investuar të hyrat e tyre në arsim dhe shkencë dhe që të nxisin rritjen e cilësisë së AL. Duke i shndërruar në institucione jofitimprurëse, IAL-të private do të nxiteshin që të investojnë në projekte kërkimore dhe zhvillimore si dhe do të kontribuonin në nxitjen e konkurrencës lojale dhe fer në raport me ato publike. Për më tepër do të nxitej investimi i IAL-ve private në stafin akademik dhe në rritjen e mobilitetit të kuadrove dhe studentëve, por jo vetëm kjo. Gradualisht do të duhej në përputhje me kriteret ligjore të futet parimi i barazisë së dhënies së statusit të universitetit IAL-ve publike dhe private. Ndërkohë që sot asnjërës prej IAL-ve private nuk u është dhënë statusi i universitetit, por vetëm i kolegjit.

Arsimi i lartë karakterizohet nga një zhvillim i paharmonizuar dhe i paekulibruar mes AL publik dhe privat, sipas numrit të bartësve, shpërndarjes së programeve të studimit dhe të studentëve me multiplikime të ofertës edukative dhe përsëritje të njëra-tjetrës. Është mëse e nevojshme që shumica e universiteteve publike të vendosura nëpër shumë qendra të vendit dhe të cilat janë themeluar analizë të mirëfilltë, të ristrukturohen sipas nevojave të ekonomisë dhe shoqërisë duke shmangur një konkurrencë jolojale edhe brenda vetë institucioneve

publike të arsimit të lartë. Programet e studimit dhe kurrikulat të harmonizohen me nevojat e tregut duke investuar në ngritjen e kompetencave të profesoratit dhe në mekanizmat për sigurimin e cilësisë. Njëra prej mundësive do të ishte që IAL t'i marrin (adaptojnë) programet e studimit nga shtetet e BE, sepse këto shtete, në njërën anë i përcjellin parametrat e tregut të punës dhe në anën tjetër u ofrojnë studentëve dhe të diplomuarve tanë qasje më të lehtë në vazhdimin e studimeve si edhe në tregun evropian të punës.

